FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 170

Tiranë – E martë, 4 gusht 2026

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 634, datë 31.7.2026	Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese nr. 1, me shkëmbim letrash, të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, për planin shumëvjeçar të veprimit në favor të Shqipërisë, për vitet 2025–2027, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA III), miratuar me vendimin nr. 735, datë 10.12.2025, të Këshillit të Ministrave	17193
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 757, datë 22.7.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Kroacisë.....	17225
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 758, datë 22.7.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Spanjës.....	17228
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 763, datë 24.7.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Çekisë.....	17229
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 764, datë 24.7.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Spanjës.....	17231
Vendim i Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 133, datë 22.7.2026	Për disa ndryshime në vendimin e Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 132/2026, "Autorizim i ndihmës shtetërore 'Fondi për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme për vitin 2026'".....	17233
Urdhër i drejtorit të Inspektoratit të Përgjithshëm nr. 276, datë 20.7.2026	Për administrimin e Regjistrit të Inspektorëve, Numrit Unik të Identifikimit dhe Kartës së Inspektorit.....	17235

Vendim i Gjykatës Kushtetues nr. 73, datë 16.6.2026

Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-2954, datë 10.7.2025, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë..... 17249

Kërkesë për shpalljen e vdekjes së shtetasit Artur Koçollari..... 17263

Kërkesë për deklarimin e zhdukjes së shtetasit Pullumb Xhemali..... 17263

VENDIM
Nr. 634, datë 31.7.2026

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE NR. 1, ME SHKËMBIM LETRASH, TË MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, DHE KOMISIONIT EVROPIAN, PËR PLANIN SHUMËVJEÇAR TË VEPRIMIT NË FAVOR TË SHQIPËRISË, PËR VITET 2025–2027, NË KUADËR TË INSTRUMENTIT TË ASISTENCËS SË PARAANËTARËSIMIT (IPA III), MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 735, DATË 10.12.2025, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese nr. 1, me shkëmbim letrash, të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, për planin shumëvjeçar të veprimit në favor të Shqipërisë, për vitet 2025–2027, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA III), miratuar me vendimin nr. 735, datë 10.12.2025, të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

KOMISIONI EVROPIAN
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR ZGJERIMIN DHE FQINJËSINË LINDORE
B – Ballkani Perëndimor
Drejtor

Bruksel, XXX
ENEST.B/VS

Lënda: Amendimi nr. 1 i marrëveshjes së financimit nëpërmjet shkëmbimit të letrave për planin shumëvjeçar të veprimit në favor të Shqipërisë, për vitet 2025–2027

E nderuar Znj. Çano,

Komisioni dhe autoritetet shqiptare lidhën fillimisht një marrëveshje financimi për planin shumëvjeçar të veprimit në favor të Shqipërisë, për vitet 2025–2027, më 10 dhjetor 2025 (në vijim "Marrëveshja e Financimit").

Ndryshimet e mëposhtme në marrëveshjen e financimit çmohen të nevojshme:

1. Shtojca I e marrëveshjes së financimit do të zëvendësohet me shtojcën I të kësaj letre.

Të gjitha dispozitat e tjera të marrëveshjes së financimit mbeten të pandryshuara.

Ndryshimet e propozuara synojnë të pasqyrojnë ndryshimet që rrjedhin nga dokumentet e veprimit "BE-ja për shtetin e së drejtës dhe demokracinë", "BE-ja për qeverisje të mirë të integruar" dhe "Instrumenti lehtësues për BE-në", pas procesit të rishikimit vjetor 2026, siç janë komunikuar dhe rënë dakord. Këto ndryshime rialokojnë një total prej 7 milionë euro në vitin 2026, specifikisht 2,8 milionë euro nga prokurimi dhe 4,2 milionë euro nga menaxhimi indirekt në grante në vitin 2026, si edhe 0,2 milionë euro nga prokurimi në menaxhim indirekt në vitin 2027. Në këtë kuadër, për rezultatin 2 shtohet një grant si modalitet zbatimi. Gjithashtu, tabela përmbledhëse përditësohet për të përfshirë modalitetin e grantit; doganat dhe bujqësia shtohen në listën e sektorëve, në kuadër të produktit të pritshëm 2.5, në

seksionet e kontekstit dhe analizës së problemit, si dhe të mësimeve të nxjerra; ndërsa hiqet referenca për ndërhyrjet në shkallë të vogël në aktivitetet e renditura në kuadër të produktit 2.5.

Ju lutem përgjigjuni kësaj letre duke shprehur dakordësinë tuaj për ndryshimet e shpjeguara më sipër, duke përdorur modelin e letrës së përgjigjes në shtojcën 1.

Eridana Çano
Koordinatore Kombëtare e IPA-s (NIPAC)
Drejtore e Përgjithshme e Agjencisë Shtetërore të
Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës
Rruga "Kuvajt"
Tiranë, Shqipëri

Ky shkëmbim letrash do të përbëjë amendimin nr. 1 të marrëveshjes së financimit, i cili do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të fundit të letrave, pas përfundimit të procedurave të brendshme ligjore të përfituesve të IPA III dhe pranimit të amendimit nga të dy përfituesit e IPA III. Komisioni do t'i njoftojë përfituesit e IPA III për datën e hyrjes në fuqi, e cila do të jetë jo më vonë se 31 dhjetor 2026.

Në pritje të përgjigjeve tuaja që konfirmojnë dakordësinë me këtë amendim.

Me respekt,

Nënshkruar elektronikisht

Valentina Superti

Bashkëlidhur: Letërpërgjigje për pranimin e amendimit, si shtojca 1

Për dijeni: Andi Memeti, zëvendësministër i Financave, Nëpunës Kombëtar Autorizues (NAO), Ministria e Financave, Shqipëri

Sonil Bilaj, Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, Shqipëri

SHTOJCA 1

LETËR PËRGJIGJEJE

Tiranë, … 2026

Valentina Superti
Drejtore B – Ballkani Perëndimor
Drejtoria e Përgjithshme për Zgjerimin dhe Fqinjësinë Lindore

Lënda: Përgjigje ndaj kërkesës suaj për amendimin nr. 1, të marrëveshjes së financimit nëpërmjet shkëmbimit të letrave për planin shumëvjeçar të veprimit në favor të Shqipërisë, për periudhën 2025–2027

Referenca: Letra juaj e datës XXX [ref. ARES]

E nderuar Znj. Drejtore,

Në vijim të letrës suaj të lartpërmendur më sipër, ju propozoni ndryshimet e mëposhtme në marrëveshjen e financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian, lidhur me planin shumëvjeçar të veprimit në favor të Shqipërisë, për periudhën 2025–2027 (në vijim "Marrëveshja e financimit"):

1. Shtojca I e marrëveshjes së financimit zëvendësohet me shtojcën I të kësaj letre.

Të gjitha dispozitat e tjera të Marrëveshjes së Financimit mbeten të pandryshuara.

Ndryshimet e propozuara synojnë të pasqyrojnë ndryshimet që rrjedhin nga fletët e veprimit "BE-ja për shtetin e së drejtës dhe demokracinë", "BE-ja për qeverisje të mirë të integruar" dhe "Instrumenti lehtësues për BE-në" pas procesit të rishikimit vjetor 2026, siç janë komunikuar dhe dakordësuar. Këto ndryshime rialokojnë një shumë totale prej 7 milionë euro në vitin 2026, specifikisht 2.8 milionë euro nga prokurimi dhe 4.2 milionë euro nga menaxhimi indirekt drejt granteve në vitin 2026, si dhe 0.2 milionë euro nga prokurimi drejt menaxhimit indirekt në vitin 2027. Në këtë kuadër, për rezultatin 2 shtohet granti si modalitet zbatimi. Më tej, tabela përmbledhëse përditësohet për të përfshirë modalitetin e grantit;

doganat dhe bujqësia shtohen në listën e sektorëve nën produktin e pritshëm 2.5, në analizën e kontekstit dhe problematikës dhe në seksionin e mësimeve të nxjerra; ndërsa referenca për ndërhyrjet në shkallë të vogël në aktivitetet e renditura nën produktin e pritshëm 2.5, hiqet.

Në vijim të letrës suaj të lartpërmendur, lidhur me miratimin e angazhimit financiar për vitin 2025, me anë të kësaj pranoj amendimin nr. 1 të marrëveshjes së financimit. Ky amendim hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të fundit të letrës, pas përfundimit të procedurave të brendshme ligjore të përfituesit të IPA III. Komisioni njofton përfituesin e IPA III për hyrjen në fuqi, e cila do të jetë jo më vonë se data 31 dhjetor 2027.

Me respekt,

.....
Koordinatori Kombëtar i IPA-s

AL

KY VEPRIM FINANCOHET NGA BASHKIMI EVROPIAN

SHTOJCA I
E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT MBI PLANIN SHUMËVJEÇAR TË VEPRIMIT NË FAVOR TË SHQIPËRISË, PËR PERIUDHËN 2025–2027

DOKUMENTI I VEPRIMIT PËR VEPRIMIN SHUMËVJEÇAR NË FAVOR TË SHQIPËRISË, PËR PERIUDHËN 2025–2027

1.1 Përmbledhje: Tabela përmbledhëse e veprimit

Titulli **OPSYS** *(Sistemi Operacional i Komisionit Evropian për Menaxhimin e Projekteve dhe Kontratave)* **Akti themelor**	Plani shumëvjeçar i veprimit në favor të Shqipërisë për vitet 2025–2027; Vendimi Zbatues i Komisionit për financimin e planit shumëvjeçar të veprimit në favor të Ballkanit Perëndimor për vitet 2025–2027; Referenca e biznesit të OPSYS: FD-2328; Numri i nivelit 1 të angazhimit: <referenca 1> për vitin financiar 2025; <referenca 2> për vitin financiar 2026; dhe <referenca 3> për vitin financiar 2027; Financuar në kuadrin e Instrumentit për Asistencën e Paraaderimit (IPA III).
Përfituesi i veprimit	Veprimi do të zbatohet në Shqipëri.
Dokumenti programues	Kuadri programues IPA III.
Lidhja me dokumentet përkatëse të programimit strategjik	Dritarja 1: Sundimi i ligjit, të drejtat themelore dhe demokracia; Dritarja 2: Qeverisja e mirë, përafrimi me *acquis*-in e BE-së, marrëdhënie të mira fqinjësore dhe komunikim strategjik; Dritarja 4: Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse.
INFORMACION MBI BUXHETIN	
Shumat përkatëse	Kostoja totale e vlerësuar: 100 000 000 euro; Shuma totale e kontributit nga buxheti i BE-së është 100 000 000 euro, nga e cila 33 563 000 euro në vitin 2025, 30 000 000 euro në vitin 2026 dhe 36 437 000 euro në vitin 2027. Linja(t) e buxhetit (artikull, zë): Linja e buxhetit: 15.020101.01: - Për vitin 2025 – 25 563 000 euro; - Për vitin 2026 – 30 000 000 euro; - Për vitin 2027 – 36 437 000 euro. Linja e buxhetit: 15.020201: - Për vitin 2025 – 8 000 000 euro. Kontributi nga buxheti i përgjithshëm i Bashkimit Evropian varet nga disponueshmëria e alokimeve përkatëse për vitet financiare përkatëse, pas miratimit të buxhetit vjetor përkatës ose siç parashikohet në sistemin e të dymbëdhjetave të përkohshme.
MENAXHIMI DHE ZBATIMI	
Modalitetet e zbatimit (mënyra e menaxhimit dhe metodat e ofrimit)	**Menaxhim direkt nëpërmjet:** - Granteve (përfshirë edhe grantet e binjakëzimit); - Prokurimit. **Menaxhim indirekt** me subjekte që do të zgjidhen në përputhje me kriteret e përcaktuara në seksionin 4.3.3.

Afati për lidhjen e marrëveshjes shumëvjeçare të financimit	Jo më vonë se data 31 dhjetor 2026, për alokimin e vitit 2025.
Afati për shkëmbimin e letrave ose për letrën e njoftimit mbi alokimet buxhetore vjetore pasuese për zbatimin e marrëveshjes së financimit	Për angazhimin buxhetor të vitit 2026: jo më vonë se data 31 dhjetor 2027. Për angazhimin buxhetor të vitit 2027: jo më vonë se data 31 dhjetor 2028.
Afati për përfundimin/angazhimet ligjore	3 vjet pas datës së lidhjes së marrëveshjes së financimit, për alokimin e vitit 2025 (ose 3 vjet nga data e përfundimit të shkëmbimit të letrave ose të letrës së njoftimit për këstet buxhetore pasuese), me përjashtim të rasteve të përmendura në nenin 114(2) të rregullores financiare.

1.2 Përmbledhja e veprimit

Ky veprim mbështet përgatitjen e Shqipërisë për anëtarësim të ardhshëm në BE, duke avancuar agjendën e saj të reformave në sektorë të ndryshëm brenda procesit të anëtarësimit. Ai përputhet plotësisht me prioritetet tematike të IPA III dhe plotëson programin për reformë dhe rritje për Shqipërinë, siç është përcaktuar në Agjendën Kombëtare të Reformave të miratuar më 10 tetor 2024.

Në kuadër të fushës së mbështetjes 1 (dritarja 1), ky veprim forcon sundimin e ligjit, të drejtat themelore dhe demokracinë. Ai përqendrohet kryesisht në reformën në drejtësi, eficiencën gjyqësore, luftën kundër krimit të organizuar, pastrimin e parave dhe korrupsionin e nivelit të lartë, si dhe në rritjen e kapaciteteve të Shqipërisë për të përballuar sfidat ndërsektoriale, të tilla si: siguria kibernetike, parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe antiterrorizmi. Gjithashtu, promovon të drejtat e njeriut dhe forcon institucionet demokratike.

Në kuadër të fushës së mbështetjes 2 (dritarja 2), ky veprim promovon reforma të qeverisjes në nivelet qendrore dhe lokale, veçanërisht për të përmirësuar eficiencën, transparencën dhe llogaridhënien e administratës publike dhe menaxhimit financiar publik. Ai, gjithashtu, mbështet INSTAT-in në përputhjen e mëtejshme të sistemit statistikor të Shqipërisë me kërkesat e BE-së. Gjithashtu, ky veprim lehtëson përafrimin me *acquis*-in, ndërtimin e kapaciteteve për anëtarësimin në BE dhe përgatitjen e Shqipërisë për programet e ardhshme të BE-së, përfshirë fondet e politikës së kohezionit, kryesisht përmes strukturës së integrimit në BE.

Në kuadër të fushës së mbështetjes 3 (dritaret 3 dhe 4), ky veprim mbështet tranzicionin e gjelbër dhe digjital të Shqipërisë, veçanërisht duke nxitur një sektor konkurrues dhe të qëndrueshëm të lëndëve të para kritike, të integruar në zinxhirin industrial të vlerës së BE-së. Ai ndihmon në përafrimin e kuadrit të Shqipërisë për lëndët e para kritike ***(CRM/LPK)*** me *acquis*-in e BE-së, mbështet zbatimin e hartës rrugore të Qendrës Rajonale të Inovacionit për Materialet, zhvillon kapacitetet institucionale në kërkimin dhe inovacionin në sektorin e CRM-së, dhe përditëson hartën e burimeve kryesore minerale për të lehtësuar investimet e qëndrueshme në sektor, përfshirë integrimin në zinxhirët e furnizimit të BE-së.

Ky veprim është plotësisht në përputhje ose kontribuon drejtpërdrejt në zbatimin e prioriteteve dhe iniciativave kryesore të BE-së në rajon, duke përfshirë agjendat për gjelbërimin, digjitalizimin, inovacionin, kërkimin, arsimin, kulturën, rininë dhe sportin për Ballkanin Perëndimor. Ky veprim, gjithashtu, kontribuon në Agjendën për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030, duke synuar disa objektiva të zhvillimit të qëndrueshëm, qoftë drejtpërdrejt, qoftë në mënyrë ndërsektoriale.

1.3 Përfituesi(t) i/e veprimit

Ky veprim do të zbatohet në Republikën e Shqipërisë, e cila më tej do të referohet si Shqipëri.

1. Qëllimi i veprimit (përse)

2.1. Arsyetimi i përgjithshëm

Fusha e mbështetjes #1: Sundimi i ligjit, të drejtat themelore dhe demokracia

Sundimi i ligjit – Reforma në sektorin e drejtësisë

Veprimi i propozuar bazohet në mbështetjen aktuale të Shqipërisë për zbatimin e reformës në sektorin e drejtësisë, me fokus të veçantë në vazhdimin e përmirësimit të kapaciteteve të institucioneve qeverisëse të sistemit gjyqësor dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të edukimit ligjor, si dhe në mbështetjen e Ministrisë së Drejtësisë në

kapacitetin e saj të koordinimit, me qëllimin përfundimtar të forcimit të cilësisë, pavarësisë, eficiencës gjyqësore dhe llogaridhënies, në mënyrë që të konsolidohet progresi i arritur deri tani për të përmbushur kërkesat e integrimit në BE. Konsolidimi i zbatimit të reformës në sektorin e drejtësisë udhëhiqet nga Udhërrëfyesi i Sundimit të Ligjit,[1] e cila përcakton masat për të rritur pavarësinë, llogaridhënien, cilësinë dhe efikasitetin e institucioneve të drejtësisë, në përputhje me standardet evropiane. Në të njëjtën kohë, pasqyron mbështetjen për të trajtuar boshllëqet kryesore në kuadrin e procesit të negociatave për kapitullin 23, sipas Standardeve të Përkohshme[2]. Këto masa përfshijnë vlerësime të rregullta të kuadrit ligjor, vlerësime të performancës institucionale, mbështetje për përmirësimin e programeve të trajnimit, mbështetje për koordinimin dhe forcimin e bashkëpunimit, si dhe përdorimin e standardeve më të mira të verifikimit sa herë që është e zbatueshme, si dhe shkëmbimin ndërmjet kolegëve të standardeve dhe praktikave më të mira të BE-së. Forcimi i koordinimit midis institucioneve qeverisëse të sistemit gjyqësor, duke përfshirë Këshillin e Lartë Gjyqësor (KLGJ), Këshillin e Lartë të Prokurorisë (KLP), Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë (ILD), si dhe Shkollën e Magjistraturës, dhe kur është e nevojshme Ministrinë e Drejtësisë, është thelbësor për këto përpjekje dhe kritik për zbatimin e qëndrueshëm të politikave, përmirësimet e menaxhimit të burimeve dhe ndikimin e përgjithshëm të reformës në drejtësi.

Në përputhje me kuadrin e programimit IPA III, ky veprim luan rol kyç në avancimin e reformave në drejtësi të Shqipërisë, duke harmonizuar kuadrot ligjorë dhe institucionalë me standardet e BE-së. Për më tepër, veprimi plotëson strukturën horizontale të BE-së për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, me Këshillin e Evropës, duke i mundësuar përfituesve të përmbushin agjendat e tyre të reformave në fushën e sundimit të ligjit.

Për më tepër, ky veprim mbështet, gjithashtu, Objektivin e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG/OZhQ) 16. Duke forcuar pavarësinë gjyqësore, duke përmirësuar transparencën institucionale dhe duke rritur përpjekjet për ndërtimin e kapaciteteve, veprimi përputhet me Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Të drejtat themelore

Angazhimi i Shqipërisë ndaj të drejtave themelore është një shtyllë kyçe e politikës së saj të brendshme dhe kusht themelor për integrimin në BE. Ky angazhim është përfshirë në Kushtetutën e Shqipërisë, konventat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut të ratifikuara nga Shqipëria, si dhe në ligjet dhe dokumentet strategjike kombëtare, lidhur me integrimin në BE. Veprimi kontribuon në zbatimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026, i cili i jep përparësi mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave themelore, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare sipas sistemit të OKB-së, *acquis*-it të BE-së dhe standardeve të Këshillit të Evropës, duke garantuar që Kartat Evropiane të të Drejtave Themelore të zbatohen plotësisht në Shqipëri pas anëtarësimit në BE.

Veprimi është, gjithashtu, në përputhje me Udhërrëfyesin për Sundimin e Ligjit të Shqipërisë 2024–2030, që kërkon përafrim me *acquis*-in e BE-së, forcimin e institucioneve të të drejtave të njeriut dhe përmirësimin e mekanizmave të mbledhjes së të dhënave. Ai synon prioritetet politike të Komisionit Evropian për periudhën 2025–2027, të pasqyruara në kuadrin programues IPA III 2021–2027, të cilat theksojnë përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe raportimit në kontekstin e procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në BE.

Veprimi do të mbështesë këto objektiva, duke siguruar përafrimin ligjor me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare, duke përfshirë të drejtat mbi pronën, zbatimin e rekomandimeve të organeve përkatëse të monitorimit dhe forcimin e arritjeve të Shqipërisë në respektimin dhe zbatimin praktik të të drejtave themelore. Fushat e veçanta të fokusit përfshijnë mbrojtjen e të dhënave, lirinë e shprehjes, pluralizmin mediatik, antidiskriminimin, barazinë gjinore, të drejtat e fëmijëve, të drejtat mbi pronën, të drejtat procedurale dhe të drejtat e viktimave të krimit. Në përputhje me Agjendën për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030[3], Veprimi kontribuon, gjithashtu, në OZhQ 16.6 (zhvillimin e

[1] Miratuar nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 736, datë 13.12.2023.

[2] https://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2024/10/15/second-meeting-of-the-accession-conference-with-albania-at-ministerial-level/

[3] OZHQ 16: Paqja, drejtësia dhe institucionet e forta, konkretisht objektivat 16.3 (promovimi i sundimit të ligjit dhe aksesi i barabartë në drejtësi) dhe 16.6 (zhvillimi i institucioneve të përgjegjshme dhe transparente).

institucioneve të përgjegjshme dhe transparente), OZhQ 5 (barazia gjinore) dhe OZhQ 10 (ulja e pabarazive).

Zbatimi i ligjit

Veprimi i propozuar mbështet objektivin e përgjithshëm të dritares 1 të IPA-s, me një fokus të veçantë në prioritetin tematik 3: Lufta kundër krimit të organizuar dhe siguria. Raporti i vlerësimit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (korrik 2023) thekson përparimin e dukshëm dhe sfidat e vazhdueshme në forcimin e shtetit të së drejtës/sundimit të ligjit dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Në përgjithësi, veprimi synon të intensifikojë përpjekjet për të luftuar rrjetet e krimit të organizuar, korrupsionin në nivele të larta dhe pastrimin e parave, duke forcuar aftësitë e inteligjencës, duke zhvilluar trajnime të rregullta dhe duke rritur operacionet e përbashkëta, në përputhje me prioritetet dhe masat e "Strategjisë për Luftën kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025" dhe "Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2024–2030".

Këto nisma janë plotësuese të "Agjendës së Reformës së Shqipërisë (2024)", e cila thekson nevojën për të forcuar luftën kundër krimit të organizuar dhe kornizave antikorrupsion. Veprimi synon të krijojë një sistem të qëndrueshëm dhe të besueshëm kundër pastrimit të parave dhe të lehtësojë zbatimin efektiv dhe në kohë të planit të veprimit të vlerësimit kombëtar të riskut (NRA/VKR) për vitet 2024–2027. Për më tepër, veprimi mbështet pjesëmarrjen aktive të Shqipërisë në EMPACT (*Platforma Evropiane Multidisiplinore kundër Kërcënimeve Kriminale*) dhe bashkëpunimin e ngushtë me EUROJUST-in *(Agjencia e Bashkimit Evropian për Bashkëpunim Gjyqësor në Çështjet Penale)*, EUROPOL-in *(Agjencia e Bashkimit Evropian për Zbatimin e Ligji)* dhe ENFAST-in *(Rrjeti Evropian i Ekipeve Kërkuese Aktive të të Arratisurve)*, EPPO-në *(*Zyra e Prokurorit Publik Evropian), OLAF-in *(Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit)* dhe INTERPOL-in *(Organizata Ndërkombëtare e Policisë Kriminale)*. Në përfundim, veprimi synon të mbështesë hetimin dhe ndjekjen penale të krimit mjedisor, në përputhje me direktivën e re të BE-së për krimin mjedisor. Këto prioritete i përgjigjen drejtpërdrejt komunikimit të Komisionit Evropian të vitit 2023 mbi politikën e zgjerimit të BE-së, e cila thekson nevojën që vendet kandidate të provojnë një arritje të fuqishme të hetimeve proaktive, ndjekjeve penale dhe vendimeve përfundimtare në çështjet e korrupsionit, krimit të organizuar dhe pastrimit të parave.

Demokracia

Objektivi kryesor i angazhimit të Bashkimit Evropian në Ballkanin Perëndimor është përgatitja e vendeve kandidate për të përmbushur kërkesat e anëtarësimit, duke përfshirë mbështetjen e funksionimit të institucioneve demokratike. Ky veprim përqendrohet konkretisht në: i. procesin zgjedhor, duke përfshirë funksionimin e administratës zgjedhore, median në fushatën zgjedhore dhe financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore; dhe ii. funksionimin e parlamenteve në një sistem demokratik. Në veçanti, do të fokusohet në garantimin që institucionet demokratike të jenë të pajisura me burime të mjaftueshme dhe të funksionojnë në mënyrë efektive, në përputhje me parimet kushtetuese, qeverisjen e mirë dhe rekomandimet e Komisionit të Venecias. Në këtë drejtim, veprimi do të kontribuojë në forcimin e funksioneve mbikëqyrëse parlamentare të Shqipërisë, përmirësimin e dialogut politik dhe rritjen e rolit të institucioneve demokratike.

Ky veprim mbështet Planin Kombëtar të Shqipërisë për Integrimin Evropian 2024–2026, duke kontribuar njëkohësisht në zbatimin e ndryshimeve ligjore të marsit 2023, që forcuan rolin e Parlamentit në procesin e integrimit në BE. Ai përparon qëllimet e Udhërrëfyesit të Dytë për Funksionimin e Institucioneve Demokratike, duke promovuar zgjedhje të lira dhe të ndershme, pluralizmin e medias dhe transparencën e partive politike, ndërkohë që rrit transparencën parlamentare, llogaridhënien (horizontale dhe vertikale), integritetin dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pavarura. Gjithashtu, ky veprim mbështet Udhërrëfyesin e Shtetit të së Drejtës/ Sundimit të Ligjit dhe Agjendën Kombëtare të Reformës, duke forcuar lirinë e medias, përmirësuar kapacitetin e Autoritetit të Mediave Audiovizive dhe duke garantuar autonomi rregullatore për të përafruar standardet kombëtare të medias me ato evropiane.

Fusha e mbështetjes #2: Qeverisje e Mirë, përafrimi me *acquis*-in e BE-së, marrëdhënie të mira fqinjësore dhe komunikim strategjik

Veprimet e propozuara mbështesin objektivin e përgjithshëm të dritares 2 të IPA-s: Qeverisja e Mirë

dhe Reforma e Administratës Publike, duke siguruar kapacitet institucional efektiv dhe menaxhim të qëndrueshëm financiar publik; si dhe duke mbështetur kapacitetin e administratës publike shqiptare për integrimin në BE.

Reforma e Administratës Publike, Shërbimi Civil, Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Reforma e Administratës Publike (RAP) mbetet prioritet kryesor i qeverisë shqiptare, duke shërbyer si instrument i rëndësishëm për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike dhe për përmbushjen e kërkesave të integrimit në BE. Kjo mbështetje është në përputhje me metodologjinë e avancuar të zgjerimit të Komisionit Evropian, ku reforma e administratës publike përfshihet në grupin 1, grupin e themelorëve, dhe për këtë arsye konsiderohet thelbësore për zbatimin e politikave dhe legjislacionit të BE-së.

Sipas qëndrimit të përbashkët të Bashkimit Evropian për grupin 1, Shqipëria ka bërë përparim të moderuar në kuadrin e Reformës së Administratës Publike (RAP). Strategjia e RAP-it (e parashikuar të miratohet më vonë në vitin 2025) synon të ndërtojë një administratë publike efikase, profesionale, të paanshme dhe të përgjegjshme, përfshirë dhe nivelin lokal, për t'i shërbyer më mirë qytetarëve dhe bizneseve. Këto ambicie pasqyrohen, gjithashtu, në Udhërrëfyesin e RAP-it të miratuar në kuadër të negociatave për anëtarësim.

Ky veprim mbështet drejtpërdrejt këto objektiva, duke forcuar kuadrin institucional, duke mbështetur një shërbim civil profesional dhe të bazuar në meritë, duke rritur transparencën dhe efikasitetin e menaxhimit të burimeve njerëzore në administratën publike; dhe duke ofruar mbështetje për forcimin e reformave administrative në sektorët kyç, me fokus të veçantë në sektorët e cenueshëm ndaj korrupsionit.

Qeverisje vendore dhe shumëniveleshe

Kuadri legjislativ i Shqipërisë për qeverisjen shumëniveleshe është në përputhje me standardet evropiane, siç pasqyrohet në ratifikimin e Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore.

Ky veprim kontribuon në zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, Kornizës Strategjike Kombëtare për Reformën e Administratës Publike dhe Udhërrëfyesit për PAR 2023–2030. Ai adreson prioritetet kryesore në kuadër të dritares 2 të Kuadrit Programues IPA III, konkretisht prioritetin tematik 1: Qeverisja e mirë dhe prioritetin tematik 2: Kapaciteti administrativ dhe përputhshmëria me *acquis*-in e BE-së.

Duke investuar në kapacitetet e administratës publike në nivel të qeverisjes vendore, veprimi synon të ndërtojë ekspertizën e nevojshme për zbatimin efektiv të politikave sektoriale dhe legjislacionit të miratuar. Ai, gjithashtu, siguron plotësueshmëri ndërsektoriale me iniciativat e ndërtimit të kapaciteteve administrative në kuadër të dritareve të tjera IPA, duke përforcuar një qasje të të gjithë qeverisë ndaj përmirësimeve të qeverisjes dhe ofrimit të shërbimeve.

Menaxhimi i financave publike (MFP), prokurimi publik, auditimi i jashtëm dhe statistikat

Veprimi do të mbështesë reformat e vazhdueshme në fushat e menaxhimit të financave publike, prokurimit publik, mobilizimit të të ardhurave të brendshme, auditimit të jashtëm dhe statistikave. Këto masa janë në përputhje me Kornizën Programuese IPA III dhe synojnë të arrijnë qëndrueshmëri fiskale, menaxhim efikas të financave publike, menaxhim të përmirësuar të burimeve publike dhe transparencë të përmirësuar.

Veprimi është në përputhje me Udhërrëfyesin për Reformën e Administratës Publike, e cila përfshin masa mbi menaxhimin e financave publike (MFP). Udhërrëfyesi thekson rëndësinë e menaxhimit transparent dhe të qëndrueshëm të financave publike për arritjen e objektivave politike, duke siguruar sisteme efektive kontrolli, prokurimi dhe mbikëqyrjeje. Ky veprim është, gjithashtu, në përputhje me Strategjinë për Menaxhimin e Financave Publike (2023–2030) të miratuar nga qeveria.

Veprimi, gjithashtu, përputhet me strategjinë afatmesme të të ardhurave të miratuar së fundmi, e cila synon të rrisë të ardhurat fiskale përmes përmirësimit të masave të politikës tatimore, si dhe reformave në administratën tatimore dhe doganore. Në fushat e taksimit, do t'i kushtohet vëmendje e veçantë përputhjes me *acquis*-in e BE-së dhe detyrimeve ndërkombëtare tatimore.

Veprimi do të mbështesë, gjithashtu, reformat e vazhdueshme në fushën e prokurimeve publike, siç kërkohet për anëtarësimin në BE dhe siç parashikohet në Strategjinë e Prokurimeve Publike të Qeverisë (2024–2030). Brenda fushës së prokurimit, do t'i kushtohet vëmendje e veçantë promovimit të prokurimit të gjelbër dhe social, në

përputhje me Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor; si dhe mbështetjes së reformave që lidhen me strategjitë më të zgjeruara kundër korrupsionit.

Kuadri programues IPA III identifikon përmirësimin e kapaciteteve të auditimit të jashtëm si prioritet në kuadër të përparësisë tematike 1: Qeverisja e mirë; dhe veprimi do të përfshijë mbështetje të dedikuar për institucionin e lartë të auditimit. Ky veprim do të mbështesë reformat mbi auditimin e jashtëm, të përfshira në Strategjinë për Menaxhimin e Financave Publike dhe në strategjinë e miratuar nga institucioni i lartë i auditimit të Shqipërisë. Masat kryesore përfshijnë forcimin e kuadrit rregullator, përmirësimin e metodologjive të auditimit dhe investimin në burimet njerëzore për të rritur efektivitetin e auditimit dhe komunikimin e gjetjeve të auditimit; ndërsa garantohet përputhja e vazhdueshme dhe e avancuar me standardet INTOSAI *(Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve të Larta të Auditimit)* dhe ISSAI *(Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve të Larta të Auditimit)*.

Së fundi, veprimi do të mbështesë fushën e statistikave. Përfundimet e përbashkëta të dialogut ekonomik dhe financiar 2024 ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor theksojnë rëndësinë e përputhjes së mëtejshme, duke nënvizuar modernizimin e proceseve statistikore, përmirësimin e mbledhjes dhe sigurisë së të dhënave, si dhe përmirësimin e infrastrukturës digjitale për të siguruar raportim statistikor të besueshëm. Përputhja e metodologjive statistikore me rregulloren e ESA-s (Sistemit Evropian të Llogarive) në fuqi është thelbësore për llogaritjen e treguesve kryesorë ekonomikë si GDP/PBB dhe GNI/BNP, duke mbështetur kështu përputhshmërinë e Shqipërisë me kërkesat e sistemit statistikor të BE-së. Veprimi do të mbështesë masat dhe reformat e përfshira në Programin e Statistikave Zyrtare të Shqipërisë 2022–2026 dhe pasuesin e tij, si dhe masat e kërkuara për anëtarësimin në BE (kapitulli 18 – statistika), me fokus të rëndësishëm në statistikat makroekonomike dhe financat publike; përmirësimin e menaxhimit dhe sigurisë së të dhënave dhe sigurisë kibernetike.

EUIF, Instrumenti Lehtësues për Integrimin Evropian

Qëllimi kryesor i këtij veprimi është të forcojë kapacitetin dhe llogaridhënien e administratës publike shqiptare në përgatitjet për anëtarësimin në BE. Në përputhje me kuadrin programues IPA III, ky objektiv është një prioritet ndërsektorial dhe plotëson ndërtimin e kapacitetit administrativ në kuadër të dritareve të tjera, në përputhje me qasjen sektoriale. Veprimi mbështet objektivat e prioritetit tematik 2, të dritares 2 të IPA-s, e cila fokusohet në forcimin e kapacitetit administrativ të vendit dhe përputhjen e politikave dhe legjislacionit të tij me kërkesat e BE-së, si dhe përmbushjen e detyrimeve të anëtarësimit në BE.

Mbështetja do të kontribuojë në përmirësimin e kapacitetit për të drejtuar procesin e reformës, duke përfshirë përmes koordinimit të zbatimit të Agjendës së Reformës dhe përputhjes dhe zbatimit të mëtejshëm të kërkesave të *acquis*-it të BE-së. Ky veprim, gjithashtu, mbështet prioritetin tematik 1, të dritares 2 të IPA-s, e cila fokusohet në qeverisjen e mirë dhe horizontalisht në dritaret e tjera të IPA III, duke kontribuar kështu në procesin e përgjithshëm të integrimit. **EUIF/ILIE *(Instrumenti Lehtësues për Integrimin Evropian)*** mbështet, gjithashtu, zbatimin e IPA III, përgatitjet në kuadër të kapitullit 22 të negociatave të anëtarësimit dhe ofrimin e mbështetjes për veprime individuale, duke qenë një mjet financiar fleksibël i aftë që të mobilizojë shpejt burime për nevoja emergjente për të mbështetur integrimin.

Fusha e mbështetjes #3: Agjenda e gjelbër dhe lidhshmëria e qëndrueshme & konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse

Veprimi i propozuar paraqitet si pasojë e Ligjit për Lëndët e Para Kritike (CRMA) të Bashkimit Evropian,[4] i cili krijon një kornizë për sigurimin e një furnizimi të sigurt dhe të qëndrueshëm të lëndëve të para kritike. Plani i Veprimit për Lëndët e Para Kritike[5] përcakton qartë objektivin e BE-së për të angazhuar vendet me burime të pasura, përfshirë Ballkanin Perëndimor, duke njohur rëndësinë e integrimit të Ballkanit Perëndimor në zinxhirët e furnizimit të BE-së. Objektivat e veprimit janë në

[4] Rregullorja (BE) 2024/1252, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 11 prill 2024, për krijimin e një kuadri për garantimin e furnizimit të sigurt dhe të qëndrueshëm të lëndëve të para kritike dhe për ndryshimin e rregulloreve (BE) nr. 168/2013, (BE) 2018/858, (BE) 2018/1724 dhe (BE) 2019/1020.

[5] Plani i Veprimit për Lëndët e Para Kritike, COM/KKE (Komunikimi i Komisionit Evropian) nr. 474, i vitit 2020, përfundimtar.

përputhje me kuadrin programues IPA III[6], veçanërisht në kuadër të dritares 4, të prioritetit tematik 2: Zhvillimi i sektorit privat, tregtia, kërkimi dhe inovacioni, ku qëllimi është përmirësimi i mjedisit të biznesit, ekosistemit të inovacionit dhe klimës së investimeve të përfituesve, duke promovuar integrimin me zinxhirët industrialë të vlerës së BE-së. Objektivat e veprimit janë, gjithashtu, në përputhje me dritaren 3 "Agjenda e gjelbër dhe lidhshmëria e qëndrueshme", Prioriteti tematik I: Mjedisi dhe ndryshimet klimatike, duke u fokusuar, gjithashtu, në rikthimin e degradimit mjedisor, uljen e niveleve të ndotjes industriale dhe kimike, si dhe asgjësimin e duhur të mbetjeve të rrezikshme dhe të nxjerra nga minierat.

Do t'i jepet vëmendje e veçantë prodhimit dhe përdorimit të qëndrueshëm të lëndëve të para kritike, të nevojshme për ekonominë e gjelbër dhe neutrale ndaj klimës, në përputhje me parimet e ekonomisë së gjelbër dhe të qarkullimit. Veprimi plotëson Planin e ri të Rritjes për Ballkanin Perëndimor dhe objektivin e tij për të integruar rajonin në zinxhirët industrialë të furnizimit të BE-së[7]**.** Veprimi është, gjithashtu, në përputhje të plotë me planin ekonomik dhe të investimeve për Ballkanin Perëndimor[8], ku një nga objektivat është "…të lehtësojë integrimin e zinxhirëve të vlerave industriale të qëndrueshme midis Ballkanit Perëndimor dhe BE-së, veçanërisht duke mbështetur prodhimin dhe përpunimin e qëndrueshëm të lëndëve të para, përfshirë lëndët kritike, duke siguruar tregti dhe investime të paanshme, në përputhje me standardet sociale, mjedisore dhe të transparencës të BE-së".

Për më tepër, veprimi përputhet plotësisht me Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor[9], e cila, në lidhje me ekonominë qarkore, përcakton objektivin për të synuar një model ku vlera dhe burimet ruhen sa më gjatë në ekonomi dhe gjenerimi i mbetjeve minimizohet[10], duke marrë parasysh se vendet e Ballkanit Perëndimor konsiderohen një nga zonat e ardhshme potenciale të furnizimit me minerale të Evropës.

2.2. Konteksti dhe analiza e problemit

Fusha e mbështetjes #1: Sundimi i ligjit, të drejtat themelore dhe demokracia

Sundimi i ligjit – Reforma e sektorit të drejtësisë

Reforma e drejtësisë, e vitit 2016, në Shqipëri mbetet një nga arritjet më të rëndësishme të vendit drejt forcimit të sundimit të ligjit, pavarësisë gjyqësore dhe përputhjes me standardet evropiane. U nis një proces i gjerë ristrukturimi, me qëllim krijimin e strukturave të reja të qeverisjes për të përmirësuar pavarësinë dhe llogaridhënien dhe për të garantuar menaxhim efektiv të sistemit të drejtësisë. Ndër zhvillimet më kritike institucionale pas reformës ishte krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGj) dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP). Këto organe u themeluan në vitin 2018 për të garantuar vetëqeverisjen e gjykatave dhe prokurorive, duke përfshirë menaxhimin e pavarur të karrierës gjyqësore, procesin e vlerësimit, ngritjes në detyrë dhe shkarkimit. Për më tepër, Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD) u themelua në vitin 2020, si institucioni i vetëm përgjegjës për hetimet disiplinore ndaj magjistratëve dhe ndaj anëtarëve të Këshillave si pjesë e Gjykatës së Lartë, përfshirë strukturat e SPAK-ut.

Procesi i vetingut ka luajtur rol thelbësor në rindërtimin e sistemit gjyqësor, duke garantuar integritetin dhe transparencën dhe aktualisht ndodhet në fazat përfundimtare. Reflektimi mbi rezultatet e tij dhe praktikat më të mira janë të domosdoshme në një kontekst ku ruajtja e nivelit të lartë të llogaridhënies në drejtësi është një qëllim kryesor i reformës së drejtësisë. Ndërsa Gjykata e Lartë aktualisht është e plotësuar me 19 gjyqtarë, vendet e lira në gjyqësor vazhdojnë të mbeten, duke

[6] Vendimi i Zbatuar i Komisionit, datë 10.12.2021, për miratimin e Kuadrit Programues të Instrumentit të Asistencës Paraanëtarësimit (IPA III) për periudhën 2021–2027.

[7] Komunikim i Komisionit drejtuar Parlamentit Evropian, Këshillit, Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian, dhe Komitetit të Rajoneve – Plani i ri i rritjes për Ballkanin Perëndimor, 8.11.2023, COM (Komunikimi i Komisionit Evropian) nr. 691, i vitit 2023.

[8] Komunikatë e Komisionit drejtuar Parlamentit Evropian, Këshillit, Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian, dhe Komitetit të Rajoneve – Plani Ekonomik dhe i Investimeve për Ballkanin Perëndimor, 6.10.2020, COM (Komunikatë e Komisionit Evropian) nr. 641, i vitit 2020.

[9] Dokumenti i Punës i Stafit të Komisionit – Udhëzime për Zbatimin e Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor që shoqëron Komunikatën nga Komisioni drejtuar Parlamentit Evropian, Këshillit, Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetit të Rajoneve, një plan ekonomik dhe investimesh për Ballkanin Perëndimor {SWD(2020) 223}.

[10] Agjenda Strategjike e Lëndëve të Para të EIT 2021–2027, Berlin, 15 mars 2021.

ndikuar në efikasitetin e gjykatave në të gjitha nivelet. Në vitin 2023, vetëm 60.5% e gjyqtarëve ishin në detyrë aktivë, dhe Gjykata e Apelit Tiranë funksiononte me më pak se 50% të kapacitetit të saj. Mungesa e magjistratëve i ka ngarkuar Shkollës së Magjistraturës përgjegjësi shtesë, e cila ka qenë e detyruar të rrisë pranimin nga 7–12 kandidatë në vit në të paktën 88 për të përmbushur kërkesat e sistemit gjyqësor.

Një udhërrëfyes gjyqësor u zbatua midis shkurtit dhe korrikut 2023, për të optimizuar burimet dhe për të përmirësuar efikasitetin. Kjo reformë bashkoi gjashtë gjykata apeli në një Gjykatë të vetme Apeli në Tiranë dhe uli numrin e gjykatave të shkallës së parë nga 22 në 13. Në të njëjtën kohë, ajo uli Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë nga 6 në dy, duke ruajtur vetëm një Gjykatë Administrative Apeli. Ndërsa organet e vetingut po i afrohen fundit të mandatit të tyre, përgjegjësia për mbikëqyrjen gjyqësore po kalon te Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD).

Këto institucione kërkojnë mbështetje të vazhdueshme për të siguruar që ato të përparojnë më tej në zbatimin e reformës, të ruajnë nivelin më të lartë të integritetit dhe të vazhdojnë zbatimin e standardeve të larta etike dhe të transparencës të përcaktuara gjatë procesit të vetingut. Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD), i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen disiplinore, përballet me kufizime në kapacitete, veçanërisht në plotësimin e pozicioneve kyçe. Prokuroria e Posaçme (ZPP) ka bërë përparim të konsiderueshëm në trajtimin e rasteve të profilit të lartë të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Megjithatë, dobësitë institucionale vazhdojnë, duke pasur parasysh zgjerimin e kapaciteteve hetimore të Zyrës Kombëtare të Hetimit (ZKH).

Ministria e Drejtësisë (MD) luan rol thelbësor në koordinimin e reformave gjyqësore, përafrimin e legjislacionit me *acquis*-in e BE-së, koordinimin e politikave, si dhe garantimin e funksionimit të duhur të çështjeve gjyqësore përkatëse, si ndihma juridike falas, shërbimet e provës ose profesionet e lira juridike, veçanërisht përdorimi alternativ i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Megjithatë, mbeten ende pak sfida, në lidhje me përmirësimin e hartimit ligjor, planifikimin strategjik, kapacitetet e raportimit dhe komunikimin strategjik mbi reforma të ndryshme, zgjerimin e shërbimeve juridike falas dhe cilësinë e profesioneve juridike falas, duke përfshirë reformat që lidhen me drejtësinë penale.

Efikasiteti gjyqësor mbetet një çështje thelbësore, e ndikuar kryesisht nga burimet njerëzore, lehtësirat, menaxhimi i burimeve njerëzore të kufizuara, mungesa e politikave të qeverisjes së koordinuara mirë, cilësia e trajnimeve dhe vendimmarrja në kohë dhe me ndikim nga të gjitha institucionet përkatëse. Si e tillë, kjo rezulton në një akumulim çështjesh të trajtuara me vonesë në të gjitha gjykatat, kohëzgjatje të procedurave, vonesë në publikimin e vendimeve të arsyetuara, cilësi të vendimeve, akses të kufizuar efektiv në informacion dhe dobësim të shërbimeve gjyqësore.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i cili është përgjegjës për kryerjen e hetimeve disiplinore, përballet me sfida të lidhura me burimet njerëzore dhe me nevojën për standardizim më të avancuar të procedurave dhe metodave, të cilat mundësojnë një vlerësim të hollësishëm të një çështje specifike, përfshirë verifikime të rregullta të të dhënave të deklarimeve të pasurisë. Për më tepër, administratës gjyqësore i mungon një sistem i integruar për menaxhimin e çështjeve, kryetarë gjykatash në të gjitha nivelet, përveç Gjykatës së Lartë, si dhe një udhërrëfyes për politika të koordinuara që do të përmirësonin cilësinë e menaxhimit dhe vendimmarrjes së gjykatave. Ky udhërrëfyes gjithëpërfshirës dhe zbatimi i tij kërkon një koordinim të përmirësuar midis të gjitha palëve përkatëse, por kryesisht midis Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGj), Këshillit të Lartë të Prokurorisë (KLP), Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD) dhe Shkollës së Magjistraturës (ShM).

Sipas dispozitave ligjore pas reformës së drejtësisë, raportimi i rregullt dhe mbledhja e të dhënave janë aktualisht një praktikë e zakonshme në të gjitha institucionet e drejtësisë, veçanërisht për shkak të detyrimit të tyre vjetor për të raportuar në parlament. Mungesa e një sistemi të integruar për menaxhimin e çështjeve, si dhe e një akti unik dhe gjithëpërfshirës rregullator për statistikat gjyqësore, bën që të dhënat e raportuara të mos jenë plotësisht të besueshme, pasi nuk lejojnë një analizë gjithëpërfshirëse dhe hartim politikash mbi këtë bazë në të gjitha nivelet. Si rezultat, roli i Ministrisë së Drejtësisë në koordinimin e politikave të sektorit të drejtësisë dobësohet, gjithashtu, nga kapaciteti i kufizuar analitik, boshllëqet në koordinimin me donatorët dhe komunikimi publik joefektiv, të cilat

të gjitha dëmtojnë përpjekjet për ndërtimin e besimit në sistemin e drejtësisë.

Sistemet e drejtësisë për të miturit dhe lirimit me kusht kanë kaluar, gjithashtu, nëpër reforma, por mbeten sfida në zbatimin e tyre. Korniza e drejtësisë për të miturit në Shqipëri përputhet me standardet ndërkombëtare, megjithatë vazhdojnë boshllëqet në sigurimin e një procesi ligjor të përshtatshëm për fëmijët dhe zbatimin e politikave të duhura dhe të koordinuara në të gjitha nivelet. Sistemi i lirimit me kusht, i cili luan një rol thelbësor në dënimet alternative, pengohet nga praktikat administrative të vjetruara, përfshirë mungesën e proceseve dhe dokumenteve të digjitalizuara, mungesën e burimeve njerëzore, trajnimeve dhe alokimeve buxhetore. Ndërsa aktualisht arkiva e lirimit me kusht është tërësisht në dokumente shkresore, mungesa e burimeve njerëzore dhe e hartimit të politikave krijon një sistem që nuk është plotësisht efektiv dhe paraqet rreziqe sigurie.

Edukimi ligjor kryhet nëpërmjet arsimit fillor në Fakultetin e Drejtësisë dhe arsimit të specializuar vetëm për gjyqtarët, prokurorët dhe këshilltarët ligjorë në Shkollën e Magjistraturës. Shkolla e Magjistraturës është pika e vetme e hyrjes në sistemin gjyqësor dhe si e tillë përbën pjesë themelore të cilësisë dhe integritetit të sistemit të drejtësisë. Ajo ofron trajnim fillestar për tre vjet për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët, si dhe trajnim të vazhdueshëm gjatë të gjithë karrierës së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Roli dhe kompetencat e Shkollës së Magjistraturës janë rritur që nga miratimi i reformës në drejtësi dhe si të tilla kanë sjellë nevojën për të rishikuar burimet e saj njerëzore, menaxhimin e brendshëm, cilësinë e trajnimeve që përshtaten me një realitet më dinamik në gjyqësor dhe pasqyrojnë sfidat e tij, duke nxitur trajnime të bazuara në aftësi dhe reflektim mbi provimin e pranimit.

Të drejtat themelore

Në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026, qeveria e Shqipërisë deklaroi angazhimin e saj të plotë për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave themelore të njeriut dhe për përputhshmërinë me detyrimet ndërkombëtare sipas sistemit të OKB-së, *acquis*-it të BE-së dhe standardeve të Këshillit të Evropës. Masa specifike për mbrojtjen dhe promovimin e të dhënave personale, lirinë e shprehjes, përfshirë lirinë dhe pluralizmin e mediave, antidiskriminimin, barazinë gjinore dhe të drejtat e grave, të drejtat e fëmijëve, të drejtat e pronës, të drejtat procedurale dhe të drejtat e viktimave të krimit janë të përcaktuara qartë në këtë dokument.

Për më tepër, Udhërrëfyesi për Sundimin e Ligjit[11] përcakton prioritetet për vazhdimin e përafrimit të kuadrit ligjor me *acquis*-in e BE-së, forcimin e kapaciteteve të institucioneve të të drejtave të njeriut dhe mundësimin e mbledhjes së të dhënave në fushën e të drejtave themelore, si dhe përmirësimin e mëtejshëm të të drejtave të personave të dënuar, të ndaluar ose të paraburgosur. Raporti vjetor për Shqipërinë 2023 dhe raporti i shqyrtimit për grupin 1 mbi bazat, ndonëse pranojnë se kuadri ligjor i Shqipërisë përbën një bazë të përgjithshme të mirë për mbrojtjen e të drejtave themelore, arritën në përfundimin se përpjekjet duhet të intensifikohen në nivel zbatimi. Raporti theksoi se Shqipëria "duhet të zhvillojë një sistem gjithëpërfshirës monitorimi dhe mbledhjeje të të dhënave për të vlerësuar nivelin e zbatimit të legjislacionit, politikave dhe strategjive të të drejtave të njeriut"[12].

Në fushën e të drejtave themelore, Ministria e Drejtësisë është institucioni kryesor përgjegjës për raportimin në Komisionin Evropian në kuadër të kapitullit 23 "Drejtësia dhe të drejtat themelore", përfshirë edhe në Agjencinë e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA). Aktorë të tjerë kryesorë shtetërorë janë: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si organi publik kryesor përgjegjës për hartimin e politikave mbi çështje të ndryshme të barazisë gjinore, të drejtave të fëmijëve, të drejtave të personave me aftësi të kufizuara dhe të drejtave të pakicave, si dhe për detyrat e raportimit mbi zbatimin e Konventave të ndryshme (CEDAW *(Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave),* Konventa e Stambollit, mbi të Drejtat e Fëmijës etj.); Ministria e Arsimit dhe Sportit; ministria përgjegjëse për punësimin; dhe Ministria e Brendshme. Parlamenti Shqiptar, INSTAT-i, Avokati i Popullit (Institucioni kombëtar për të drejtat e njeriut – NHRI), organet rregullatore të pavarura, shoqatat e autoriteteve vendore dhe këshilla kombëtarë të ndryshëm, të

[11] VKM-ja nr. 736, 13.12.2023.

[12] Raporti i shqyrtimit të Komisionit të BE-së për grupin 1, f. 30.

angazhuar në dialog politik, si dhe organizatat e shoqërisë civile, janë, gjithashtu, aktorë të rëndësishëm.

Zbatimi i ligjit

Angazhimi i qeverisë së Shqipërisë për forcimin e sundimit të ligjit është detajuar në Udhërrëfyesin për Sundimin e Ligjit 2024–2030, i cili u miratua në dhjetor 2023[13], dhe përcakton reforma ambicioze, përfshirë luftën kundër mashtrimit, parandalimin e pastrimit të parave, korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Kuadri ligjor bazohet kryesisht në Kushtetutën, Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale, së bashku me legjislacion specifik, si ligji nr. 10 192, datë 3.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurive" (Ligji Antimafia). "Strategjia për Luftën Kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025" përcakton objektiva specifikisht për luftën kundër lëndëve narkotike, krimit ekonomik dhe pastrimit të parave. Shqipëria ka miratuar, gjithashtu, një "Strategji Kombëtare për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit 2024–2030", zbatimi i së cilës koordinohet nga Njësia e Inteligjencës Financiare. Edhe pse Shqipëria u hoq nga lista e vendeve të monitoruara të FATF/GPVF (Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar) në 2024-ën, përputhshmëria e vazhdueshme me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare mbetet një prioritet. Vazhdon të ketë sfida në zbatimin e ligjeve për pastrimin e parave dhe zbatimin e plotë të regjistrit të pronarëve përfitues. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për t'u përafruar me *acquis*-in e BE-së mbi rikuperimin dhe sekuestrimin e pasurive dhe për të pasur një zyrë plotësisht funksionale për rikuperimin e aseteve (ARO/ZRA).

Qeveria e Shqipërisë ka prioritizuar luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në agjendën e saj kryesore politike; megjithatë, lufta efektive kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit pengohet nga zbatimi i papërshtatshëm i kuadrit ligjor dhe rregullator ekzistues. Mekanizmat e raportimit dhe monitorimit të politikave dhe strategjive kombëtare janë të dobëta, çka ndikon negativisht në një proces vendimmarrjeje të bazuar mbi informacion të saktë. Mekanizmat e zbatimit për sekuestrimin parandalues, konfiskimin pa bazë dënimi dhe konfiskimin ndaj palëve të treta nuk janë zbatuar plotësisht. Kjo përfshin ndjekjen e qarkullimeve/lëvizjeve financiare që mbështesin organizatat kriminale, zbatimin e detyrimeve të transparencës sipas regjistrit të pronarëve përfitues, si dhe arritjen e rezultateve më të forta në ndjekjen dhe dënimin e rasteve të pastrimit të parave. Zbatimi i ligjit për krimet mjedisore në Shqipëri është i dobët për shkak të mangësive strukturore, financimit të kufizuar dhe mungesës së ekspertizës. Inspektimet dhe monitorimi mbeten të dobëta, çka dobëson edhe më tej efektivitetin e zbatimit.

Gjithashtu, Akademia e Sigurisë së Shqipërisë përballet me mungesë trajnerësh të specializuar dhe përdor kurrikula të vjetëruara, të cilat pengojnë zhvillimin profesional të vazhdueshëm dhe specializimin e agjentëve të zbatimit të ligjit. Po ashtu, Shkolla e Magjistraturës duhet të sigurojë përditësimin e vazhdueshëm të kurrikulave, si dhe forcimin e ekspertizës së brendshme për të garantuar zhvillimin profesional të qëndrueshëm të prokurorëve dhe gjyqtarëve, përfshirë edhe fushat e krimit kibernetik dhe krimeve mjedisore.

Në Shqipëri, institucione të shumta janë të angazhuara në luftën kundër krimit të organizuar, përkatësisht Ministria e Brendshme (MB), Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (ASP/DPPSH), Agjencia për Administrimin e Pronës së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK) dhe Prokuroria e Përgjithshme. Për më tepër, departamente specifike në ASP dhe Inspektorati Kombëtar për Kontrollin e Territorit janë të angazhuara në inspektimin dhe parandalimin e krimeve mjedisore. Ministria e Financave, gjithashtu, luan një rol vendimtar, veçanërisht përmes Njësisë së Inteligjencës Financiare (FIU/NjIF) dhe Administratës Doganore Shqiptare.

Demokracia

Raporti i shqyrtimit të Komisionit të Bashkimit Evropian për grupin 1 mbi Themelorët, duke vlerësuar funksionimin e Parlamentit Shqiptar (f. 10–17) në monitorimin e zbatimit të ligjeve, politikave, buxheteve publike, përmbushjen e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe programeve qeveritare përmes komisioneve parlamentare,

[13] Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 736, datë 13.12.2023.

pyetjeve parlamentare dhe përdorimit të mjeteve parlamentare si seanca dëgjimore, hetime etj., shprehet se mbikëqyrja e ekzekutivit nga Kuvendi është e kufizuar. I njëjti përfundim nxirret edhe në lidhje me rolin mbikëqyrës të Kuvendit mbi punën e institucioneve të pavarura që kufizohet vetëm në shqyrtimin e raporteve të tyre vjetore. Gjithashtu, vlerësohet e nevojshme monitorimi sistematik i rekomandimeve të institucioneve të pavarura dhe ndjekja e tyre. Vlerësimet e ndikimit gjinor nuk kryhen rregullisht. Strategjia e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve 2022–2026 përmend burime të pamjaftueshme, mungesën e stafit të mirëtrajnuar dhe menaxhimin e dobët strategjik si pengesa për efikasitetin zgjedhor, ndërsa janë miratuar dispozita ligjore për më shumë transparencë në financimin e partive politike. Mbeten shqetësime, lidhur me përqendrimin e pronësisë së mediave, infiltrimin biznes-politikë dhe mungesën e masave mbrojtëse për rastet SLAPP *(Paditë Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike),* ndërsa kuadri kombëtar i mediave nuk përputhet me standardet e BE-së. Mediat e pavarura dhe grupet e gazetarëve, gjithashtu, kanë ngritur shqetësime mbi etikën në raportimin lidhur me çështjet gjinore.

Aktorët kryesorë përfshijnë Parlamentin, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Autoritetin e Mediave Audiovizive, organet rregullatore të pavarura dhe Aleancën e Grave Deputete.

Fusha e mbështetjes #2: Qeverisje e mirë, përputhje me *acquis*-in e BE-së, marrëdhënie të mira fqinjësore dhe komunikim strategjik

Shërbimi civil dhe menaxhimi i burimeve njerëzore

Në kuadër të integrimit në BE, Shqipëria miratoi Udhërrëfyesin për Reformën e Administratës Publike 2023–2030[14] bazuar në strategjinë ekzistuese për Reformën e Administratës Publike (PAR)[15], Strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike (PFM/MFP), Strategjinë e Decentralizimit dhe Qeverisjes Vendore, Strategjinë Antikorrupsion dhe Strategjinë për Agjendën Digjitale.

Në janar 2024 u krijua pozicioni i Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin [16]. Ndërkohë që udhëheq njëkohësisht agjendën qeveritare për zbatimin e politikave mbi menaxhimin dhe ndërtimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore në administratën publike, Ministri i Shtetit vepron, gjithashtu, si Koordinator Kombëtar Antikorrupsion. Ligji për Shërbimin Civil nr. 152/2013, parashikon se rekrutimi në shërbimin civil bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës, aftësisë profesionale dhe mosdiskriminimit. Kritere dhe procedurat e mobilitetit janë të përcaktuara qartë nga ligji dhe garantojnë parimin e orientimit drejt performancës. Pas një reforme të fundit të pagave, po zbatohen programe të veçanta për të tërhequr dhe mbajtur në punë nëpunës civil të kualifikuar. Procesi koordinohet nga Departamenti i Administratës Publike (DPA/DAP). Rritja e profesionalizimit të nëpunësve civilë është një domosdoshmëri që theksohet edhe më shumë nga ndryshimet në administratën publike, si dhe nga ndryshimet legjislative dhe zhvillimet teknologjike, përfshirë aftësitë e veçanta që kërkohen me urgjencë, në kuadër të procesit të anëtarësimit në BE. Kjo e bën të nevojshme hartimin e vazhdueshëm të programeve të përditësuara të mësimdhënies dhe zhvillimit për nëpunësit civilë, të cilat kombinojnë trajnimin me prani fizike me platformën digjitale të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA/SSHAP). Sistemi i informacionit për menaxhimin e burimeve njerëzore (HRMIS/SIMBNj) po plotësohet me të dhënat e nevojshme, megjithëse ndodhet ende në fazë të hershme; ai nuk mbulon ende të gjithë sektorin publik, nuk është plotësisht i përditësuar dhe ka ende nevojë të zgjerohet me funksionalitete shtesë. Qeveria po ndjek një proces të vazhdueshëm rishikimi të procedurave administrative, përfshirë digjitalizimin, riprojektimin e proceseve të biznesit dhe zbatimin e procedurave të përbashkëta administrative. Gjithashtu, qeveria ka nisur një proces të vlerësimit të riskut për integritetin dhe hartimit të planeve të integritetit në institucionet qeveritare në nivel kombëtar dhe lokal, me qëllim adresimin e rreziqeve specifike në aspektin e integritetit dhe korrupsionit. Ky proces po zgjerohet gradualisht drejt më shumë institucioneve qeveritare, me një fokus të veçantë në sektorët e ndjeshëm (duke përfshirë – por pa u kufizuar vetëm në – kadastrën, tatimet, doganën dhe arsimin). Si

[14] Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 737, datë 3.12.2023.

[15] Në proces konsultimi të brendshëm.

[16] Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 29, datë 17.1.2024.

rrjedhojë, veprimi mund të përfshijë mbështetje teknike për institucionet e zgjedhura qeveritare në zbatimin e disa prej reformave të parashikuara administrative, në përgjigje të vlerësimeve të rrezikut dhe planeve të integritetit, me fokus të veçantë në sektorët e ndjeshëm.

Palët e interesuara të reformës janë Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Departamenti i Administratës Publike, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Ministri i Shtetit për Qeverisjen Vendore dhe nëpunësit civilë që do të përfitojnë nga transformimi digjital i (HRM/MBNJ-së) në administratën publike shqiptare. Përveç kësaj, mbështetje mund t'u ofrohet subjekteve të zgjedhura qeveritare në bazë të reformave administrative në zbatimin e planeve të tyre të integritetit.

Qeverisja vendore dhe shumëniveleshe

Kuadri politik për decentralizimin dhe qeverisjen vendore përcaktohet nga Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030. Kuadri legjislativ i Shqipërisë për qeverisjen shumëniveleshe është në përputhje me standardet evropiane, mbështetur nga ratifikimi i Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore. Këshilli Konsultativ i Vetëqeverisjes Qendrore dhe Vendore, i krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave në dhjetor 2016, shërben si platformë e institucionalizuar për konsultim dhe dialog me autoritetet vendore.

Siç vërehet në Raportin e Komisionit për Shqipërinë për vitin 2024, nevojiten ende përpjekje për të përmirësuar burimet financiare, kapacitetin administrativ dhe autonominë fiskale të njësive të qeverisjes vendore. Në lidhje me procesin e integrimit në BE, zyrat e integrimit në BE janë ngritur në bashki, por u mungojnë kapacitetet për të përmbushur funksionet e tyre, ndërsa stafi bashkiak nuk është i trajnuar mjaftueshëm mbi çështjet e integrimit në BE dhe nuk është i përgatitur për pjesëmarrje në Politikën e Kohezionit dhe programet e BE-së në të ardhmen. Organizata ombrellë e bashkive të Shqipërisë nuk ka kapacitete të mjaftueshme për të vepruar si partner brenda partneritetit të qeverisjes shumëniveleshe për Politikën e Kohezionit dhe për të përfaqësuar anëtarët e saj në forumet teknike. Projekti Kombëtar i Vetëm për Investime, i ngritur nga qeveria për projektet investuese, nuk përfshin një listë projektesh zhvillimi bashkiake dhe/ose territoriale. Bashkitë shqiptare duhet të përgatiten për të pasur akses dhe për të përdorur me sukses fondet e BE-së pas anëtarësimit, përfshirë fondet e Kohezionit të BE-së, çka kërkon mjete të veçanta për zhvillim territorial të integruar, duke nënkuptuar konsolidimin e qeverisjes shumëniveleshe, në përputhje me Kodin Evropian të Sjelljes për Partneritetin.

Të gjithë aktorët përkatës, përkatësisht Ministri i Shtetit për Qeverisjen Vendore, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë (NAMA) dhe bashkitë, e njohin nevojën për të punuar në mënyrë të koordinuar për të përmirësuar kapacitetin administrativ të autoriteteve vendore, duke rezultuar në shërbime më të mira vendore dhe në zbatim efektiv të fondeve të BE-së.

Menaxhimi i Financave Publike (MFP), Prokurimi Publik, Auditimi i Jashtëm dhe Statistikat

Strategjia e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike (PFM) 2023–2030 përcakton drejtimet dhe prioritetet për të garantuar një sistem financash publike që promovon transparencën, përgjegjshmërinë, disiplinën fiskale, si dhe efikasitetin dhe barazinë në përdorimin e burimeve publike. Në mënyrë të ngjashme, Strategjia Afatmesme për Menaxhimin e Borxhit (MTDS) për vitet 2022–2026 synon të ulë rreziqet e rifinancimit, duke rritur lëshimin e borxhit afatgjatë dhe duke zbutur rreziqet nga norma e interesit dhe kursi i këmbimit.

Në përgjithësi, këto përpjekje pasqyrojnë një angazhim të përbashkët drejt një qeverisjeje fiskale më të fortë, me prioritet kryesor në politikën tatimore dhe fiskale, përfshirë Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave (MTRS) të sapo miratuar për vitet 2024–2027, e cila synon rritjen e të ardhurave dhe garantimin e stabilitetit financiar afatgjatë. Performanca fiskale mbetet e qëndrueshme, me rregulla fiskale të vendosura në kuadër të Ligjit Organik të Buxhetit[17]. Qeveria është zotuar, gjithashtu, për ngritjen e një këshilli fiskal të pavarur.

[17] Ligji Organik i Buxhetit (OBL/LOB) nr. 9936/2008, i ndryshuar.

Sistemi i prokurimit publik në Shqipëri rregullohet nga ligji nr. 162/2020 (i ndryshuar nga Ligji nr. 16/2024) dhe aktet nënligjore përkatëse, të cilat përcaktojnë që të gjitha proceset e prokurimit të kryhen në mënyrë elektronike, me akses publik në të gjitha njoftimet, dokumentet e tenderëve dhe materialet përkatëse. Strategjia Kombëtare për Prokurimin Publik 2024–2030 synon modernizimin e kuadrit, duke nxitur qëndrueshmërinë dhe efikasitetin, bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare.

Në lidhje me auditimin e jashtëm, në fund të vitit 2022, institucioni shqiptar i auditimit të lartë (ALSAI) miratoi Strategjinë e tij të Zhvillimit Institucional 2023–2027.

Instituti Kombëtar i Statistikave të Shqipërisë (INSTAT) luan rol qendror në mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare mbi fenomenet socio-ekonomike, në përputhje me standardet e Sistemit Statistik Evropian (ESS) dhe Sistemit Evropian Statistikor (ESA) në fuqi.

Menaxhimi i Financave Publike (MFP) në Shqipëri përballet me disa sfida, përfshirë mungesën e transparencës së buxhetit, rishikime të shpeshta të buxhetit në mënyrë *ad hoc*, dhe vlerësim të dobët të rrezikut fiskal. Duhet ende të krijohet një Këshill Fiskal për të forcuar përputhshmërinë me rregullat fiskale. Strategjia Afatmesme e të Ardhurave (MTRS) është miratuar së fundi dhe duhet të zbatohet, si në aspektin e politikës tatimore, ashtu edhe të reformave në administrimin tatimor. Rreziqet fiskale nga partneritetet publike-private (PPP), ndërmarrjet publike (SOE) dhe garancitë kërkojnë monitorim më të mirë, së bashku me përmirësimin e raportimit të borxhit për SOE-të për të ulur dobësitë fiskale. Planifikimi dhe ekzekutimi i investimeve kanë nevojë për përmirësim, duke përfshirë forcimin e zbatimit të vlerësimeve të ndikimit në mjedis (EIA) dhe vlerësimeve strategjike mjedisore (SEA) për menaxhimin e investimeve publike.

Prokurimi Publik është kryesisht në përputhje me standardet e BE-së, por mbetet në nivel të përgatitjes së moderuar. Ligjet për koncesionet dhe PPP-të kërkojnë harmonizim të mëtejshëm. Prokurimi konkurrues duhet të inkurajohet përmes kritereve ekonomikisht të favorshme dhe kontratave kuadër, ndërsa prokurimi i gjelbër kërkon rregullore më të qarta dhe stimuj financiarë.

Auditimi i Jashtëm (ALSAI/KLSH) përballet me kufizime kapacitetesh në auditimin e fondeve të BE-së, në integrimin e teknikave të avancuara të IT-së dhe në zgjerimin e mbulimit të auditimit. Sfidat përfshijnë personel të pamjaftueshëm, mundësi të kufizuara digjitale dhe nevojën për një komunikim më të mirë të rezultateve të auditimit. KLSH-ja synon të forcojë auditimet e integritetit, shqyrtimet e performancës në sektorin publik dhe përafrimin me standardet ndërkombëtare të auditimit (ISSAI 1 & ISSAI 10/*Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve të Larta të Auditimit*).

Statistikat dhe menaxhimi i të dhënave (INSTAT-i) mbeten pjesërisht të përafruara me *acquis*-in e BE-së, veçanërisht në llogaritë kombëtare, statistikat financiare dhe raportimin e të dhënave sektoriale. Është e nevojshme përputhja e plotë me metodologjinë ESA (*Sistemi Evropian i Llogarive*) në fuqi, sidomos për PBB-në tremujore, statistikat e punësimit dhe statistikat e financave të qeverisë. Vazhdon të ketë ende mangësi në statistikat mjedisore, përfshirë raportimin për mbetjet industriale dhe ambalazhet plastike. Lëvizja e lartë e stafit në INSTAT dobëson qëndrueshmërinë afatgjatë të të dhënave, ndërsa siguria digjitale dhe përmirësimet e infrastrukturës janë të domosdoshme për të garantuar integritetin e të dhënave. Zhvillimi i një sistemi gjithëpërfshirës të menaxhimit të të dhënave është thelbësor për përmirësimin e rezultateve zyrtare statistikore të Shqipërisë.

Menaxhimi i financave publike në Shqipëri koordinohet nga institucionet kryesore brenda Ministrisë së Financave. Një këshill fiskal i pavarur pritet të krijohet në vitet në vijim. Në fushën e prokurimit publik, Agjencia e Prokurimit Publik harton dhe monitoron politikat përmes një platforme të dhënash të hapura, ndërsa Komisioni i Prokurimit Publik trajton ankesat dhe Ministria e Financave, së bashku me ATRAKO-n *(Agjencinë e Trajtimit të Koncesioneve)*, menaxhon PPP-të dhe koncesionet. Gjithashtu, Kontrolli i Lartë i Shtetit forcon mbikëqyrjen financiare përmes kapaciteteve të përmirësuara të auditimit, ndërsa INSTAT-i koordinon Sistemin Kombëtar Statistikor.

Institucioni i integrimit në Bashkimin Evropian

Më 15 tetor 2024, në konferencën ndërqeveritare me Bashkimin Evropian, Shqipëria hapi **Grupkapitullin 1 – Themelorët**, i përbërë nga pesë

kapituj negociues [18]: Progresi në këto fusha përcakton ritmin e përgjithshëm të negociatave. Fundi i vitit 2027 u propozua si një objektiv i rekomanduar për përfundimin e përgatitjeve teknike për zbatimin e Politikës së Kohezionit të BE-së nga përfaqësuesit e Komisionit Evropian në përfundim të takimit dypalësh të shqyrtimit për kapitullin 22. Ky afat kohor ambicioz është marrë në konsideratë në qasjen ndaj përgatitjes së Planit të Veprimit për kapitullin 22. Për më tepër, Shqipëria ka përgatitur dhe i ka paraqitur Komisionit Agjendën e Reformës si pjesë e Instrumentit të Reformës dhe Rritjes (RGF) për Ballkanin Perëndimor. Agjenda e Reformës u miratua nga Komisioni, më 23 tetor 2024[19]. Reformat dhe investimet e parashikuara kanë potencialin të përshpejtojnë përgatitjet për anëtarësim në disa sektorë. Tri programet operative u miratuan me vendim të Komisionit në gusht 2024[20], zbatimi i të cilave në menaxhim indirekt nga Shqipëria iu besua tri Autoriteteve të Menaxhimit të sapokrijuara. Institucionet shqiptare do të zbatojnë fondet IPA dhe RGF paralelisht, me rregulla dhe mekanizma institucionalë të ndryshëm.

Në fushën e mbështetjes për integrimin në BE, negociatat dhe përafrimin, procesi i anëtarësimit të Shqipërisë menaxhohet nga një gamë e gjerë institucionesh, përfshirë Parlamentin, Këshillin e Ministrave dhe disa ministri. Procesi koordinohet përmes organeve, të tilla si Komiteti i Integrimit Evropian dhe Këshilli Kombëtar i Integrimit Evropian, të cilat punojnë për të përafruar legjislacionin kombëtar me *acquis*-in e BE-së dhe për të siguruar transparencë në marrjen e vendimeve. Aktorët kryesorë në këtë fushë përfshijnë Kryenegociatorin, i cili vepron përmes Sekretariatit të Integrimit Evropian, strukturat negociuese të krijuara për të menaxhuar procesin e anëtarësimit, si dhe disa ministri dhe autoritete kombëtare të angazhuara në mënyrë aktive në këto reforma.

Në mbështetje të integrimit të përshpejtuar, Plani i Rritjes dhe Agjenda e Reformave synojnë të sjellin përfitime të hershme nga anëtarësimi në BE për Shqipërinë, duke nxitur rritjen ekonomike dhe avancimin e konvergjencës socio-ekonomike. Këto iniciativa synojnë të përshpejtojnë reformat dhe investimet thelbësore, por kompleksiteti i tyre kërkon bashkëpunim të fortë ndërinstitucional dhe rritje të kapaciteteve administrative në menaxhimin financiar, monitorimin, raportimin dhe auditimin. Aktorët kryesorë të përfshirë janë Zyra e Kryeministrit, Ministria e Financave, Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, si dhe disa ministri dhe agjenci publike. Për sa i përket menaxhimit të ndihmës financiare të BE-së, zbatimi i kënaqshëm i IPA III, veçanërisht i Programeve Operacionale shumëvjeçare 2024–2027 në menaxhimin indirekt, kërkon aftësi të reja dhe rritje të kapaciteteve midis institucioneve të Shqipërisë: Autoritetet menaxhuese, strukturat ndërmjetëse, Koordinatori Kombëtar i IPA-së, SASPAC, njësitë IPA brenda ministrive të linjës dhe agjencive publike, Zyra Kombëtare e Autorizimit dhe Struktura e Menaxhimit të NAO-së/ ZKA-së, si dhe përfituesit përfundimtarë të ndihmës. Përgatitjet për Politikën e Kohezionit, të udhëhequra nga Negociatori i kapitullit 22 dhe të mbështetura nga Grupi Ndërinstitucional i Punës, do të duhet të adresojnë sfidat e konsiderueshme që priten gjatë perspektivës financiare 2028–2032, në lidhje me planifikimin e mirëfilltë dhe zbatimin e reformave dhe investimeve.

[18] Kapitulli 5 – Prokurimi Publik, kapitulli 18 – Statistikat, kapitulli 23 – Sistemi Gjyqësor dhe të Drejtat Themelore, kapitulli 24 – Drejtësia, Liria dhe Siguria, dhe kapitulli 32 – Kontrolli financiar.

[19] Vendimi zbatues i Komisionit, i datës 23.10.2024, për miratimin e Agjendave të Reformës dhe programit shumëvjeçar të veprimit, në kuadër të Programit të Instrumentit për Reformë dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor* {SWD(2024) 241 përfundimtar} - {SWD(2024) 242, përfundimtar} - {SWD *(Dokumenti i Punës i Stafit)* (2024) 243 përfundimtar} - {SWD(2024) 244 përfundimtar} - {SWD(2024) 245 përfundimtar } https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/commission-implementing-decision-approving-reform-agendas-and-multiannual-work-programme-under_en, C(2024) 7375 përfundimtar

[20] Vendimi zbatues i Komisionit, i datës 5.8.2024, mbi financimin e planit shumëvjeçar të veprimit për një Program Operacional mbi energjinë në favor të Republikës së Shqipërisë, për vitet 2024–2027, C(2024) 5758 përfundimtar; Vendimi zbatues i Komisionit, i datës 20.8.2024, mbi financimin e planit shumëvjeçar të veprimit për një Program Operacional mbi Ekonominë dhe Shoqërinë Digjitale në favor të Republikës së Shqipërisë, për vitet 2024–2027, C (2024) 5759 përfundimtar; Vendimi zbatues i Komisionit, i datës 20.8.2024, mbi financimin e planit shumëvjeçar të veprimit për një Program Operacional mbi BE-në për Punësimin e të Rinjve në favor të Republikës së Shqipërisë për vitet 2024–2027, C(2024) 5760, përfundimtar.

Për më tepër, ndërhyrjet e synuara janë të nevojshme për të adresuar nevojat e reja në disa sektorë, përfshirë mirëqenien e fëmijëve, bujqësinë, mjedisin, trashëgiminë kulturore, barazinë gjinore dhe doganat. Këto përfshijnë një gamë të gjerë aktorësh, nga Koordinatori Kombëtar i IPA-s dhe SASPAC-ut, tek bashkitë dhe koordinatorët lokalë për barazinë gjinore, si dhe entitete specifike sektoriale, si: Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministria e Bujqësisë, Administrata Doganore Shqiptare (ADSH), dhe Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve (AKEM). Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, organizatat e shoqërisë civile dhe Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Fusha e mbështetjes #3: Agjenda e gjelbër dhe lidhshmëria e qëndrueshme & Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse

Lëndët e para kritike janë thelbësore për ekonominë e Evropës. Ndërsa kërkesa globale rritet – veçanërisht për shkak të përpjekjeve për të dekarbonizuar ekonomitë – nevoja për këto materiale po shtohet. Parashikohet që kërkesa e BE-së për metale të rralla të tokës të rritet gjashtë herë deri në vitin 2030 dhe shtatë herë deri në vitin 2050. Aktualisht, Evropa mbështetet në masë të konsiderueshme në import, shpesh nga një vend i vetëm, dhe krizat e fundit kanë nxjerrë në pah dobësitë strategjike të BE-së.

Sipas Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, ekzistojnë 51 ngjarje/paraqitje gjeologjike të depozitave të Lëndëve të Para Kritike/Lëndëve të Para Strategjike (CRM/SRM)[21]. Në të gjitha këto raste, rezervat gjeologjike klasifikohen si të vogla dhe të mesme. Pikat kryesore të forcës për zhvillimin e sektorit të Lëndëve të Para Kritike (CRM) në vend janë depozitat e mëdha të Titanomagnetit, një depozitë nikel dhe disa depozita hekuri-nikeli me madhësi të vogël dhe të mesme që aktualisht po shfrytëzohen. Sektori i Lëndëve të Para Kritike njihet si një sektor potencialisht i rëndësishëm ekonomik në Shqipëri dhe është identifikuar si një nga sektorët më të rëndësishëm në Strategjinë e Specializimit të Zgjuar (S3), e cila përcakton objektiva dhe masa specifike për zhvillimin e këtij sektori. Qeveria e Shqipërisë, në bashkëpunim me Komunitetin e Inovacionit për Lëndët e Para i EIT-së *(Instituti Evropian për Inovacion dhe Teknologji),* ka themeluar Qendrën Rajonale të Inovacionit për Lëndët e Para Minerale me një vendim të Këshillit të Ministrave, në dhjetor 2023, me qëllim zhvillimin e sektorit CRM dhe rivitalizimin e sektorit minerar në përgjithësi.

Sfidat kryesore që lidhen me sektorin e CRM-së *(Lëndëve të Para Kritike)* janë nevoja për rishikim të sasisë dhe cilësisë përmes analizave minerale të depozitave aktuale; nevoja për përditësimin e kuadrit ligjor dhe strategjik minerar për t'u përputhur me direktivën më të fundit për lëndët e para kritike dhe për ta bërë vendin më tërheqës për investime; mungesa e infrastrukturës së përshtatshme kërkimore dhe e pajisjeve për studiuesit dhe SME-të *(ndërmarrjet e vogla dhe të mesme)* inovative në sektor; mungesa e menaxhimit mjedisor, rreziqet që lidhen me aspektet e sigurisë dhe aktivitetet minerare me shkallë të vogël pranë komuniteteve rurale të banuara; sfidat e lidhura me qeverisjen dhe transparencën në sektorin e burimeve natyrore; dhe ndihma e kufizuar e donatorëve për sektorin minerar në Shqipëri.

Për sa i përket kërkimit dhe shfrytëzimit CRM/SRM-së *(të lëndëve të para kritike/strategjike),* institucioni kryesor i politikave është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)[22], e cila do të jetë përfituesja kryesore e veprimit. Qendra Rajonale e Inovacionit[23] për Lëndët e Para, EIT në Shqipëri[24] është një entitet ligjor me buxhet publik në varësi të ministrit përgjegjës për minierat dhe industrinë. Misioni i saj është të koordinojë aktivitetin që lidhet me inovacionin dhe zhvillimin në sektorin e lëndëve të para, në bashkëpunim me Lëndët e Para EIT, me qëllim fuqizimin e rajonit me infrastrukturën e duhur për të shfrytëzuar potencialin e tij minerar dhe për të ndërtuar lidhje të forta midis Ballkanit Perëndimor dhe Evropës.

[21] Barit, fluorit, nikeli, titanomagnetiti, arseniku, boksiti, kobalti, magneziti, mangani, fosforiti dhe platini.

[22] VKM-ja nr. 111, 2.3.2022, "Për ndarjen e përgjegjësive për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë".

[23] Instituti Evropian i Inovacionit dhe Teknologjisë

[24] Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 697, datë 6.12.2023, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës Rajonale të Inovacionit të Institutit Evropian të Teknologjisë dhe Inovacionit për Lëndët e Para (Qendra Rajonale e Inovacionit të Lëndëve të Para EIT).

Aktorë të tjerë të interesuar publikë përfshijnë **Shërbimin Gjeologjik Shqiptar**[25] (AGS/SHGJSH) i cili është përgjegjës për eksplorimin dhe vlerësimin e mineraleve metalike dhe jometalike, materialeve industriale etj., si dhe **Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore**[26] (AKBN) e cila fokusohet në zhvillimin, mbikëqyrjen dhe shfrytëzimin racional të burimeve natyrore, si dhe në monitorimin e aktiviteteve passhfrytëzuese në sektorin minerar. Institucione të tjera publike me përgjegjësi potenciale, lidhur me ciklin e sektorit të lëndëve të para kritike/strategjike (CRM/SRM), nga kërkimi deri tek përpunimi, duhet të përcaktohen qartë në kuadrin e ri/të ndryshuar ligjor; duhet të krijohet një mekanizëm i fortë koordinimi, si dhe të realizohet ndërtimi i kapaciteteve për të adresuar boshllëkun e njohurive në këtë fushë relativisht të re.

2.3 Mësime të nxjerra

Projektet e mëparshme të financuara nga BE-ja kanë theksuar rëndësinë e zotërimit institucional për të mbështetur reformën e drejtësisë në Shqipëri. Ndërsa mbështetja e jashtme ka qenë thelbësore, institucione si: Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD), Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), Inspektorati i Lartë i Drejtësisë (ILD) dhe Ministria e Drejtësisë (MD) ende kërkojnë ndërtim kapacitetesh në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe planifikimin strategjik për të garantuar qëndrueshmëri afatgjatë. Projektet aktuale, si EU4Justice, SoM Twinning, JUST-AL dhe SEJ IV, kanë theksuar nevojën për koordinim më të fuqishëm ndërmjet institucioneve të drejtësisë, përmirësim të planifikimit afatgjatë të politikave dhe forcim të komunikimit strategjik për të rikthyer besimin e plotë në sistemin gjyqësor. Vendimmarrja e bazuar në të dhëna të besueshme mbetet një sfidë për shkak të mungesës së një sistemi të unifikuar për statistikat gjyqësore. Për më tepër, çështjet e prapambetura gjyqësore, mungesa e burimeve njerëzore dhe kohëzgjatja e theksuar e procedimeve theksojnë nevojën për masa vendimtare dhe për veprime koordinuese nga institucionet qeverisëse, po aq sa edhe për përmirësimin e performancës së gjykatave në të gjitha nivelet. Në të njëjtën kohë, mbështetja e vazhdueshme dhe forcimi i Shkollës së Magjistraturës në të gjitha kompetencat dhe funksionet e saj, duke përfshirë edhe zgjerimin e bashkëpunimit me rrjetet evropiane të trajnimit ligjor, mbetet nevojë thelbësore për të garantuar cilësi dhe progres të qëndrueshëm të sistemit gjyqësor për të gjitha gjeneratat e ardhshme.

Për sa i përket luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, mekanizmat e dobët të raportimit mbi strategjitë kombëtare ndikojnë në procesin e vendimmarrjes dhe koordinimin me donatorët. Nevojitet një bashkëpunim më i mirë ndërinstitucional për të adresuar krime komplekse, si trafikimi i qenieve njerëzore dhe kontrabanda e drogës. Sfidat në nivel të përfituesve përfshijnë nevojën për angazhim organizativ në ndërtimin e kapaciteteve, avancim karriere bazuar në meritë, si dhe reforma të qëndrueshme ligjore dhe strukturore për të ruajtur përmirësimet e financuara nga donatorët. Krijimi i partneriteteve afatgjata me organizata ndërkombëtare nxit ndarjen e vazhdueshme të njohurive.

Strukturat qeveritare duhet të krijojnë mekanizma sistematikë angazhimi dhe veprime pasuese për të forcuar pjesëmarrjen demokratike. Forcimi i institucioneve të pavarura është jetik për ruajtjen e kontrolleve dhe balancave. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) kërkon kapacitete të zgjeruara institucionale dhe teknike për të siguruar zgjedhje të lira dhe të ndershme. Mbrojtja e pluralizmit të medias kërkon një Autoritet të Medias Shqiptare (AMA) më të pavarur, transparencë më të madhe në pronësinë e medias dhe mbikëqyrje më të rreptë të medias *online*. Një mësim kyç është nevoja për konsultime publike gjithëpërfshirëse dhe transparente me shoqërinë civile dhe median.

BE-ja ka ofruar mbështetje afatgjatë për fushat e parashikuara, në kuadër të veprimit për qeverisje të mirë (PAR, MFP, qeverisja vendore, statistikat, auditimi i jashtëm), duke përfshirë së fundi mbështetjen në kuadër të Programit IPA 2020 të BE-së për qeverisje të mirë; si dhe përmes një numri programesh rajonale. Përvoja nga këto programe tregon rëndësinë e angazhimit të fuqishëm politik, dialogut politik dhe koordinimit midis sektorëve; duke pasur parasysh natyrën ndërsektoriale të reformave të mbështetura. Ndihma teknike mbetet e rëndësishme për zbatimin e mëtejshëm të këtyre

[25] Veprimtaria e AGS/SHGJSH-së rregullohet nga ligji nr. 111/2015, datë 15.10.2015, "Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar".

[26] VKM-ja nr. 547, 9.8.2006, e ndryshuar, "Për Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore".

reformave, veçanërisht tashmë që fokusi është gjithnjë e më shumë në përafrimin e plotë dhe përfundimtar me *acquis-in* dhe praktikat e BE-së.

Mbështetja për një forcim të gjerë të potencialit të ndërtimit të kapaciteteve të administratës publike shqiptare është e rëndësishme për të përmirësuar atraktivitetin e sektorit publik për stafin dhe reagimin e tij ndaj sfidave të paraqitura nga procesi i pranimit. Sistemi HRMIS *(Sistemi i Informacionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore)* është mbështetur më parë dhe është i rëndësishëm për të mbështetur përmirësimet e vazhdueshme, dhe në veçanti integrimin më të mirë me funksione të tjera administrative dhe përdorimin e zgjeruar të mundësive digjitale. Përveç kësaj, do të mbetet e rëndësishme për reformën e procesit institucional dhe administrativ në funksion të luftës kundër korrupsionit, duke u bazuar në vlerësimet e rrezikut dhe planet e integritetit të zhvilluara nga institucionet (shpesh me mbështetjen e BE-së), veçanërisht në sektorin e cenueshëm ndaj korrupsionit.

Mbështetja e BE-së për qeverisjen vendore ka qenë e gjerë, por shpesh mungon integrimi në planet e zhvillimit të komunave, çka ndikon në qëndrueshmërinë e saj. Ndihma e ardhshme duhet të përputhet me strukturat institucionale vendore për të përforcuar ndikimin afatgjatë. Barazia gjinore nuk është trajtuar në mënyrë sistematike në veprimet e financuara nga BE-ja, dhe pjesëmarrja e qytetarëve në qeverisjen vendore mbetet një fushë që kërkon mbështetje të mëtejshme. Veprimi IPA 2026 do të bazohet në mësimet e nxjerra nga iniciativat e mëparshme, duke përfshirë edhe programin e ardhshëm IPA 2024 **"EU4Local Governance" ("BE4Qeverisja Lokale")**.

Nevoja për një kapacitet më të fortë institucional për të koordinuar reformën e Menaxhimit Financiar Publik (PFM) si në nivel qendror, ashtu edhe në nivel vendor mbetet një prioritet. Garantimi i përputhshmërisë midis planifikimit strategjik dhe proceseve buxhetore afatmesme është thelbësor për stabilitetin fiskal afatgjatë, si dhe për përmirësimin e gjenerimit të të ardhurave të brendshme, ku Shqipëria ende mbetet pas vendeve anëtare të BE-së. Nismat e fundit në prokurimin publik kanë forcuar transparencën dhe llogaridhënien, por ndërtimi i vazhdueshëm i kapaciteteve mbetet i nevojshëm për të ruajtur përmirësimet. Përfshirja e shoqërisë civile dhe monitorimi i pavarur luajnë rol kyç në parandalimin e korrupsionit dhe përmirësimin e mbikëqyrjes së prokurimit, dhe duhet të përfshihen në hartimin e projekteve.

Në auditimin e jashtëm, **ALSAI**/KLSH *(Institucioni i Lartë i Auditimit në Shqipëri)* ka bërë përparim në përputhjen e praktikave të saj me standardet ndërkombëtare dhe në forcimin e auditimit të performancës. Bashkëpunimi me SAI-të/ISA-të *(Institucionet e Larta të Auditimit)* të vendeve evropiane dhe organet kundër korrupsionit (me mbështetje të BE-së) ka sjellë vlerë të shtuar, por mbështetja e mëtejshme mbetet e rëndësishme, përfshirë edhe në fushën e komunikimit të rezultateve të auditimit.

Për sa i përket statistikave, projektet e mëparshme kanë treguar rëndësinë e një mbështetjeje të fortë institucionale të kapaciteteve të zhvilluara, për të ruajtur kapacitetet në INSTAT dhe në anëtarë të tjerë kyç të sistemit statistikor kombëtar. Ndihma është, gjithashtu, e nevojshme për përdorimin më të gjerë të të dhënave administrative, menaxhimin e të dhënave dhe sigurinë kibernetike. Forcimi i transparencës dhe aksesueshmërisë së të dhënave mbetet thelbësor për vendimmarrjen e bazuar në prova.

Në kuadër të integrimit në BE, asistenca teknike ka rezultuar efektive në forcimin e kapacitetit të Kryenegociatorit të Shqipërisë, ministrive përkatëse dhe institucioneve publike për të kryer vlerësime bilaterale, për të hartuar udhërrëfyes dhe për të përditësuar Planin Kombëtar për Integrimin Evropian. Megjithatë, mbështetja e gjerë koordinuese duhet të zvogëlohet dhe të zëvendësohet me mbështetje të synuar dhe konkrete për të ndihmuar agjencitë individuale të përmbushin standardet specifike të BE-së. Përpjekjet për menaxhimin e ndihmës financiare të BE-së dhe përgatitjen për Politikën e Kohezionit kanë theksuar mangësi në veprimet e mëparshme të mbështetjes.

Mbështetja e kufizuar për përgatitjet e Politikës së Kohezionit thekson më tej nevojën për një qasje më gjithëpërfshirëse dhe të mirëkoordinuar, veçanërisht kur përputhen kërkesat komplekse të kapitullit 22 me fusha të tjera të politikave. Së fundi, projektet e synuara që adresojnë nevojat e reja kanë theksuar efektivitetin e qasjeve të integruara dhe me aktorë të shumtë.

Ndërsa Shqipëria i është bashkuar Programit të Bashkimit Doganor, duke i mundësuar akses në iniciativa për ngritjen e kapaciteteve të lidhura me

ndryshimet në vijim, në kuadër të Bashkimit Doganor, ajo ka përfituar, gjithashtu, nga një projekt binjakëzimi dhe nga mbështetje teknike për integrimin e saj në sistemet TARIC, si edhe nga programe rajonale në mbështetje të lehtësimit të tregtisë në kuadër të CEFTA-s (përfshirë edhe në fushën e doganave).

Mësimet e nxjerra nga zbatimi i programit në vijim IPA 2021 EU4 *Circular Economy* (BE Ekonomia Qarkore) tregojnë sesi bashkitë, ashtu edhe AKEM-i, nuk kanë fonde dhe kapacitete të mjaftueshme për të krijuar dhe menaxhuar një sistem efikas të menaxhimit të mbetjeve. Ndërsa një Sistem Funksional i Integruar Administrativ dhe i Kontrollit (IACS) në Shqipëri është parakusht për t'u bashkuar me Politikën e Përbashkët Bujqësore (CAP), i cili ende nuk është krijuar; megjithatë, programi EU for Property Rights (BE-ja për të Drejtat e Pronave) mbulon hapat e parë drejt krijimit të LPIS-it dhe pilotimit fillestar të tij.

Për më tepër, që nga viti 2023, Shqipëria ka marrë pjesë si vëzhguese në një projekt pilot për vendet në zgjerim, në kuadër të Instrumentit të Mbështetjes Teknike [27]. Qëllimi i projektit pilot është përshpejtimi i anëtarësimit të vendeve në zgjerim në BE, duke krijuar lidhje midis vendeve në zgjerim dhe shteteve anëtare të BE-së, dhe duke i njohur vendet e zgjerimit me llojet e reformave dhe projekteve që realizohen nga shtetet anëtare të BE-së pas anëtarësimit. Në veçanti, Shqipëria merr pjesë në dy projekte me objektiva të përgjithshëm për përmirësimin e pjesëmarrjes qytetare përmes teknologjive të reja dhe përfshirjen e qëndrueshmërisë në financat publike vendore.

3. PËRSHKRIMI I VEPRIMIT (ÇFARË)

3.1. Logjika e ndërhyrjes

Objektivi i përgjithshëm (ndikimi) i këtij veprimi është:

Forcimi i shtetit të së drejtës/sundimit të ligjit, qeverisjes, rezultateve konkrete në luftën kundër krimit të organizuar, sigurisë, kapaciteteve administrative, si dhe zhvillimit ekonomik dhe industrial, me qëllim përshpejtimin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Produktet (objektivat specifike) janë:

1. Forcimi i shtetit të së drejtës në Shqipëri përmes kornizave të fuqizuara ligjore, zbatimit efektiv të politikave mbi të drejtat e njeriut, barazisë dhe të drejtave të pronësisë të përafruara me standardet e BE-së, si dhe përmes avancimit të kapaciteteve, koordinimit dhe llogaridhënies së institucioneve gjyqësore, të rendit dhe demokratike.

2. Forcimi i qeverisjes së mirë në nivel qendror dhe vendor, i përpjekjeve kundër korrupsionit, administratës publike, menaxhimit të financave publike dhe kapaciteteve statistikore, si dhe avancimi i procesit të integrimit në BE, menaxhimi efektiv i ndihmës së BE-së dhe i përgatitjeve për Politikën e Kohezionit.

3. Rritja e integrimit ekonomik, konkurrueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sektorit të lëndëve të para kritike të Shqipërisë në zinxhirët e vlerës industrialë të BE-së, në përputhje me standardet e BE-së.

Produktet janë (kjo nuk është listë e plotë):

1.1 Forcimi i qeverisjes, kapaciteteve institucionale dhe vendimmarrjes së bazuar në prova në sektorin e drejtësisë, duke përfshirë gjykatat, shërbimet e prokurorisë dhe organet e posaçme hetimore.

1.2 Garantimi i vazhdimësisë së kapaciteteve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM) për të ushtruar mandatin e tij.

1.3 Përmirësimi i shërbimeve të drejtësisë për të mitur, duke përfshirë rehabilitimin e favorshëm për fëmijët dhe programe joizoluese, së bashku me forcimin e kapaciteteve për trajnim, kërkim shkencor dhe inovacion në Shkollën e Magjistraturës.

1.4 Rritja e kapaciteteve të autoriteteve kombëtare shqiptare për të mbrojtur të drejtat e njeriut, për të promovuar barazinë – duke përfshirë barazinë gjinore – dhe për të garantuar monitorimin dhe zbatimin efektiv të Kartës së të Drejtave Themelore.

1.5 Forcimi i kuadrit ligjor, kapaciteteve institucionale dhe efektivitetit operacional për luftimin e rrjeteve të krimit të organizuar, korrupsionit në nivelet e larta, pastrimit të parave, ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit, si dhe krimeve mjedisore.

1.6 Mbikëqyrje parlamentare e forcuar, integritet zgjedhor dhe liri e medias, duke përfshirë rritjen e llogaridhënies, kapaciteteve institucionale dhe

[27] Rregullorja (BE) 2021/240, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 10 shkurt 2021, për krijimin e një instrumenti mbështetjeje teknike, FZ/OJ L 57, 18.2.2021, f. 1–16 https://eur-lex.europa.eu/eli/reg/2021/240/oj/eng".

mbrojtjeve ligjore për të garantuar transparencë, gjithëpërfshirje dhe qëndrueshmëri demokratike.

2.1 Forcimi i efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimit civil nëpërmjet ndërtimit të kapaciteteve të avancuara, përdorimit të mjeteve moderne të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe modernizimit të vazhdueshëm të proceseve administrative në përputhje me planet e integritetit.

2.2 Kapacitete më të mira institucionale dhe administrative të organeve kryesore të qeverisjes vendore dhe modele të pilotuara në përputhje me BE-në për zhvillim të integruar territorial.

2.3 Forcimi i transparencës dhe i kapaciteteve institucionale në menaxhimin e financave publike (PFM) dhe të të ardhurave të brendshme, përmirësimi i mbrojtjes së të dhënave, kapaciteteve për auditimin e jashtëm, si dhe përmirësimi i prodhimit të të dhënave statistikore dhe i infrastrukturës së të dhënave në përputhje me kërkesat e BE-së.

2.4 Përmirësimi i kapaciteteve institucionale për menaxhimin e procesit të negociatave me BE-në, zbatimin e transpozimit ligjor, zbatimin dhe respektimin e ligjeve, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi integrimin në BE.

2.5 Forcimi i mbështetjes së BE-së, duke përfshirë programet e bashkimit, përgatitjen e projekteve, nevojat për monitorim dhe vlerësim, përgatitjet për politikën e kohezionit, si dhe mbështetje të synuar për sektorët socialë, doganat, mjedisin, bujqësinë, kulturën, barazinë gjinore dhe nevojat e tjera emergjente.

2.6 Rritja e kapaciteteve për menaxhimin e të gjitha proceseve, lidhur me integrimin e përshpejtuar në rajon dhe me tregun e përbashkët të BE-së, përfshirë koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të **Agjendës së Reformave të Shqipërisë** të Programit të Reformës dhe Rritjes.

2.7 SME-të përfitojnë nga mundësitë e ekonomisë qarkore për rritjen e efikasitetit të burimeve dhe fitojnë qasje në teknologji inovative.

3.1 Përmirësimi i kuadrit strategjik dhe politik, të përafruar me BE-në, për lëndët e para kritike /strategjike (CRM/SRM) dhe ekonominë qarkore, me fokus të veçantë në avancimin e praktikave të menaxhimit mjedisor.

3.2 Burimet parësore dhe dytësore të furnizimit për lëndët e para kritike/strategjike (CRM/SRM) dhe opsionet për të zvogëluar gjurmën e konsumit dhe për rritjen e shkallës së përdorimit rrethor të materialeve të vlerësuara dhe të kartografuara.

3.3 Vlerësohet ndikimi social dhe mjedisor nga industria nxjerrëse dhe përpunuese, si dhe ripërdorimi i mbetjeve minerare si një burim potencial dytësor për lëndët e para kritike/strategjike (CRM).

3.4 Forcimi i kapaciteteve për kërkime, inovacione, rrjetëzime dhe investime brenda ekosistemit shqiptar të lëndëve të para kritike/ strategjike (CRM/SRM) dhe rrjeteve të ekonomisë qarkore.

Listë indikative e aktiviteteve:

Aktivitete të lidhura me produktin 1.1:

- Të ofrohet këshillim dhe të forcohen më tej kapacitetet e institucioneve të qeverisjes së sistemit gjyqësor (KLGJ, KLP dhe KLD) për ushtrimin e kompetencave të tyre, me qëllim sigurimin e masave të koordinuara për rritjen e efikasitetit gjyqësor, përmirësimin e komunikimit strategjik dhe transparencës, kryerjen e vlerësimeve cilësore dhe promovimeve në karrierë, dhënien e këshillave mbi rishikimin ligjor dhe hartimin e akteve nënligjore, rishikimin e standardeve etike, si dhe forcimin e kapaciteteve të brendshme përmes trajnimeve dhe shkëmbimit të përvojave me institucione të ngjashme të shteteve anëtare të BE-së;

- Të forcohen kapacitetet menaxhuese të gjykatave, të reduktohet numri i çështjeve të mbetura pezull dhe kohëzgjatja e proceseve, të sigurohet vlerësimi i nevojave dhe të rritet transparenca nëpërmjet aksesit në dosje dhe administrimit të shërbimeve gjyqësore. Kur është e zbatueshme, të punohet ngushtësisht me Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese për vendosjen e standardeve në vendimmarrjen gjyqësore, zhvillimin e kërkimit dhe përmirësimin e cilësisë së vendimeve gjyqësore, me synim ruajtjen e frymës së Reformës në Drejtësi në të gjitha aspektet e saj, si dhe forcimin e rolit të Ministrisë së Drejtësisë (MdD);

- Të garantohet transferimi i duhur i standardeve dhe kompetencave të procesit të rivlerësimit kalimtar (veting), kur është e zbatueshme, tek institucionet përkatëse të drejtësisë;

- Të forcohen kapacitetet për zbatimin e praktikave të drejtësisë restauruese, me qëllim promovimin e rehabilitimit dhe reduktimin e përsëritjes së veprave penale, nëpërmjet një sistemi të përforcuar të shërbimit të provës, duke ndihmuar në rekrutimin, trajnimin dhe zhvillimin e praktikës

së stafit të provës, si dhe nëpërmjet digjitalizimit të dokumenteve dhe proceseve;

- Të hartohen dhe zbatohen aktet nënligjore për kuadrin statistikor dhe të menaxhimit të të dhënave në sektorin e drejtësisë, përfshirë analizën e të dhënave të ndara sipas gjinisë, si dhe të ofrohet mbështetje për trajnimet dhe praktikat e punës për Ministrinë e Drejtësisë, me qëllim ofrimin e analizave cilësore të të dhënave, raportimeve dhe hartimit të akteve ligjore mbi bazën e politikave të orientuara nga të dhënat;

- Të forcohet trajnimi gjyqësor i Shkollës së Magjistraturës nëpërmjet përmirësimit të mëtejshëm të provimit të pranimit, përditësimit të kurrikulës me tema të reja ligjore të përafruara me *acquis-in* e BE-së, përmirësimit të trajnimeve mbi aftësitë, standardet e integritetit dhe praktikat më të mira, forcimit të programit të mentorimit, si dhe garantimit të përdorimit më të mirë të teknologjisë digjitale për të nxënë dhe mbledhur të dhëna. Gjithashtu, të forcohen kapacitetet menaxhuese dhe ato të rekrutimit për stafin e përhershëm dhe jo të përhershëm të trajnimit.

Aktivitete të lidhura me produktin 1.2:

- Ofrimi i mbështetjes së nevojshme operacionale për të lehtësuar funksionimin efektiv të detyrave të ONM-së (Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit) deri në përfundim të procesit të rivlerësimit (ankimeve);

- Lehtësimi i monitorimit dhe raportimit të vazhdueshëm të procedurave të seancave në Dhomën e Apelimit dhe, nëse çmohet e nevojshme, formulimi i opinioneve kundërshtuese.

Aktivitete të lidhura me produktin 1.3:

- Zbatimi i një qasjeje të integruar për drejtësinë dhe rehabilitimin miqësor ndaj fëmijëve, përmes forcimit të kuadrit rregullator, rritjes së kapaciteteve institucionale me anë të trajnimeve të specializuara, përafrimit të dispozitave ligjore me standardet ndërkombëtare, integrimit të modelit *Barnahus* për mbështetje gjithëpërfshirëse të viktimave, si dhe mbështetjes së Qendrës Kombëtare për Rehabilitimin dhe Riintegrimin e Fëmijëve dhe të Rinjve në Konflikt me Ligjin;

- Hartimi i kuadrit rregullator për Qendrën Kombëtare për Rehabilitimin dhe Riintegrimin e Fëmijëve dhe të Rinjve në Konflikt me Ligjin, dhe mbështetja e autoriteteve të drejtësisë me udhëzime mbi prioritetin e interesit më të lartë të fëmijës gjatë procedimeve ligjore;

- Mbështetja e monitorimit dhe raportimit cilësor për Strategjinë e Drejtësisë për Fëmijët dhe Strategjinë e Mbrojtjes së Viktimave, si dhe kryerja e kërkimeve me qasje sensitive ndaj gjinisë mbi kriminalitetin e të miturve dhe viktimizimin e fëmijëve, me qëllim orientimin e zhvillimeve të ardhshme të politikave.

Aktivitete të lidhura me produktin 1.4:

- Ofrimi i këshillave për hartimin e politikave dhe forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve institucionale të organeve publike për t'u përafruar me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare për të drejtat e njeriut;

- Asistencë në mbledhjen dhe monitorimin e të dhënave, përfshirë të dhënat e ndara sipas gjinisë, për të ndjekur zbatimin dhe raportimin mbi të drejtat e njeriut dhe barazinë, si dhe fuqizimin e OSHC-ve në monitorimin e të drejtave;

- Krijimi i një pike kontakti për Kartën dhe mekanizmave të përputhshmërisë, lidhur me kushtëzimet për Politikën e Kohezionit.

Aktivitete të lidhura me produktin 1.5:

- Ofrimi i asistencës teknike mbi kuadrin ligjor të përafruar me BE-në, përmirësimin e monitorimit të politikave dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në luftën kundër krimit të organizuar, pastrimit të parave, rikuperimit të aseteve dhe korrupsionit;

- Rritja e kapaciteteve për ndjekjen penale të krimit të organizuar, krimit kibernetik, veprave penale financiare dhe krimeve mjedisore, duke përdorur teknika të avancuara hetimore, lehtësimi i bashkëpunimit me agjencitë e BE-së dhe pajisja e institucioneve me mjete moderne për të forcuar aftësitë operacionale;

- Mbështetje për zhvillimin e politikave dhe ndërtimin e kapaciteteve institucionale në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe kërcënimeve terroriste;

- Asistencë për Akademinë e Sigurisë dhe Shkollën e Magjistraturës në zhvillimin e kurrikulave, krijimin e partneriteteve arsimore dhe fillimin e projekteve të përbashkëta kërkimore me akademitë e BE-së.

Aktivitete të lidhura me produktin 1.6:

- Ofrimi i asistencës teknike për Parlamentin e Shqipërisë për të përmbushur rolin e tij në procesin e integrimit në BE, nëpërmjet trajnimeve, shkëmbimit të praktikave më të mira dhe ngritjes së kapaciteteve në monitorim, hartim legjislacioni dhe sigurimin kundër korrupsionit, së bashku me

promovimin e barazisë gjinore në legjislacion, forcimin e shërbimeve parlamentare dhe mbështetjen e mbikëqyrjes mbi lirinë e medias, qeverisjen digjitale dhe sigurinë kibernetike;

- Ofrimi i mbështetjes për deputetët, me fokus të veçantë te deputetet gra, në arritjen e konsensusit ndërpartiak mbi nismat për barazinë gjinore;

- Dhënia e asistencës për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për të rritur kapacitetet në mbikëqyrje dhe llogaridhënie, për të forcuar bashkëpunimin me shoqërinë civile dhe median, për të mbështetur Inteligjencën e Biznesit në analizimin e financave të partive politike, për të përmirësuar infrastrukturën digjitale për aksesueshmëri dhe për të ngritur një qendër trajnimi për përmirësimin e administrimit zgjedhor;

- Mbështetje për Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA) në përafrimin e funksioneve të saj rregullatore me standardet e BE-së, forcimin e kapacitetit për të monitoruar median *online* dhe për të rregulluar platformat digjitale në luftën kundër seksizmit, gjuhës së urrejtjes dhe dezinformimit, si dhe mbështetje për aktorët mediatikë, shoqërinë civile dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut në zbatimin e masave anti-SLAPP *(Padi Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike),* në përputhje me Këshillin e Evropës dhe Direktivën (BE) 2024/1096.

Aktivitete të lidhura me rezultatin 2.1:

- Mbështetje për Departamentin e Administratës Publike (DAP), Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA/SHSHAP) dhe shërbimin civil përmes ngritjes së kapaciteteve, programeve arsimore dhe platformave digjitale të të nxënit;

- Asistencë në përafrimin legjislativ dhe përmbushjen e kritereve të anëtarësimit në BE për reformën e administratës publike, përfshirë edhe përmes konsulencës ligjore;

- Lehtësimi i automatizimit të proceseve të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, duke përfshirë përmirësimin e platformës digjitale të HRM/MBNj-së;

- Mbështetje për reformat e proceseve administrative për të forcuar integritetin dhe luftën kundër korrupsionit në sektorët kyç, me theks të veçantë te sektorët e cenueshëm nga korrupsioni dhe në përgjigje të planeve të integritetit të hartuara prej tyre.

Aktivitete të lidhura me produktin 2.2:

- Ngritja e mëtejshme e kapaciteteve të stafit të Ministrit të Shtetit për Qeverisjen Vendore, Këshillit Konsultativ të Vetëqeverisjes Qendrore dhe Vendore, bashkive dhe zyrave të tyre të integrimit në BE, Agjencisë së Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore dhe institucioneve të tjera, për të përmirësuar qeverisjen vendore dhe shumënivelëshe, si dhe për të rritur partneritetin, kapacitetet e planifikimit pjesëmarrës dhe menaxhimin e fondeve të BE-së;

- Ofrimi i mbështetjes me grante për bashkitë për hartimin dhe zbatimin e koncepteve të Investimit Territorial të Integruar (ITI), pilotimin e koncepteve, modeleve, strategjive dhe mekanizmave të BE-së për qeverisje vendore dhe shumënivelëshe dhe zhvillim territorial të integruar, përfshirë përmes mbështetjes mbështetje nëpërmjet homologëve nga bashkitë e BE-së;

- Dhënia e konsulencës teknike dhe përmbajtësore në përgatitjen e udhëzuesve, si dhe të materialeve udhëzuese/trajnimeve *online* për bashkitë;

- Mbështetje për hartimin dhe zbatimin e planeve bashkiake për barazinë gjinore dhe fushatave ndërgjegjësuese mbi barazinë gjinore;

- Ngritja e kapaciteteve për planifikimin dhe programimin bashkiak/ndërbashkiak, kapaciteteve për identifikimin e investimeve dhe përgatitjen e **linjës së projekteve/portofolit të projekteve)** në nivel bashkiak, përmes të nxënit me mbështetje nëpërmjet homologëve, mekanizmave të planifikimit pjesëmarrës, programeve të zbatuara të ndërtimit të kapaciteteve, aktiviteteve rrjetëzuese dhe takimeve konsultuese të punës mbi integrimin në BE dhe Politikën e Kohezionit.

Aktivitete të lidhura me produktin 2.3:

- Lehtësimi i reformave kyçe në Menaxhimin Fiskal Publik (PFM/MFP) – përfshirë fusha si: kontabiliteti publik, Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike (PIFC/KBFP), menaxhimi i borxhit, planifikimi i politikës fiskale (përfshirë operacionalizimin e Këshillit Fiskal), menaxhimi i investimeve publike (duke zbatuar direktivat për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor në projektet infrastrukturore) – dhe forcimi i praktikave të prokurimit publik përmes asistencës teknike për përafrimin ligjor, masave kundër korrupsionit dhe kërkesave për certifikim, përfshirë prokurimin e Gjelbër dhe Social;

- Mbështetje për Menaxhimin e të Ardhurave të Brendshme dhe përafrimin në fushën e tatimeve përmes mbështetjes teknike dhe ngritjes së kapaciteteve të administratave tatimore dhe

doganore; përfshirë tatimin ndërkombëtar, analizën e të dhënave, menaxhimin e rrezikut dhe tatimin mjedisor;

- Lehtësimi i tranzicionit drejt Kontabilitetit Akrual përmes trajnimeve dhe certifikimeve, në përputhje me Standardet Evropiane të Kontabilitetit të Sektorit Publik (EPSAS/SEKSP);

- Forcimi i kapaciteteve të auditimit të jashtëm përmes ngritjes së kapaciteteve të institucionit të lartë të auditimit mbi teknika dhe qasje të reja auditimi; komunikim publik mbi auditimet dhe mbështetje në auditimin e fondeve të BE-së;

- Mbështetje për INSTAT-in dhe sistemin kombëtar statistikor për përmirësimin e prodhimit statistikor, me fokus të veçantë në adresimin e boshllëqeve të të dhënave në llogaritë kombëtare, të dhënat gjeohapësinore, gjinore dhe mjedisore; për forcimin e kornizave të qeverisjes statistikore në përputhje me standardet e ESS/SSE dhe për forcimin e sigurisë kibernetike dhe sistemeve të menaxhimit të integruar të të dhënave;

- Ofrimi i konsulencës ligjore dhe asistencës teknike për përditësimin e akteve nënligjore për prokurimin publik, duke u fokusuar në përafrimin me legjislacionin e BE-së, transparencën dhe luftën kundër korrupsionit, monitorimin e praktikave të prokurimit dhe kërkesave për certifikim (përfshirë prokurimin e gjelbër/mjedisor dhe social).

Aktivitete të lidhura me produktin 2.4:

- Ofrimi i mbështetjes ligjore dhe teknike për përafrimin e kuadrit ligjor të Shqipërisë me *acquis*-in e BE-së përmes vlerësimeve të boshllëqeve, hartimit ligjor, përkthimit dhe certifikimit, si dhe zhvillimit të mjeteve, metodologjive dhe dokumenteve politike për të mbështetur këtë përafrim;

- Asistencë në hartimin e pozicioneve negociuese dhe ofrimi i trajnimeve gjithëpërfshirëse mbi aspekte të ndryshme të procesit të anëtarësimit në BE;

- Lehtësimi i iniciativave të synuara për të rritur ndërgjegjësimin mbi përfitimet dhe progresin e procesit të anëtarësimit;

- Ngritja e kapaciteteve të institucioneve përkatëse përmes mentorimit në vendin e punës dhe asistencës teknike për të koordinuar, monitoruar dhe vlerësuar në mënyrë efektive zbatimin e reformave dhe investimeve sipas mekanizmit për reformë dhe rritje, duke siguruar, gjithashtu, mekanizma të fortë komunikimi, vizibiliteti dhe auditimi.

Aktivitete të lidhura me produktin 2.5:

- Ofrimi i asistencës teknike për menaxhimin e IPA-së, monitorimin, vlerësimin, raportimin, auditimin, kontrollin e brendshëm dhe menaxhimin financiar, si dhe për Planin e Komunikimit dhe Vizibilitetit të IPA III, zbatimin e strategjisë kundër mashtrimit dhe programimin sipas nevojës;

- Ofrimi i asistencës për përgatitjet për kapitullin 22, duke përfshirë hartimin e programeve të politikës së kohezionit, ngritjen e sistemit të menaxhimit dhe kontrollit për fondet e Politikës së Kohezionit dhe sistemin e monitorimit dhe vlerësimit;

- Asistencë në përgatitjen e projekteve, monitorimin dhe vlerësimin e ndihmës së BE-së;

- Ofrimi i asistencës së përshtatur për projekte individuale, duke mbështetur zbatimin e garancisë për fëmijët, forcimin e trashëgimisë kulturore dhe iniciativave për zhvillim ekonomik lokal dhe avancimin e barazisë gjinore. Për më tepër, ky aktivitet trajton prioritetet emergjente operacionale, politike dhe ligjore përmes ndërhyrjeve individuale.

Aktivitete të lidhura me produktin 2.6:

- Ofrimi i mbështetjes teknike për ministritë përgjegjëse dhe agjencitë publike për zbatimin e reformave dhe investimeve të RGF/MRRr-së;

- Ofrimi i asistencës, në lidhje me auditimin e performancës së RGF/MRRr-së (përfshirë përdorimin e mjeteve të inteligjencës artificiale);

- Trajnim praktik dhe ngritje kapacitetesh në vendin e punës për monitorimin e zbatimit të marrëveshjes së huas dhe marrëveshjes së mekanizmit, si dhe për komunikimin dhe ndërgjegjësimin mbi rezultatet e RGF/MRRr-së.

Aktivitete të lidhura me produktin 3.1:

- Përgatitja e një kuadri ligjor të përmirësuar për materialet kritike, sektorin minerar, ripërdorimin e mbetjeve nga minierat dhe përpunimi, si dhe për praktikat e qëndrueshme mjedisore dhe sociale;

- Hartimi i një strategjie të re minerare, e cila miratohet duke marrë parasysh vlerësimin strategjik mjedisor përkatës, si dhe një plan veprimi dhe standard për parandalimin dhe adresimin e ndikimit negativ socio-mjedisor të nxjerrjes së lëndëve kritike;

- Përditësimi i rrugës së zbatimit për lëndët kritike/strategjike.

Aktivitete të lidhura me produktet 3.2, 3.3 dhe 3.4:

- Përgatitja e një vlerësimi të përditësuar të rezervave gjeologjike për mineralet e zgjedhura

CRM *(Lëndët e para kritike)* duke përdorur teknologji të avancuara;

- Vlerësimi i ndikimeve sociale dhe mjedisore të industrive nxjerrëse dhe përpunuese, si dhe i ripërdorimit të mbetjeve minerare dhe riciklimit, si një burim dytësor potencial për CRM-në;

- Ofrimi i asistencës teknike për zhvillimin e një qendre funksionale kërkimore dhe inovacioni dhe me performancë të lartë, dedikuar mbështetjes së lëndëve të para kritike;

- Krijimi i një rrjeti investimesh funksional, transparent dhe informativ që lidh aktorët kombëtarë me zinxhirët industrialë të BE-së për materialet e papërpunuara;

- Lehtësimi i projekteve të përbashkëta kërkimore;

- Ngritja e kapaciteteve për mbledhjen dhe standardizimin e të dhënave publike të disponueshme, përfshirë sondazhet gjeologjike, vlerësimet minerare dhe informacionin rregullator, për të zhvilluar një bazë të dhënash të centralizuar që lejon akses të lehtë dhe analizë të të dhënave të lidhura me minierat, duke u fokusuar tek investitorët e BE-së;

- Trajnimi i kërkuesve dhe teknikëve laboratorikë në përdorimin e pajisjeve;

- Rritja e kapaciteteve dhe ofrimi i asistencës për përgatitjen e një studimi fizibiliteti dhe plani biznesi për krijimin e një qendre kërkimore me akses të hapur dhe të qëndrueshme financiarisht, si dhe përgatitja e specifikimeve teknike, prokurimi dhe instalimi i pajisjeve laboratorike të avancuara.

3.2. Iniciativa(t) e ekipit të Evropës

E pazbatueshme.

3.3. Kontributi në prioritetet horizontale dhe integrimin

Mbrojtja e mjedisit, ndryshimet klimatike dhe biodiversiteti

Aspektet e mbrojtjes së mjedisit dhe ndryshimeve klimatike janë integruar në të gjithë veprimin, duke përfshirë praktika të qëndrueshme dhe masa zbutëse gjatë hartimit dhe zbatimit të tij për të minimizuar ndikimet negative dhe për të nxitur kujdesin ndaj mjedisit, përfshirë edhe përmes zbatimit të parimeve të prokurimit të gjelbër. Veprimi do të integrojë Agjendën e Gjelbër dhe respektimin e parimit "Mos shkakto dëme të konsiderueshme" të përfshirë në legjislacionin e financave të qëndrueshme të BE-së, veçanërisht për mekanizmin për reformë dhe rritje dhe sistemin e ngritur për politikën e kohezionit. Kjo përfshin mbështetje për bashkitë në përgatitjen e strategjive lokale të zhvillimit, duke marrë parasysh veprimet klimatike dhe objektivat mjedisorë, përgatitjen e një **linje të projekteve/portofolit të projekteve,** të qëndrueshëm ndaj ndryshimeve klimatike dhe mbështetje për mobilitetin urban të qëndrueshëm për të ndihmuar bashkitë të arrijnë objektivat e planeve të tyre klimatike. Do të ofrohet mbështetje për forcimin e kapaciteteve në vlerësimin e ndikimit mjedisor, tatimin mjedisor dhe përafrimin e mëtejshëm të mbledhjes, përpunimit dhe raportimit të të dhënave mjedisore. Ngritja e kapaciteteve dhe përmirësimi i teknikave do të ndihmojnë në luftën kundër krimeve mjedisore.

Ky veprim do të kontribuojë në arritjen e objektivave klimatike të BE-së dhe të Shqipërisë përmes burimit, përpunimit dhe riciklimit të lëndëve të para kritike në Evropë, si dhe sigurimin e zinxhirëve të furnizimit, duke hapur rrugën që Shqipëria të kontribuojë në sigurimin e një furnizimi të qëndrueshëm dhe të sigurt të lëndëve të para kritike të nevojshme për tranzicionin e gjelbër. Duke qenë se përpunimi i lëndëve të para kritike mund të jetë tejet ndotës, parimi "mos shkakto dëme" do të garantohet nëpërmjet zbatimit të mekanizmave të fortë të mbrojtjes mjedisore dhe sistemeve të menaxhimit. Mbështetja për miratimin e një kuadri rregullator rigoroz, duke marrë parasysh praktikat më të mira dhe standardet e reja mjedisore, do të transformojë sektorin minerar në Shqipëri. Aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve për aktorët institucionalë të sektorit minerar do të fokusohen tek standardet mjedisore. Promovimi i ripërdorimit të mbetjeve nga nxjerrja dhe përpunimi në Shqipëri si burime dytësore për lëndët e para kritike do të përmirësojë cilësinë mjedisore dhe do të nxisë zhvillimin e qëndrueshëm, duke hapur mundësi për tranzicionin e gjelbër SME-ve *(të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme)* minerare.

Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave dhe i vajzave

Veprimi përfshin objektiva të rëndësishme për barazinë gjinore, është në përgjithësi sensitiv ndaj çështjeve gjinore dhe plotësisht në përputhje me parimet dhe qasjen e përcaktuar në Strategjinë për Barazinë Gjinore të Bashkimit Evropian 2020–2025. Agjenda për barazinë gjinore do të mbështetet drejtpërdrejt përmes miratimit (dhe monitorimit të zbatimit të saj) të një dokumenti politik për organet

publike, i cili integron parimet e të drejtave të njeriut dhe barazisë, duke kontribuar, gjithashtu, në përmbushjen e kushteve për barazinë gjinore të nevojshme për zbatimin e Politikës së Kohezionit, duke ofruar mbështetje për institucionet shqiptare në fushën e barazisë gjinore, integrimit të saj në të gjitha politikat dhe buxhetimit, si dhe duke rritur disponueshmërinë e statistikave të ndara sipas gjinive. Do të ofrohet mbështetje për qeverisjet lokale në planifikimin e zhvillimit në mënyrë sensitive ndaj çështjeve gjinore, përfshirë qasjet pjesëmarrëse dhe vlerësimet e ndikimit gjinor për linjën e ardhshme të projekteve/portofolin e projekteve të politikës së kohezionit. Do të ofrohet mbështetje për përafrimin më të mirë të *acquis*-it të BE-së për barazinë gjinore, përfshirë zbatimin e kuadrit ligjor mbi dhunën me bazë gjinore, zhvillimin dhe zbatimin e planeve komunale për barazinë gjinore dhe fushatat për ndërgjegjësimin mbi barazinë gjinore. Parlamenti do të mbështetet në zhvillimin e mekanizmave për integrimin e çështjeve gjinore, përfshirjen e perspektivave gjinore në praktikat parlamentare, legjislacion dhe buxhetim, si dhe në mbikëqyrjen e zbatimit të strategjive dhe iniciativave për barazinë gjinore dhe integrimin e saj në të gjitha politikat.

Do të ofrohet mbështetje për parlamentarët, me fokus të veçantë tek parlamentaret gra, në punën drejt arritjes së konsensusit ndërpartiak mbi iniciativat për barazinë gjinore. Auditimet e parashikuara të ndikimit social do të kontribuojnë në barazinë gjinore, ndërsa prokurimi publik me përgjegjësi sociale do të rrisë pjesëmarrjen ekonomike të grave. Veprimi parashikon përmirësimin e shërbimeve të ndihmës ligjore dhe rritjen e aksesit në drejtësi për gratë e cenueshme dhe të marzhinalizuara, një qasje të ndjeshme ndaj çështjeve gjinore për sistemin e drejtësisë së të miturve, zhvillimin e treguesve të drejtësisë sensitive ndaj gjinisë, promovimin e praktikave jodiskriminuese për gratë në sistemin gjyqësor dhe përfshirjen e grave në pozita vendimmarrëse në të gjithë sistemin e drejtësisë. Trajnime të përshtatura do t'u ofrohen Autoritetit të Mediave Audiovizive për të përmirësuar monitorimin dhe promovimin e barazisë gjinore në media dhe për të luftuar seksizmin, duke mbështetur zbatimin e praktikave të raportimit me përgjegjësi gjinore. Do të promovohen mundësi për gratë kërkuese dhe sipërmarrëse në sektorin minerar, i cili dominohet nga meshkujt.

Të drejtat e njeriut

Zhvillimi dhe zbatimi i një politike koherente për të drejtat e njeriut dhe barazi, bazuar në Kartën Evropiane të të Drejtave Themelore, do të sigurojë mjetin kryesor për integrimin e të drejtave të njeriut në përgatitjen dhe zbatimin e politikave publike, përfshirë programet e Politikës së Kohezionit dhe përgatitjen e dokumenteve të planifikimit territorial. Përshtatja me *acquis*-in dhe qeverisja e mirë, gjithmonë marrin parasysh të drejtat e njeriut, në përputhje me parimin "Mos lër askënd pas". Të drejtat e njeriut garantohen nëpërmjet konsolidimit të sistemit të drejtësisë, përmes gjyqtarëve të pavarur dhe të kualifikuar, aksesit në drejtësi për komunitetet e cenueshme dhe fëmijët, dhe ofrimit të ndihmës ligjore. Lufta kundër krimit të organizuar do të mbrojë ata që preken nga trafikimi i qenieve njerëzore dhe shfrytëzimi i komuniteteve të cenueshme.

Aktivitetet e drejtuara kundër korrupsionit do të kontribuojnë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke mbrojtur të ardhurat publike dhe mbështetur funksionimin dhe legjitimitetin e institucioneve. Mbështetja për mediat do të ruajë të drejtën për lirinë e opinionit dhe shprehjes, ndërsa ngritja e kapaciteteve të Autoritetit të Mediave Audiovizive do të kontribuojë në krijimin e një mjedisi mediatik që lufton diskriminimin në shoqëri bazuar në gjininë, origjinën raciale ose etnike, fenë ose besimin, aftësitë e kufizuara, moshën ose orientimin seksual. Praktikat e prokurimit me përgjegjësi sociale do të kontribuojnë pozitivisht në promovimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, grave dhe pakicave ekonomikisht të pambrojtura, si dhe në forcimin e aksesit në drejtësi për shkeljet e të drejtave të njeriut që lidhen me prokurimin publik, ndërsa përmirësimi i praktikave të prokurimit publik do të ndihmojë në parandalimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut brenda zinxhirëve të vlerës shtetërore. Kryerja e auditimeve të ndikimit social nga ALSAI/KLSH do të identifikojë çdo çështje të lidhur me të drejtat e njeriut. Përgatitjet për modelin e Garancisë për Fëmijët të BE-së shërbejnë si përshpejtues për të përmirësuar të drejtat e fëmijëve. Mbështetja për zbatimin e reformës për mbrojtjen e të dhënave do të garantojë mekanizma efektivë për të mbrojtur privatësinë dhe të dhënat personale, duke ruajtur dhe promovuar të drejtën për lirinë e

shprehjes. Strategjia e re minerare do të forcojë parimet e drejtësisë sociale, barazisë, shëndetit dhe mosdiskriminimit dhe do të mbështesë të drejtat e qytetarëve në zonat ku ndodhen lëndët e para kritike.

Aftësitë e kufizuara

Zbatimi dhe implementimi i Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (UNCRPD/KKBDPAK) do të forcohet përmes zbatimit të dokumentit politik mbi të drejtat e njeriut dhe barazinë, duke u fokusuar në garantimin që politika, legjislacioni dhe standardet për aksesueshmërinë të jenë të integruara siç duhet, përfshirë edhe në hartimin e programeve të Politikës së Kohezionit. Kjo do të integrohet në aktivitetet e planifikimit nëpër sektorë dhe në zbatimin e investimeve të mekanizmit për reformë dhe rritje.

Zhvillimi dhe zbatimi i legjislacionit që lidhet me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara do të monitorohet dhe raportohet. Mbështetja për bashkitë do të garantojë që kërkesat për kërkesat e aksesueshmërisë të respektohen plotësisht gjatë përgatitjes së projekteve të infrastrukturës, ndërsa një perspektivë e aksesueshmërisë dhe përfshirjes do të miratohet për përgatitjen e dokumenteve të planifikimit të zhvillimit lokal. Auditimet e ndikimit social do të shqyrtojnë mënyrën sesi politikat dhe planet publike marrin në konsideratë nevojat e personave me aftësi të kufizuara. Në përgjithësi, praktikat e përmirësuara të prokurimit do të marrin parasysh parimin e dizajnit universal dhe do të garantojnë që nuk ka pengesa për aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara. Praktikat e prokurimit me përgjegjësi sociale do të jenë, gjithashtu, të dobishme, pasi nxisin pjesëmarrjen ekonomike dhe mundësitë për personat me aftësi të kufizuara dhe rrisin cilësinë e shërbimeve mbështetëse.

Demokracia

Kapaciteti i institucioneve demokratike në Shqipëri për të funksionuar në përputhje me parimet e efikasitetit dhe llogaridhënies do të forcohet, duke rritur kështu besimin publik dhe besimin në institucionet demokratike. Do të ofrohet mbështetje për Parlamentin në rolin e tij mbikëqyrës, monitorues dhe përfaqësues. Një Komision Zgjedhor më efikas dhe i pajisur me kapacitete të plota do të garantojë që të gjithë qytetarët të mund të ushtrojnë të drejtat e tyre zgjedhore në mënyrë efektive dhe të nxisë pjesëmarrjen efektive dhe të qëndrueshme të qytetarëve.

Një media e lirë, e pavarur dhe pluraliste, e bazuar në lirinë e informacionit dhe të shprehjes, është një element thelbësor i çdo demokracie funksionale. Garantimi që të drejtat e njeriut respektohen në të gjithë sektorët dhe organet publike në të gjitha nivelet, në monitorimin dhe promovimin e respektimit të të drejtave themelore, do të kontribuojë në konsolidimin e vlerave demokratike brenda vendit. Forcimi i sektorit publik do të nxisë qeverisjen e mirë, një nga shtyllat/parimet e demokracisë. Rritja e transparencës në menaxhimin financiar publik, menaxhimin e borxhit, përafrimin fiskal dhe përmirësimin e praktikave të prokurimit kontribuojnë të gjitha në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në financat publike dhe rritjen e besimit të publikut, të cilat janë të domosdoshme për demokracinë.

Mbështetja e ofruar qeverisjeve lokale do të rrisë kapacitetin e tyre për të zbatuar parimet e qeverisjes së mirë, duke përfshirë parimet e transparencës, përfshirjes dhe pjesëmarrjes, efikasitetit, efektivitetit dhe llogaridhënies. Auditimet e ndikimit social bazohen në parimet e qeverisjes demokratike dhe çojnë në menaxhimin demokratik të burimeve publike dhe ofrimin e shërbimeve publike. Praktikat e prokurimit me përgjegjësi sociale mund të nxisin krijimin e pasurisë komunitare përmes pronësisë demokratike, duke çuar në demokraci ekonomike. Rritja e kapaciteteve në vlerësimin e ndikimit mjedisor do të kontribuojë, gjithashtu, në ndërtimin dhe konsolidimin e demokracisë mjedisore, përfshirë tranzicionin e gjelbër. Konsolidimi i sistemit të drejtësisë, përmirësimi i kushteve të sigurisë në burgje, promovimi i praktikave të drejtësisë restauruese, drejtësia për të miturit dhe modeli *Barnahus*, si dhe aksesi i barabartë në drejtësi dhe ndihmë ligjore, veçanërisht për grupet e cenueshme, do të promovojnë vlerat dhe parimet demokratike. Hartimi i përditësuar i burimeve strategjike do të hapë rrugën për përfshirjen demokratike në tranzicionin e gjelbër.

Sensitiviteti ndaj konflikteve, paqja dhe qëndrueshmëria

Qëndrueshmëria do të bazohet në tranzicionin e gjelbër nëpërmjet prezantimit të një kuadri rregullator të përditësuar që përmbush standardet e BE-së në sektorin minerar, duke marrë parasysh numrin e madh të operacioneve informale të

nxjerrjes së mineraleve në shkallë të vogël që nuk janë të qëndrueshme. Konfliktet e mundshme midis komuniteteve lokale, SME-ve (ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme) dhe investitorëve do të adresohen në mënyrë proaktive, duke theksuar mundësitë që do të hapen përmes vendosjes së standardeve të larta shoqërore dhe mjedisore, dhe miratimi i paradigmave të ekonomisë qarkore dhe zgjidhjeve inovative do të garantojë mundësi të rëndësishme zhvillimi për komunitetet rurale lokale, duke garantuar përfitime konkrete në nivel komuniteti dhe duke ruajtur cilësinë mjedisore.

Ulja e rrezikut nga fatkeqësitë

Rregullimi dhe standardet e përmirësuara në sektorin e minierave do të zvogëlojnë rreziqet në miniera. Ruajtja dhe ripërdorimi i mbetjeve nxjerrëse dhe të përpunimit, në kontekstin e ekonomisë qarkore, janë një hap i rëndësishëm drejt parandalimit dhe uljes së rreziqeve.

3.4. Supozimet dhe rreziqet e jashtme

Supozime të jashtme:

- Angazhimi politik i qëndrueshëm, stabiliteti institucional dhe koordinimi efektiv midis palëve të interesit për zbatimin e suksesshëm të reformave dhe procesit të përafrimit me *acquis*-in e BE-së.

- Burime të mjaftueshme financiare dhe teknike në dispozicion për të mbështetur ndërtimin e kapaciteteve në sektorin publik, dhe ekzistenca e strukturave administrative dhe organizative të qëndrueshme.

- Profesionistët e drejtësisë dhe nëpunësit civilë të angazhuar aktivisht në iniciativat e ndërtimit të kapaciteteve dhe proceset e reformës, me një kapacitet institucional për të përthithur dhe ruajtur ndryshimet.

- Bashkitë dhe organet e qeverisjes të angazhuara për të ndjekur modelet e BE-së dhe që koordinimi ndërqeveritar të jetë efektiv.

- Reformat në menaxhimin financiar publik dhe prokurim varen nga miratimi në kohë i kuadrit të nevojshëm ligjor dhe angazhimi afatgjatë i qeverisë.

- Janë vendosur treguesit përfundimtarë për kapitullin 22.

- Ekziston një interes i lartë dhe i qëndrueshëm i tregjeve evropiane për produktet e nxjerrjes, përpunimit dhe riciklimit të lëndëve të para kritike (CRM).

- Qeveria e Shqipërisë mbetet plotësisht e angazhuar për përgatitjen/përditësimin dhe përafrimin e politikave dhe kuadrit ligjor lidhur me CRM-në.

Kategoria	Rreziqet	Probabiliteti (i lartë/ mesatar/ i ulët)	Ndikimi (I lartë/ mesatar/ i ulët)	Masat zbutëse
3-Për njerëzit dhe organizatën	Mungesa e vullnetit të qëndrueshëm politik për të zbatuar reformat në drejtësi, për të ruajtur pavarësinë e institucioneve dhe për të integruar në mënyrë të qëndrueshme të drejtat themelore dhe parimet e barazisë.	Mesatar	I lartë	Angazhimi i vazhdueshëm me palët kyçe politike dhe monitorimi i rregullt nga BE-ja për të siguruar angazhimin ndaj objektivave të reformës. Angazhimi i vazhdueshëm me organet e qeverisjes qendrore dhe lokale për të garantuar respektimin e të drejtave themelore.
3-Për njerëzit dhe organizatën	Stafi i pamjaftueshëm në organet publike dhe institucionet e pavarura mund të pengojë aftësinë e tyre për të përfituar plotësisht nga aktivitetet e ndërtimit të kapaciteteve.	Mesatar	Mesatar	Analiza vjetore e ngarkesës së punës dhe monitorimi i vazhdueshëm i procesit të plotësimit me personel kryhen nga të gjitha institucionet dhe strukturat për të garantuar nivelet optimale të kapacitetit. Gjithashtu, politika e mbajtjes dhe rekrutimit të stafit është përforcuar më tej.
2-Për planifikimin, proceset dhe sistemet	Mekanizmat e dobët të koordinimit midis agjencive të ndryshme, si në nivel qendror edhe lokal, dhe mungesa e platformave të përbashkëta të të dhënave mund të pengojnë efektivitetin e hetimeve dhe inspektimeve të përbashkëta të synuara për të luftuar krimin e organizuar, aktivitetet financiare, kibernetike dhe mjedisore të paligjshme.	Mesatar	Mesatar	Procedurat e koordinimit dhe komunikimit ndërinstitucional po vlerësohen, miratohen dhe monitorohen rregullisht. Përmirësimet identifikohen dhe zbatohen sipas nevojës për të garantuar bashkëpunim më të fortë midis agjencive, duke rritur aftësinë e tyre për të kryer hetime dhe inspektime të përbashkëta në luftën kundër aktiviteteve të paligjshme mjedisore.
3-Për njerëzit dhe organizatën	Rezistenca ndaj ndryshimit midis deputetëve dhe stafit mund të pengojë përpjekjet për qeverisje të hapur.	I ulët	I ulët	Bashkëpunimi me homologët e BE-së do të ndihmojë në vendosjen e parimeve të qeverisjes së hapur si prioritet dhe në tejkalimin e rezistencës.

2-Për planifikimin, proceset dhe sistemet	Bashkëpunimi i dobët midis Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) dhe medias.	Mesatar	Mesatar	AMA-s dhe medias do t'u ofrohen procedura bashkëpunimi dhe udhëzime për të marrë masa që të përmirësojnë etikën mediatike në praktikë, të zbatuara përmes rritjes së monitorimit.
1-Mjedisi i jashtëm	Mungesa e kohës ose e interesit të nëpunësve civilë për të marrë pjesë në aktivitetet e propozuara të trajnimit dhe ndërtimit të kapaciteteve.	I lartë	I ulët	Aktivitetet e trajnimit dhe ndërtimit të kapaciteteve janë të akredituara, ofrohen profesionalisht, sigurojnë stimuj të përshtatshëm për nëpunësit civilë dhe ofrohen nëpërmjet modaliteteve fleksibël të pjesëmarrjes.
1-Mjedisi i jashtëm	Bashkëpunimi midis qeverisjes qendrore dhe lokale vazhdon përmes funksionimit të qetë të Këshillit Konsultativ.	I ulët	I lartë	Ruajtja e kanaleve të qarta dhe të strukturuara të komunikimit.
2-Për planifikimin, proceset dhe sistemet	Vonesa në miratimin e legjislacionit të nevojshëm ose akteve nënligjore që ndikojnë në negociatat e anëtarësimit.	Mesatar	Mesatar	Garantimi i angazhimit dhe konsultimit të hershëm me të gjitha palët përkatëse për të ndërtuar konsensus dhe garantuar pjesëmarrjen e tyre aktive në procesin e hartimit të ligjit. Ofrimi i mbështetjes teknike për të siguruar përparimin e qetë të të gjitha akteve ligjore të planifikuara, duke përfshirë konsultimet dhe vlerësimet e ndikimit rregullator.
3-Për njerëzit dhe organizatën	Rezistenca e stafit ndaj inovacionit të sjellë nga zhvillimi teknologjik.	Mesatar	Mesatar	Ofrimi i mbështetjes teknike për të garantuar përparimin e qetë të të gjitha akteve ligjore të planifikuara, duke përfshirë konsultimet dhe vlerësimet e ndikimit rregullator.
3 Për njerëzit dhe organizatën	Nivelet e pamjaftueshme të stafit, normat e larta të rotacionit dhe mungesa e kapaciteteve teknike midis institucioneve të përfituesve përkatëse shqiptarë, që mund të pengojnë aftësinë e tyre për të përthithur në mënyrë efektive mbështetjen e ofruar nga ndërhyrjet, duke çuar në vonesa dhe joefikasitet.	Mesatar	Mesatar	Qeveria e Shqipërisë është e angazhuar në zbatimin e masave të politikës për mbajtjen e stafit, të cilat janë në vijim. Ofrimi i asistencës teknike të synuar dhe programeve të ndërtimit të kapaciteteve për të përmirësuar aftësitë dhe njohuritë e stafit përkatës. Kryhen vlerësime të rregullta të niveleve të plotësimit me personel dhe kapaciteteve teknike të institucioneve të përfituesve shqiptarë përkatës, për të identifikuar fushat ku nevojitet mbështetje shtesë.
3- Për njerëzit dhe organizatën	Përgjegjësitë institucionale për kërkimin dhe shfrytëzimin e materialeve kritike/strategjike të papërpunuara (CRM) nuk janë të qarta. Bashkëpunimi midis institucioneve shqiptare në zbatimin e veprimit është i dobët, duke çuar në vështirësi dhe vonesa.	Mesatar	I lartë	Veprimi do të ndihmojë në hartimin e një udhërrëfyesi për përgatitjen e materialeve kritike/strategjike të papërpunuara (CRM/SRM), duke qartësuar rolet dhe përgjegjësitë e organeve publike. Veprimi do t'i kushtojë vëmendje të veçantë nxitjes së bashkëpunimit dhe koordinimit midis institucioneve aktive në këtë sektor.
5-Për komunikim dhe informacion	Interesi i pamjaftueshëm nga aktorët e sektorit privat, industria evropiane dhe aktorë të tjerë për të investuar në sektorin e lëndëve të para kritike në Shqipëri.	Mesatar	Mesatar	Veprimi do të mbështesë krijimin e një qendre të hapur kërkimore për të përhapur informacion mbi mundësitë e rëndësishme për zhvillimin e biznesit dhe për të ofruar mbështetje për *start-up*-et e reja ose ekzistuese në sektorin e lëndëve të para kritike (CRM). Rrjeti i krijuar i investimeve do të mbështesë përgatitjen e projekteve industriale të konsoliduara dhe do të krijojë mundësi për zhvillim biznesi.

4. RREGULLIMET E ZBATIMIT

4.1 Marrëveshjet e financimit

Për të zbatuar këtë veprim, do të nënshkruhet një marrëveshje financimi me Republikën e Shqipërisë.

4.2 Periudha treguese e zbatimit

Periudha treguese e zbatimit operacional të këtij veprimi, gjatë së cilës do të kryhen aktivitetet dhe do të zbatohen kontratat dhe marrëveshjet përkatëse, është deri në 72 muaj nga data e nënshkrimit të marrëveshjes së financimit (dhe letra njoftuese ose shkëmbimi i letrave për këstet e mëvonshme vjetore buxhetore). Zgjatjet e periudhës së zbatimit mund të bien dakord nga zyrtari përgjegjës i autorizuar i Komisionit në raste të arsyeshme dhe të justifikuara.

4.3. Modalitetet e zbatimit

Komisioni do të garantojë që të respektohen rregullat dhe procedurat e duhura të BE-së për ofrimin e financimit për palët e treta, duke përfshirë procedurat e shqyrtimit, kur është e nevojshme, dhe përputhshmërinë e veprimit me masat kufizuese të BE-së[28].

4.3.1 Menaxhimi i drejtpërdrejtë (grantet)

4.3.1.1 Grantet për bashkëpunim institucional

a) Qëllimi i grantit/granteve

Pjesë e rezultatit 1 dhe rezultatit 2 do të zbatohet përmes një granti për bashkëpunim institucional (grant binjakëzimi).

b) Lloji i aplikantëve të synuar

Aplikantët duhet të jenë administrata të shteteve anëtare të BE-së ose organe të mandatuara prej tyre.

4.3.2 Menaxhimi i drejtpërdrejtë (prokurimi)

Prokurimi, i kombinuar me modalitete të tjera zbatimi, do të kontribuojë në pjesën e rezultateve 1 dhe 2.

4.3.3 Menaxhimi i tërthortë me një entitet të vlerësuar sipas kolonës [29]

Një pjesë e këtij veprimi, lidhur me fushën e mbështetjes 1, mund të zbatohet përmes menaxhimit të tërthortë me një entitet të vlerësuar sipas kolonës, i cili do të përzgjidhet nga shërbimet e Komisionit, duke përdorur kriteret e mëposhtme:

- Njohuri dhe ekspertizë të provuar në fushën e drejtësisë për të miturit; gjykim me kusht; të drejtat e njeriut, barazia dhe Kartën e të Drejtave Themelore; demokracia; bashkëpunimi policor dhe gjyqësor, duke përfshirë atë midis Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë; ose luftimi i rrjeteve të krimit të organizuar, korrupsionit të nivelit të lartë dhe pastrimit të parave.

- Një histori suksesi dhe kapacitet për të zhvilluar marrëdhënie të mira pune me partnerë lokalë dhe ndërkombëtarë.

- Kapacitet operacional dhe logjistik i provuar dhe ekspertizë në fushat përkatëse.

Zbatimi nga këta entitete përfshin kontributin në arritjen e rezultatit 1 dhe produkteve përkatëse.

Një pjesë e këtij veprimi mund të zbatohet përmes menaxhimit të tërthortë me Agjencinë Austriake të Zhvillimit (ADA/AAZH). Ky zbatim përfshin pjesën e veprimit që lidhet me monitorimin e vetingut gjyqësor. Entiteti i parashikuar është përzgjedhur, duke përdorur kriteret e mëposhtme: përvoja në zbatimin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit të procesit aktual të vetingut në Shqipëri, ekspertizë teknike, kapacitet operacional dhe kapacitet i provuar për të kryer punën e pritshme në kohë dhe me rezultate të kënaqshme.

Komisioni autorizon që shpenzimet e kryera, në kuadër të mbështetjes për Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit të njihen si të pranueshme që nga data 1 shtator 2025, për shkak të natyrës së tyre sensitive dhe prioritetit të lartë.

Në rast se entiteti i parashikuar do të duhet të zëvendësohet, shërbimet e Komisionit mund të përzgjedhin një entitet zëvendësues duke përdorur të njëjtat kritere. Nëse entiteti zëvendësohet, vendimi për zëvendësimin duhet të jetë i arsyetuar.

Një pjesë e këtij veprimi, lidhur me fushën e mbështetjes 2, mund të zbatohet përmes menaxhimit të tërthortë me një entitet të vlerësuar sipas kolonës, i cili do të përzgjidhet nga shërbimet e Komisionit duke përdorur kriteret e mëposhtme:

- Njohuri dhe ekspertizë të provuar në fushën e zhvillimit të kapaciteteve të shërbimit civil; sistemet e menaxhimit të burimeve njerëzore; qeverisja lokale dhe zhvillimi territorial i integruar; mbrojtja e të dhënave; auditimi i jashtëm; statistikat zyrtare; garancia për fëmijë; kultura; ose barazia gjinore.

[28] Shihni **Hartën e Sanksioneve të BE-së**. Harta e sanksioneve është një mjet IT për identifikimin e regjimeve të sanksioneve. Burimi i sanksioneve rrjedh nga aktet ligjore të botuara në **Fletoren Zyrtare (OJ/FZ)**. Në rast të një mospërputhjeje midis akteve ligjore të botuara dhe përditësimeve në faqen e internetit, versioni i Fletores Zyrtare do të ketë përparësi.

[29] Nënshkrimi i një marrëveshjeje kontributi me entitetin e përzgjedhur është i lidhur me përfundimin e vlerësimit të nevojshëm sipas kolonës.

- Një histori suksesi dhe kapacitet për të zhvilluar marrëdhënie të mira pune me partnerë lokalë dhe ndërkombëtarë.

- Kapacitet operacional dhe logjistik i provuar dhe ekspertizë në fushat përkatëse.

Zbatimi nga këta entitete përfshin kontributin në arritjen e rezultatit 2 dhe produkteve përkatëse.

Një pjesë e këtij veprimi, lidhur me fushën e mbështetjes 3, mund të zbatohet përmes menaxhimit të tërthortë me një entitet të vlerësuar sipas kolonës, i cili do të përzgjidhet nga shërbimet e Komisionit duke përdorur kriteret e mëposhtme:

- Njohuri dhe ekspertizë të provuar në fushën e CRM-së, duke përfshirë kuadrin politik, hartëzimin, ndikimin social dhe mjedisor, investimet, kërkimin dhe inovacionin.

- Një histori suksesi dhe kapacitet për të zhvilluar marrëdhënie të mira pune me partnerë lokalë dhe ndërkombëtarë.

- Kapacitet operacional dhe logjistik i provuar dhe ekspertizë në fushat përkatëse.

Zbatimi nga këta entitete përfshin kontributin në arritjen e rezultatit 3 dhe produkteve përkatëse.

4.3.4 Ndryshimet nga menaxhimi i tërthortë në menaxhimin e drejtpërdrejtë (dhe anasjelltas) për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme

Nëse modaliteti i zbatimit nën menaxhimin e drejtpërdrejtë, siç përcaktohet në seksionin 4.3.1.1 (grante për bashkëpunim institucional) dhe në seksionin 4.3.2 (prokurimi), nuk mund të zbatohet për shkak të rrethanave jashtë kontrollit të Komisionit, do të përdoret modaliteti i zbatimit përmes menaxhimit të tërthortë me një entitet të vlerësuar sipas kolonës, sipas seksionit 4.3.3.

Nëse modaliteti i zbatimit nën menaxhimin e tërthortë, lidhur me auditimin e jashtëm dhe mbrojtjen e të dhënave, siç përcaktohet në seksionin 4.3.3, nuk mund të zbatohet për shkak të rrethanave jashtë kontrollit të Komisionit, do të përdoret modaliteti i zbatimit përmes granteve (grante për bashkëpunim institucional) sipas elementeve të binjakëzimit të granteve, të përcaktuara në seksionin 4.3.1.1.

Nëse modaliteti i zbatimit nën menaxhimin e tërthortë, siç përcaktohet në seksionin 4.3.3, duke përjashtuar pjesën që lidhet me auditimin e jashtëm dhe zhvillimin territorial të integruar, nuk mund të zbatohet për shkak të rrethanave jashtë kontrollit të Komisionit, do të përdoret modaliteti i zbatimit përmes prokurimit nën menaxhimin e drejtpërdrejtë sipas elementeve të përcaktuara në seksionin 4.3.2.

4.4. Fusha e përfitueshmërisë gjeografike për prokurimin dhe grantet – vetëm nëse do të përdoren prokurimi ose grantet

Përfitueshmëria gjeografike në lidhje me vendin e themelimit për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit dhe dhënies së granteve, si dhe në lidhje me origjinën e furnizimeve të blera, siç përcaktohet në aktin themelor dhe dokumentet kontraktuale përkatëse, do të zbatohet, duke iu nënshtruar dispozitave të mëposhtme. Zyrtari autorizues përgjegjës i Komisionit mund të zgjasë përfitueshmërinë gjeografike bazuar në urgjencë ose në mungesën e shërbimeve në tregjet e vendeve ose territoreve përkatëse, ose në raste të tjera të arsyetuara siç duhet ku zbatimi i rregullave të përfitueshmërisë do ta bënte realizimin e këtij plani veprimi të pamundur ose jashtëzakonisht të vështirë (neni 28(10) i Rregullores NDICI/*IFZHBN (instrumenti i fqinjësisë, zhvillimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar).*

4.5. Buxheti indikativ

Buxheti Indikativ	**Kontributi i BE-së 2025 (euro)**	**Kontributi i BE-së 2026 (euro)**	**Kontributi i BE-së 2027 (euro)**	**Kontributi total i BE-së 2025–2027 (euro)**
		Modalitetet e zbatimit		
Metodat e zbatimit – shihni seksionin 4.3				
Grantet – (menaxhim i drejtpërdrejtë) shihni seksionin 4.3.1		8,000,000.00		8,000,000.00

Prokurimi (menaxhim i drejtpërdrejtë – sipas seksionit 4.3.2)	16,563,000.00	6,250,000.00	12,000,000.00	32,813,000.00
Menaxhimi i tërthortë me entitete të vlerësuara sipas shtyllave – shihni seksionin 4.3.3	17,000,000.00	15,750,000.00	26,437,000.00	59,187,000.00
Vlerësimi – shihni seksionin 5.2	E pazbatueshme	E pazbatueshme	E pazbatueshme	E pazbatueshme
Auditimi dhe verifikimi – shih seksionin 6	E pazbatueshme	E pazbatueshme	E pazbatueshme	E pazbatueshme
Komunikimi strategjik dhe diplomacia publike – shih seksionin 7	E pazbatueshme	E pazbatueshme	E pazbatueshme	E pazbatueshme
Kontigjencat	E pazbatueshme	E pazbatueshme	E pazbatueshme	E pazbatueshme
Totali	**33,563,000.00**	**30,000,000.00**	**36,437,000.00**	**100,000,000.00**

5. MATJA E PERFORMANCËS

5.1 Monitorimi dhe raportimi

Aktivitetet e monitorimit të kryera për këtë veprim do të synojnë të identifikojnë sukseset, problemet dhe/ose rreziqet e mundshme, në mënyrë që të merren masat korrigjuese në kohën e duhur. Të dyja llojet e monitorimit të brendshëm do të kryhen në mënyrë gjithëpërfshirëse, duke përfshirë aktorët kyç.

Monitorimi i brendshëm

Monitorimi teknik dhe financiar i përditshëm i zbatimit të këtij veprimi ose pjesëve të veprimit, do të jetë një proces i vazhdueshëm dhe pjesë e përgjegjësive të partnerëve zbatuese dhe të Komisionit.

Monitorimi i jashtëm

Sipas rregullave dhe procedurave të Komisionit, Komisioni mund të kryejë monitorim shtesë nëpërmjet konsulentëve të jashtëm të pavarur të angazhuar nga Komisioni. Monitorimi i jashtëm mbështetet nga të dyja llojet e monitorimit të brendshëm të përshkruara më sipër.

5.2 Vlerësimi

Komisioni mund të kryejë një vlerësim afatmesëm, përfundimtar ose *ex post* për këtë veprim ose pjesë të veprimit. Në rast se një vlerësim afatmesëm ose përfundimtar nuk është parashikuar, Komisioni, gjatë zbatimit, mund të vendosë të kryejë një vlerësim të tillë për arsye bindëse, qoftë me vendimin e tij, qoftë me iniciativë të qeverisë së Shqipërisë. Sipas udhëzimeve të *Better Regulation* (Rregullimit më të Mirë)[30], vlerësimet mund të identifikohen si rezultat i vendimeve të reja strategjike ose reagimeve të rëndësishme (negative) mbi performancën (p.sh. probleme në zbatim, gjetje nga rezultatet e monitorimit, ankesa ose shkelje, raporte auditimi).

Në frymën e partneritetit, shërbimet e Komisionit dhe qeveria e Shqipërisë, si dhe aktorë kyç të tjerë, mund të kryejnë, gjithashtu, vlerësime të përbashkëta.

Qeveria e Shqipërisë dhe aktorët e tjerë kyç do të kontribuojnë dhe do të sigurojnë informacionin e nevojshëm për ushtrimet e ndryshme të vlerësimit. Pas dakordësisë midis palëve, raportet e vlerësimit mund të bëhen publike për të lejuar aktorët përkatës, duke përfshirë përfaqësuesit e shoqërisë civile, të shprehin mendimet e tyre, duke kontribuar kështu në funksionin e llogaridhënies së vlerësimit.

Si rezultat i një vlerësimi, dhe kur është e nevojshme, në marrëveshje me qeverinë e Shqipërisë, Komisioni dhe partneri zbatues vendosin së bashku për veprimet pasuese që duhen ndërmarrë dhe çdo rregullim të nevojshëm, duke përfshirë, nëse specifikohet, riorientimin e komponentëve përkatës.

5. AUDITIMI DHE VERIFIKIMET

Pa cenuar detyrimet që zbatohen për kontratat e lidhura për realizimin e ndërhyrjeve në kuadër të këtij veprimi, Komisioni, mbi bazën e një vlerësimi të rrezikut, mund të kontraktojë

[30] Udhëzime *Better Regulation* (Rregullimit më të Mirë), SWD(2021) 305, përfundimtar.

auditime ose detyra verifikimi të pavarura për një ose më shumë kontrata ose marrëveshje të lidhura për ndërhyrje ose pjesë të tyre që rrjedhin nga ky veprim.

6. KOMUNIKIMI STRATEGJIK DHE DIPLOMACIA PUBLIKE

Të gjitha entitetet që zbatojnë ndërhyrje të jashtme të financuara nga BE-ja kanë detyrimin kontraktual që të informojnë audiencat përkatëse mbi mbështetjen e Bashkimit për punën e tyre, duke vendosur emblemën e BE-së dhe një deklaratë të shkurtër për financimin, sipas rastit, në të gjitha materialet e komunikimit që lidhen me ndërhyrjet përkatëse. Për këtë qëllim, ato duhet të respektojnë udhëzimet e dhëna në dokumentin udhëzues të vitit 2022, *Komunikimi dhe rritja e vizibilitetit të BE-së: Udhëzime për veprimet e jashtme* (ose çdo dokument pasues).

Ky detyrim do të zbatohet njëlloj, pavarësisht nëse ndërhyrjet përkatëse zbatohen nga Komisioni, vendi partner, ofruesit e shërbimeve, përfituesit e granteve apo entitete të besuara ose të deleguara si agjencitë e OKB-së, institucionet financiare ndërkombëtare dhe agjencitë e shteteve anëtare të BE-së. Në çdo rast, një referencë për detyrimet kontraktuale përkatëse duhet të përfshihet në marrëveshjen për financim, kontratat e prokurimit dhe të granteve, si dhe në marrëveshjet e kontributeve.

URDHËR
Nr. 757, datë 22.7.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E KROACISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishit të freskët dhe produkteve të tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përjashtuar mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e thatë të kafshëve shtëpiake, dhe vakteve proteinike sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	**Ndarja administrative e nivelit 2**	**Ndarja administrative e nivelit 3**
Osjecko-Baranjska	Đurđenovac*	
Osjecko-Baranjska	Draž*	
Osjecko-Baranjska	Drenje*	
Osjecko-Baranjska	Erdut*	
Osjecko-Baranjska	Kneževi Vinogradi*	
Osjecko-Baranjska	Magadenovac*	
Osjecko-Baranjska	Našice*	
Osjecko-Baranjska	Osijek*	
Osjecko-Baranjska	Viljevo*	
Viroviticko-Podravska	Crnac*	
Viroviticko-Podravska	**Orahovica***	
Viroviticko-Podravska	Zdenci*	

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishit të freskët dhe produkteve të tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Kroacisë, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

2.4 Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4

të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) janë përgatitur nga mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

4. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

6. Urdhri nr. 745, datë 17.7.2026, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës

afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin Kroacisë", shfuqizohet.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 758, datë 22.7.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E SPANJËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) mishit të freskët;

ç) materialit biologjik të shpendëve të pashoqëruar me test diagnostik PCR-je të kryer 14 ditë përpara mbledhjes, që vërteton mosprezencën e virusit;

d) vezëve dhe produkteve të vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të pseudopestit, përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55°C në 2,521 sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55°C në 2,278 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kriposje nuk është bërë trajtimi me temperaturë 55°C në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës së tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57°C në 50.4 orë;

dh) produktet e mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:

i. 65°C në 39.8 sekonda;

ii. 70°C në 3.6 sekonda;

iii. 74°C në 0.5 sekonda;

iv. 80°C në 0.03 sekonda;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Spanjës, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
1.	Comunitat Valenciana	Valencia/València	La Vall D'albaida-Castello de Rugat*
2.	Comunitat Valenciana	Valencia/València	La Vall D'albaida-Ontinyent*
3.	Castilla y León	Valladolid	Valladolid*
4.	Castilla y León	Valladolid	Olmedo*
5.	Castilla y León	Valladolid	Medina del Campo*
6.	Castilla y León	Valladolid	Peñafiel*
7.	Castilla y León	Valladolid	Tordesillas*
8.	Castilla y León	Zamora	Toro*
9.	Castilla y León	Segovia	Cuellar*
10.	**Castilla y León**	**Ávila**	**San Pedro del Arroyo***
11.	**Castilla y León**	**Salamanca**	**Peñaranda de Bracamonte***

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produkteve të mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Spanjës, të cilat nuk kanë pasur njoftim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.

4. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produkteve të mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që

vijnë nga zonat e sipërcituara sipas pikës 2 të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

7. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

8. Urdhri nr. 738, datë 16.7.2026, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit, të shfaqur në shtetin e Spanjës", shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 763, datë 24.7.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË SHFAQUR NË SHTETIN E ÇEKISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Çekisë, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë*
Jihočeský	Prachatice*
Kraj Vysočina	**Žďár nad Sázavou***

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet

8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupa për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupave ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ç) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve në pikat 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 794, datë 14.8.2025, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Çekisë", shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 764, datë 24.7.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË SHFAQUR NË SHTETIN E SPANJËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Spanjës, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	**Ndarja administrative e nivelit të dytë**	**Ndarja administrative e nivelit të tretë***
Aragón	Huesca	Boltaña*
Cataluña	Girona	Pla de l'estany (banyoles)*
Castilla - La Mancha	Toledo	Galvez*
Castilla - La Mancha	Toledo	Toledo*
Castilla - La Mancha	Toledo	Oropesa*
Comunidad Foral de Navarra	Navarra	Ochagavia*
País Vasco	Gipuzkoa	Gipuzkoa*
Illes Balears	Illes Balears	Palma*
Illes Balears	Illes Balears	Menorca*
Galicia	A Coruña	Ferrol*
Galicia	A Coruña	A Barcala*
Galicia	**Lugo**	**Meira***

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides,* në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupa për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitrupave ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ç) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve në pikat 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 746, datë 17.7.2026, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu të shfaqur në shtetin e Spanjës", shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

VENDIM
Nr. 133, datë 22.7.2026

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KOMISIONIT TË NDIHMËS SHTETËRORE NR. 132/2026, "AUTORIZIM I NDIHMËS SHTETËRORE 'FONDI PËR NDËRMARRJET MIKRO, TË VOGLA DHE TË MESME PËR VITIN 2026'"

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

- Znj. Delina Ibrahimaj kryetare;
- Znj. Mimoza Dhëmbi anëtare;
- Z. Besnik Çina anëtar;
- Znj. Keida Qirko anëtare;
- Z. Ahmet Mançellari anëtar,

në mbledhjen e tij të radhës të datës 22.7.2026, në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, mori në shqyrtim kërkesën nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) e lidhur me vendimin nr. 132, datë 29.4.2026, të Komisionit të Ndihmës Shtetërore, të shoqëruar me formularin e njoftimit të AIDA-s, në përputhje me legjislacionin e ndihmës shtetërore.

I. Procedura

1. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), me shkresën nr. 1312, datë 6.7.2026, ka paraqitur kërkesën për ndryshimin e vendimit nr. 132, datë 29.4.2026, të Komisionit të Ndihmës Shtetërore (KNSH), me qëllim përshtatjen e specifikimeve teknike të skemës me elementet zbatuese të VKM-së nr. 225, datë 1.4.2026.

2. Në kuadër të fillimit të fazës së zbatimit të skemës së mbështetjes financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) për vitin 2026, AIDA, në cilësinë e institucionit zbatues, ka kërkuar nga KNSH-ja rishikimin e vendimit nr. 132, datë 29.4.2026, "Për autorizimin e ndihmës shtetërore 'Fondi për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme për vitin 2026'".

3. Në kërkesën e saj, AIDA ka parashtruar nevojën për rishikimin e disa zërave të shpenzimeve dhe intensiteteve të ndihmës, duke argumentuar se, për qëllime të zbatimit të skemës sipas VKM-së nr. 225, datë 1.4.2026, kërkohet një shtrirje më e gjerë e kostove të pranueshme. Specifikisht, AIDA ka kërkuar që krijimi i aplikacioneve dhe platformave të tregtisë elektronike, i trajtuar në vendimin nr. 132, sipas rregullave të ndihmës për investime (me intensitete 10% dhe 20%), të përfshihet në kategorinë e shpenzimeve korrente me mbulim deri në 100%, ashtu siç parashikohet në VKM-në nr. 225. Gjithashtu, është kërkuar përfshirja e kostove për ambalazhimin dhe etiketimin si kosto të mbulueshme, si dhe qartësimi i trajtimit të shërbimeve të konsulencës në kuadër të procesit të certifikimit të standardeve.

4. Komisioni i Ndihmës Shtetërore, pas vlerësimit të kërkesës së AIDA-s, konstaton se vendimi nr. 132, datë 29.4.2026, është një akt administrativ i rregullt, i nxjerrë në përputhje të plotë me ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në fuqi. Përcaktimi i intensiteteve të ndihmës (10%, 20% dhe 50%) dhe kategorizimi i shpenzimeve në vendimin e KNSH-së nr. 132/2026, pasqyrojnë tavanet maksimale të lejuara dhe kriteret e përcaktuara në legjislacionin e ndihmës shtetërore për përputhshmërinë e skemave të mbështetjes me tregun e përbashkët. Për rrjedhojë, pretendimi i institucionit zbatues të ndihmës (AIDA) për ekzistencën e "mospërputhjeve" ligjore midis dy akteve nuk qëndron. VKM-ja nr. 225/2026 përcakton kriteret e përgjithshme të politikës për zhvillimin e biznesit, ndërsa vendimi i KNSH-së garanton që ky financim publik të mos cenojë konkurrencën, duke aplikuar rregullat e ndihmës për investime, ndihmës për konsulencë apo ndihmës *de minimis*, sipas natyrës ekonomike të çdo shpenzimi.

5. Megjithatë, duke vlerësuar se skema synon rritjen e konkurrueshmërisë së NMVM-ve dhe duke marrë parasysh vështirësitë teknike të evidentuara nga AIDA për administrimin dhe vlerësimin e aplikimeve brenda kufijve të vendimit të KNSH nr. 132/2026, analizon se kërkesa e AIDA-s mund të pranohet pjesërisht. Ky ndryshim nuk bëhet për shkak mospërputhjeje, por në funksion të harmonizimit teknik dhe fleksibilitetit procedural, duke rikategorizuar disa nga aktivitetet (si krijimi i platformave elektronike dhe proceset e ambalazhimit) nën instrumente të tjera të lejuara nga legjislacioni i ndihmës shtetërore (si rregullorja *de minimis* ose ndihmat

për NMVM-të), pa cenuar kërkesat ligjore të vendimmarrjes së KNSH-së.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të neneve 4, 8, 22, 23 dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar:

VENDOSI:

Kreu II, pikat 2 dhe 3, "Përshkrimi i masës" ndryshon si vijon:

"2. Qëllimi: Skema synon dhënien e përfitimit me fond nga buxheti i shtetit për mbështetjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM), të cilat synojnë rritjen e konkurrueshmërisë së tyre, zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve, inovacionin dhe rinovimin e teknologjisë, me qëllim nxitjen e eksportit dhe forcimin e aftësive të NMVM-ve, lidhur me shërbimet dhe produktet për një treg të qëndrueshëm.

3. Baza ligjore e planit të ndihmës: Plani i ndihmës shtetërore mbështetet në pikën 2, të nenit 9, të ligjit nr. 43/2022, "Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme" dhe VKM-së nr. 225, datë 1.4.2026, "Për përcaktimin e masës së përfitimit, kritereve dhe kushteve të veçanta të përfitimit për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, për vitin 2026".".

Kreu III, pika 14, "Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore" ndryshon, si më poshtë:

"14. Plani i ndihmës ofrohet nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe financohet nga buxheti i shtetit përmes programit ekonomik (04130) "Mbështetje për zhvillimin ekonomik". Vlera totale e skemës është 100,000,000 lekë. Prandaj, ndihma akordohet përmes burimeve shtetërore. Lidhur me përfituesit e ndihmës, ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM), skema parashikon mbulimin e kostove të miratuara deri në 100%, por jo më shumë se 2,500,000 lekë për një aplikues. Plani i ndihmës, ka në fokus rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit privat, forcimin e potencialit eksportues të vendit. Bazuar në këtë skemë, ndërmarrjet aktive në të gjithë sektorët e ekonomisë do të sigurojnë një avantazh ekonomik në formë e mbështetjes me grante direkte që do të mundësojnë uljen e kostove të tyre të prodhimit/shërbimit. Në këtë mënyrë ndihma ofron një avantazh ekonomik pasi lehtëson përfituesit nga kostot që do të duhej të përballonin në kushte normale tregu. Skema është selektive, pasi nuk është e hapur për të gjithë operatorët ekonomikë në treg, por vetëm për ndërmarrjet që plotësojnë kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 43/2022, "Për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme" dhe që përzgjidhen si fituese nëpërmjet procedurës së aplikimit, bazuar në plane biznesi të fokusuara në nxitjen e eksportit dhe inovacionit. Skema në mënyrë të drejtpërdrejtë mund të shtrembërojë ose të kërcënojë të shtrembërojë konkurrencën, pasi forcon pozicionin në konkurrencë të përfituesve të saj në tregun vendas dhe ndërkombëtar.".

Kreu IV, pika 15, Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës, ndryshon si më poshtë:

"15. Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson skemën e njoftuar në përputhje me nenin 8 të ligjit nr. 9374/2005, "Për ndihmën shtetërore", i ndryshuar, i cili parashikon:

"Ndihma *de Minimis*" është e lejueshme nëse, pavarësisht nga forma ose qëllimi për të cilin i jepet një ndërmarrjeje, nuk kalon vlerën maksimale për një aktivitet të caktuar, për një periudhë financiare prej tre vjetësh.

Mbështetur në kreun II të VKM-së nr. 605, datë 31.8.2016, "Për përcaktimin e vlerës maksimale, të kushteve dhe të procedurës për dhënien e ndihmës *de minimis*", ndihma lejohet nëse përmbushen njëherazi kushtet e mëposhtme:

- Vlera totale e ndihmës për një ndërmarrje të vetme nuk tejkalon 14,000,000 lekë gjatë një periudhe prej tre viteve financiare;
- Ndihma është transparente dhe ekuivalenti bruto i grantit mund të llogaritet përpara dhënies së saj.

Në rastin konkret, këto kushte plotësohen në nivel skeme pasi ndihma individuale maksimale nuk e kalon vlerën 2,500,000 lekë, kohëzgjatja e skemës është e kufizuar brenda vitit buxhetor 2026, dhe ndihma jepet në formën e grantit direkt (ndihmë transparente).

Megjithatë, duke qenë se skemat e mbështetjes së AIDA-s janë të përvitshme dhe ndërmarrjet mund të përfitojnë nga burime të ndryshme të ndihmës shtetërore, përmbushja e kërkesës për

respektimin e tavanit ligjor prej 14,000,000 lekësh për çdo përfitues sigurohet nëpërmjet detyrimit të AIDA-s për të kryer verifikimin paraprak të ndihmave që ka përfituar secili aplikues (nëpërmjet vetëdeklarimit me shkrim dhe bazës së saj të të dhënave) përpara nënshkrimit të çdo marrëveshjeje granti. Përgjegjësia për respektimin e tavanin ligjor trevjeçar *de minimis* gjatë zbatimit të skemës është e AIDA-s në cilësinë e zbatuesit të skemës.".

Pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5, të vendimit të KNSH-së nr. 132, datë 29.4.2026, ndryshojnë dhe zëvendësohen si më poshtë:

"1. Të autorizojë skemën e ndihmës shtetërore në formën e grantit "Fondi për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme për vitin 2026", si masë ndihme "*De Minimis*", të miratuar me VKM-në nr. 225, datë 1.4.2026, "Për përcaktimin e masës së përfitimit, kritereve dhe kushteve të veçanta të përfitimit për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme, për vitin 2026".

2. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në cilësinë e autoritetit zbatues, detyrohet të sigurojnë që përpara nënshkrimit të aktit të akordimit (kontratës së grantit), çdo ndërmarrje përfituese të paraqesë një deklaratë zyrtare me shkrim mbi çdo ndihmë tjetër *de minimis* të pranuar gjatë dy viteve të mëparshme financiare dhe vitit financiar në vijim nga AIDA apo nga çdo dhënës/autoritet tjetër shtetëror, duke garantuar që shuma totale e përfituar e ndihmave të mos kalojë tavanin prej 14,000,000 lekësh.

3. AIDA detyrohet të mbajë një bazë të dhënash të brendshme me informacionin e plotë për çdo ndërmarrje përfituese dhe të njoftojë zyrtarisht Sekretariatin e Komisionit të Ndihmës Shtetërore, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të marrëveshjes së grantit, me qëllim monitorimin dhe përditësimin e të dhënave, në përputhje me procedurat ligjore në fuqi për ndihmën shtetërore.

4. AIDA detyrohet që brenda datës 31 mars të çdo viti të paraqesë raport pranë KNSH-së për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar. Raportet e zbatimit duhet të përmbajnë informacion të detajuar mbi shpenzimet e bëra dhe produktet e arritura.

5. Të gjitha të dhënat dhe dokumentacioni për zbatimin e skemës dhe ndihmën individuale të akorduar duhet të ruhen nga AIDA për një periudhë prej 10 (dhjetë) vitesh, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.".

6. Ky vendim ndryshon vendimin e Komisionit të Ndihmës Shtetërore nr. 132, datë 29.4.2026.

7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetar: Delina Ibrahimaj

Anëtarë: Mimoza Dhëmbi, Besnik Çina, Keida Qirko, Ahmet Mançellari

URDHËR
Nr. 276, datë 20.7.2026

PËR ADMINISTRIMIN E REGJISTRIT TË INSPEKTORËVE, NUMRIT UNIK TË IDENTIFIKIMIT DHE KARTËS SË INSPEKTORIT

Në mbështetje të nenit 13, pika 1, germa "k", nenit 47, të ligjit nr. 99/2024, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 25, të VKM-së nr. 778, datë 19.12.2025, "Për përzgjedhjen, emërimin, vlerësimin e rezultateve në punë, disiplinën, shkarkimin dhe lirimin nga detyra të kryeinspektorit, inspektorit të inspektoratit qendror dhe inspektoratit të përgjithshëm",

URDHËROJ:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky urdhër përcakton rregullat për krijimin, administrimin dhe funksionimin e Regjistrit të Inspektorëve, mënyrën e gjenerimit dhe administrimit të Numrit Unik të Identifikimit të Inspektorit (NUI), Numrit të Kartës së Inspektorit (NKI), si dhe procedurat për prodhimin, personalizimin, lëshimin, përdorimin, zëvendësimin, revokimin dhe verifikimin elektronik të Kartës së Inspektorit.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij urdhri është:

a) krijimi i një sistemi unik për regjistrimin dhe identifikimin e inspektorëve;

b) administrimi i Regjistrit të Inspektorëve në sistemin elektronik *e-Inspektimi*;

c) garantimi i identifikimit unik dhe të përhershëm të çdo inspektori;

ç) rregullimi i procedurave për gjenerimin dhe administrimin e Numrit Unik të Identifikimit (NUI) dhe Numrit të Kartës së Inspektorit (NKI);

d) garantimi i administrimit të sigurt, të saktë dhe të përditësuar të të dhënave të inspektorëve;

dh) mundësimi i identifikimit elektronik të inspektorëve gjatë ushtrimit të funksioneve inspektuese;

e) garantimi i gjurmueshmërisë së historikut administrativ dhe profesional të inspektorëve.

Neni 3
Fusha e zbatimit

Ky urdhër zbatohet nga:

a) Inspektorati i Përgjithshëm, si autoritet përgjegjës për administrimin e Regjistrit të Inspektorëve dhe sistemit elektronik *e-Inspektimi*;

b) institucionet inspektuese që ushtrojnë funksione inspektimi sipas legjislacionit në fuqi;

c) çdo inspektor i regjistruar në Regjistrin e Inspektorëve.

Neni 4
Përkufizime

Për qëllime të këtij urdhri, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "**Regjistri i Inspektorëve**" është regjistri elektronik kombëtar që administrohet nga Inspektorati i Përgjithshëm nëpërmjet sistemit elektronik *e-Inspektimi*;

b) "**Numri Unik i Identifikimit**" **(NUI)** është identifikuesi unik, personal dhe i pandryshueshëm i çdo inspektori;

c) "**Numri i Kartës së Inspektorit**" **(NKI)** është identifikuesi unik i Kartës së Inspektorit, i lidhur elektronikisht me NUI;

ç) "**Karta e Inspektorit**" është dokumenti zyrtar i identifikimit të inspektorit gjatë ushtrimit të funksioneve të tij;

d) "***e-Inspektimi***" është sistemi elektronik për administrimin e Regjistrit të Inspektorëve dhe të proceseve të identifikimit të inspektorëve;

dh) "**Historiku elektronik**" është regjistrimi kronologjik i të gjitha veprimeve dhe ndryshimeve që lidhen me statusin e inspektorit, NUI dhe Kartën e Inspektorit.

KREU II
REGJISTRI I INSPEKTORËVE

Neni 5
Administrimi i Regjistrit të Inspektorëve

1. Regjistri i Inspektorëve administrohet nga Inspektorati i Përgjithshëm nëpërmjet sistemit elektronik *e-Inspektimi*.

2. Regjistri shërben për identifikimin unik të inspektorëve, administrimin e statusit të tyre, historikut profesional dhe të të dhënave të nevojshme për ushtrimin e funksioneve inspektuese.

3. Regjistri administrohet në mënyrë të centralizuar dhe garanton:

a) identifikimin unik të çdo inspektori;

b) integritetin dhe saktësinë e të dhënave;

c) ruajtjen e historikut të ndryshimeve;

ç) gjurmueshmërinë e veprimeve të kryera në sistem;

d) ndërveprimin me sistemet elektronike shtetërore, sipas legjislacionit në fuqi;

dh) administrimin e Numrit Unik të Identifikimit (NUI) dhe Numrit të Kartës së Inspektorit (NKI).

4. Inspektorati i Përgjithshëm është përgjegjës për administrimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e Regjistrit të Inspektorëve.

Neni 6
Të dhënat që regjistrohen

1. Për çdo inspektor regjistrohen, të paktën këto të dhëna:

a) emri;

b) mbiemri;

c) numri personal i identifikimit;

ç) fotografia;

d) institucioni inspektues;
dh) drejtoria ose njësia organizative;
e) funksioni;
ë) fusha e inspektimit;
f) data e emërimit;
g) statusi;
gj) Numri Unik i Identifikimit (NUI);
h) Numri i Kartës së Inspektorit (NKI);
i) statusi i kartës;
j) data e lëshimit;
k) adresa zyrtare e postës elektronike;
l) të dhëna të tjera të nevojshme për administrimin e statusit të inspektorit, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Struktura e plotë e të dhënave të Regjistrit përcaktohet në shtojcën nr. 4, të këtij urdhri.

Neni 7
Regjistrimi dhe përditësimi i të dhënave

1. Institucioni inspektues është përgjegjës për regjistrimin fillestar të të dhënave të inspektorit në sistemin elektronik *e-Inspektimi*.

2. Çdo ndryshim në të dhënat e inspektorit regjistrohet në sistem pa vonesë dhe jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e hyrjes në fuqi të aktit administrativ që ka sjellë ndryshimin.

3. Përditësimi i të dhënave kryhet nga përdorues të autorizuar, sipas roleve dhe të drejtave të aksesit të përcaktuara nga Inspektorati i Përgjithshëm.

4. Inspektorati i Përgjithshëm monitoron saktësinë dhe plotësinë e të dhënave të regjistruara dhe, kur konstaton pasaktësi ose mospërputhje, kërkon korrigjimin e tyre nga institucioni përkatës.

5. Çdo ndryshim në të dhënat e regjistruara dokumentohet elektronikisht dhe shoqërohet me datën, orën dhe identifikimin e përdoruesit që ka kryer veprimin.

Neni 8
Historiku i Regjistrit të Inspektorëve

1. Regjistri i Inspektorëve ruan historikun e plotë të karrierës profesionale të çdo inspektori.

2. Historiku përfshin, në veçanti:
a) regjistrimin fillestar;
b) ndryshimet e institucionit inspektues;
c) ndryshimet e funksionit;
ç) ndryshimet e njësisë organizative;
d) ndryshimet e fushës së inspektimit;
dh) pezullimin ose rikthimin në detyrë;
e) çaktivizimin e statusit të inspektorit;
ë) lëshimin, zëvendësimin ose revokimin e kartës së inspektorit;
f) të dhëna të tjera që lidhen me administrimin e statusit të inspektorit;
g) ndryshimet e Numrit të Kartës së Inspektorit (NKI).

3. Historiku i regjistruar nuk mund të fshihet ose të zëvendësohet, por vetëm të plotësohet me të dhëna të reja, duke garantuar integritetin dhe gjurmueshmërinë e informacionit.

4. Të gjitha veprimet e kryera në Regjistrin e Inspektorëve regjistrohen automatikisht në *log*-un elektronik të sistemit *e-Inspektimi* dhe ruhen sipas rregullave për administrimin e dokumenteve elektronike.

KREU III
NUMRI UNIK I IDENTIFIKIMIT TË INSPEKTORIT (NUI)

Neni 9
Pajisja me Numrin Unik të Identifikimit

1. Çdo inspektor pajiset me Numrin Unik të Identifikimit (NUI) pas regjistrimit në Regjistrin e Inspektorëve dhe përpara pajisjes me Kartën e Inspektorit.

2. NUI gjenerohet automatikisht nga sistemi elektronik *e-Inspektimi*.

3. NUI është unik, personal dhe i përhershëm.

4. NUI përdoret për identifikimin e inspektorit në Regjistrin e Inspektorëve, në Kartën e Inspektorit dhe në sistemet elektronike që mbështesin veprimtarinë inspektuese.

Neni 10
Struktura e Numrit Unik të Identifikimit

1. NUI përbëhet nga elemente alfanumerike të gjeneruara automatikisht nga sistemi elektronik *e-Inspektimi*.

2. Struktura e NUI nuk përmban të dhëna personale ose elemente që identifikojnë institucionin, funksionin apo fushën e inspektimit.

3. Rregullat teknike për gjenerimin e NUI përcaktohen në shtojcën nr. 1, të këtij urdhri.

Neni 11
Administrimi i Numrit Unik të Identifikimit

1. NUI administrohet nga Inspektorati i Përgjithshëm nëpërmjet sistemit elektronik *e-Inspektimi*.
2. NUI lidhet elektronikisht me të gjitha të dhënat identifikuese dhe profesionale të inspektorit.
3. NUI nuk ndryshohet gjatë të gjithë periudhës në të cilën personi është i regjistruar në Regjistrin e Inspektorëve.
4. NUI nuk mund të përdoret nga një person tjetër.

Neni 12
Përditësimi i të dhënave

1. Ndryshimi i institucionit, funksionit, njësisë organizative ose fushës së inspektimit nuk sjell ndryshimin e NUI-t.
2. Në këto raste përditësohen vetëm të dhënat përkatëse në Regjistrin e Inspektorëve.
3. Çdo ndryshim regjistrohet në historikun elektronik të inspektorit.

Neni 13
Çaktivizimi i Numrit Unik të Identifikimit

1. NUI çaktivizohet kur inspektori humbet statusin e inspektorit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Pas çaktivizimit, NUI ruhet në Regjistrin e Inspektorëve dhe nuk mund t'i ricaktohet një personi tjetër.
3. Çaktivizimi i NUI-t nuk cenon ruajtjen e historikut administrativ dhe profesional të inspektorit.

Neni 14
Statusi i Numrit Unik të Identifikimit

1. Statusi i NUI-t në Regjistrin e Inspektorëve mund të jetë:
a) aktiv;
b) pezulluar;
c) çaktivizuar.

2. Në rast rikthimi në detyrë, NUI riaktivizohet, duke ruajtur të njëjtin identifikues unik dhe historikun administrativ.

KREU IV
KARTA E INSPEKTORIT

Neni 15
Pajisja me Kartën e Inspektorit

1. Çdo inspektor pajiset me Kartën e Inspektorit pas pajisjes me Numrin Unik të Identifikimit (NUI).
2. Karta e Inspektorit është dokumenti zyrtar i identifikimit të inspektorit gjatë ushtrimit të funksioneve të tij.
3. Karta prodhohet dhe personalizohet nga Inspektorati i Përgjithshëm nëpërmjet sistemit elektronik *e-Inspektimi*, sipas modelit të miratuar.
4. Karta është pronë e Inspektoratit të Përgjithshëm dhe përdoret vetëm nga mbajtësi i saj.

Neni 16
Numri i Kartës së Inspektorit (NKI)

1. Çdo Kartë Inspektori pajiset me një Numër të Kartës së Inspektorit (NKI), i gjeneruar automatikisht nga sistemi elektronik *e-Inspektimi*.
2. NKI-ja lidhet elektronikisht me NUI-n.
3. NKI-ja ndryshon vetëm në rast rilëshimi të Kartës së Inspektorit.
4. Ndryshimi i NKI-së nuk sjell ndryshimin e NUI-t.

Neni 17
Përmbajtja e Kartës së Inspektorit

1. Karta e Inspektorit përmban, të paktën:
a) stemën ose logon zyrtare;
b) emrin dhe mbiemrin e inspektorit;
c) fotografinë;
ç) funksionin;
d) institucionin inspektues;
dh) Numrin e Kartës së Inspektorit (NKI);
e) kodin QR;
ë) elementet e sigurisë;
f) datën e lëshimit.
2. Modeli dhe specifikimet teknike të Kartës së Inspektorit përcaktohen në shtojcën nr. 2, të këtij urdhri.

Neni 18
Vlefshmëria e Kartës së Inspektorit

1. Karta e Inspektorit është e vlefshme për aq kohë sa mbajtësi i saj gëzon statusin e inspektorit.
2. Vlefshmëria e kartës verifikohet nëpërmjet sistemit elektronik *e-Inspektimi*.
3. Karta humbet vlefshmërinë në rastet e parashikuara në këtë urdhër ose në legjislacionin në fuqi.

Neni 19
Rilëshimi i Kartës së Inspektorit

1. Karta e Inspektorit rilëshohet, në rastet e:
a) humbjes ose vjedhjes së kartës;
b) dëmtimit ose kur karta është bërë e papërdorshme;
c) ndryshimit të emrit ose mbiemrit të inspektorit;
ç) ndryshimit të fotografisë zyrtare;
d) përmirësimit të elementeve teknike ose të sigurisë së kartës;
dh) çdo rasti tjetër kur rilëshimi është i nevojshëm për identifikimin e saktë të inspektorit.
2. Në rast rilëshimi, gjenerohet një NKI i ri, ndërsa NUI mbetet i pandryshuar.
3. Karta e mëparshme çaktivizohet automatikisht në sistemin elektronik *e-Inspektimi* dhe nuk mund të përdoret më për ushtrimin e funksioneve inspektuese.

Neni 20
Procedura e rilëshimit të Kartës së Inspektorit

1. Kërkesa për rilëshimin e Kartës së Inspektorit paraqitet nga institucioni inspektues ose nga inspektori pranë Inspektoratit të Përgjithshëm.
2. Pas verifikimit të kërkesës, Inspektorati i Përgjithshëm prodhon dhe lëshon kartën e re.
3. Çdo rilëshim regjistrohet në Regjistrin e Inspektorëve dhe në historikun elektronik të inspektorit.

Neni 21
Revokimi dhe çaktivizimi i Kartës së Inspektorit

1. Karta e Inspektorit revokohet dhe çaktivizohet në sistemin elektronik *e-Inspektimi* në rastet, kur:
a) inspektori humbet statusin e inspektorit;
b) përfundon marrëdhënia e punës;
c) karta është lëshuar mbi bazën e të dhënave të pasakta;
ç) konstatohet përdorim i paligjshëm ose keqpërdorim i kartës;
d) raste të tjera të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.
2. Revokimi ose çaktivizimi regjistrohet menjëherë në sistemin elektronik *e-Inspektimi*.
3. Historiku i kartës së revokuar ruhet në Regjistrin e Inspektorëve dhe mbetet i aksesueshëm për qëllime administrative dhe auditimi.

KREU V
ADMINISTRIMI ELEKTRONIK

Neni 22
Verifikimi elektronik i Kartës së Inspektorit

1. Çdo Kartë Inspektori pajiset me një kod QR unik, i gjeneruar automatikisht nga sistemi elektronik *e-Inspektimi*.
2. Kodi QR shërben për verifikimin elektronik të vlefshmërisë së Kartës së Inspektorit dhe statusit të inspektorit në kohë reale.
3. Verifikimi elektronik realizohet nëpërmjet sistemit elektronik *e-Inspektimi*, duke mundësuar akses vetëm në të dhënat e nevojshme për identifikimin e inspektorit, sipas nivelit të autorizimit të përdoruesit.
4. Çdo verifikim regjistrohet automatikisht në sistem, duke garantuar gjurmueshmërinë e veprimeve të kryera.
5. Specifikimet teknike të kodit QR dhe procedurat e verifikimit elektronik përcaktohen në shtojcën nr. 3, të këtij urdhri.

KREU VI
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 23
Përgjegjësitë për zbatimin

1. Inspektorati i Përgjithshëm është përgjegjës, për:
a) administrimin e Regjistrit të Inspektorëve;
b) administrimin e sistemit elektronik *e-Inspektimi* në funksion të identifikimit të inspektorëve;

c) gjenerimin dhe administrimin e Numrit Unik të Identifikimit (NUI);

ç) prodhimin, personalizimin dhe administrimin e Kartës së Inspektorit;

d) administrimin e Numrit të Kartës së Inspektorit (NKI);

dh) garantimin e funksionimit, sigurisë dhe integritetit të sistemit.

2. Institucionet inspektuese janë përgjegjëse, për:

a) regjistrimin dhe përditësimin e të dhënave të inspektorëve;

b) garantimin e saktësisë së të dhënave të regjistruara;

c) njoftimin pa vonesë të çdo ndryshimi që ndikon në statusin e inspektorit ose të Kartës së Inspektorit;

ç) administrimin e kartës së inspektorit gjatë marrëdhënies së punës.

3. Drejtoria e Vlerësimit të Riskut dhe Metodologjisë së Inspektimit në Inspektoratin e Përgjithshëm administron procedurat për prodhimin, personalizimin, shpërndarjen, zëvendësimin dhe revokimin e Kartës së Inspektorit.

Neni 24
Aktet zbatuese

1. Inspektorati i Përgjithshëm miraton, sipas nevojës, procedurat teknike dhe specifikimet funksionale për administrimin e Regjistrit të Inspektorëve, gjenerimin e identifikuesve unikë dhe prodhimin e Kartës së Inspektorit.

2. Katalogët e kodeve, modelet e dokumenteve, specifikimet teknike dhe shtojcat e këtij urdhri përditësohen me urdhër të Inspektorit të Përgjithshëm, kur kjo është e nevojshme për zbatimin e legjislacionit ose zhvillimin e sistemit elektronik *e-Inspektimi*, pa cenuar identifikuesit unikë të gjeneruar më parë.

3. Katalogët e kodeve përcaktohen në shtojcën nr. 5, të këtij urdhri.

Neni 25
Auditimi dhe siguria e sistemit

1. Sistemi elektronik *e-Inspektimi* regjistron automatikisht çdo veprim të kryer mbi Regjistrin e Inspektorëve, Numrin Unik të Identifikimit (NUI) dhe Kartën e Inspektorit.

2. Regjistrimet e auditimit (*Audit Log*) përmbajnë, të paktën:

a) identifikimin e përdoruesit;

b) datën dhe orën e veprimit;

c) llojin e veprimit të kryer;

ç) të dhënat e përditësuara;

d) rezultatin e veprimit.

3. Regjistrimet e auditimit ruhen sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi dhe nuk mund të ndryshohen ose fshihen nga përdoruesit e sistemit.

4. Inspektorati i Përgjithshëm merr masat e nevojshme teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë, integritetit dhe disponueshmërisë së të dhënave.

Neni 26
Mbrojtja e të dhënave personale

1. Përpunimi i të dhënave personale sipas këtij urdhri kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Aksesi në Regjistrin e Inspektorëve dhe në sistemin elektronik *e-Inspektimi* lejohet vetëm për përdoruesit e autorizuar, sipas kompetencave të tyre.

3. Të dhënat përdoren vetëm për qëllimet e përcaktuara në këtë urdhër dhe nuk përpunohen në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 27
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të këtij urdhri shfuqizohet urdhri nr. 32, datë 15.7.2016, "Për miratimin e modelit të kartës së inspektorit", si dhe çdo akt tjetër që bie në kundërshtim me këtë urdhër.

Neni 28
Hyrja në fuqi

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM
Dashnor Sula

SHTOJCA NR. 1

STRUKTURA DHE RREGULLAT E GJENERIMIT TË NUMRIT UNIK TË IDENTIFIKIMIT (NUI)
(në zbatim të nenit 10 të urdhrit)

1. Qëllimi

Kjo shtojcë përcakton strukturën, rregullat e gjenerimit, administrimit dhe përdorimit të Numrit Unik të Identifikimit të Inspektorit (NUI).

2. Përkufizim

Numri Unik i Identifikimit (NUI) është identifikuesi elektronik unik, personal dhe i pandryshueshëm që gjenerohet nga sistemi elektronik *e-Inspektimi* dhe i caktohet çdo inspektori vetëm një herë.

3. Rregullat e gjenerimit

NUI:

a) gjenerohet automatikisht nga sistemi elektronik;

b) është unik për çdo inspektor;

c) nuk mund të krijohet ose ndryshohet manualisht;

ç) nuk mund të ripërdoret;

d) ruhet gjatë të gjithë ciklit administrativ të inspektorit.

4. Struktura

NUI përbëhet nga një kombinim karakteresh alfanumerike me gjatësi fikse, të gjeneruara automatikisht nga sistemi elektronik. NUI ka formatin standard:

NUI-YYYY-NNNNN

ku:

a) **NUI** është kodi identifikues i strukturës së Numrit Unik të Identifikimit;

b) **YYYY** është viti i regjistrimit të parë të inspektorit në Regjistrin e Inspektorëve dhe nuk përbën të dhënë të ndryshueshme të statusit të inspektorit;

c) **NNNN** është numri rendor unik i gjeneruar automatikisht nga sistemi dhe nuk mund të ndryshohet ose ripërdoret.

Shembull: NUI-2026-00015

MODELI I REGJISTRIT TË NUI-t

Nr.	NUI	Emër	Mbiemër	IQ	Fusha	Funksioni	Data e regjistrimit	Statusi	Nr. rendor
1	NUI-2026-000001								
2	NUI-2026-000002								

5. Administrimi

NUI lidhet elektronikisht, me:

- Regjistrin e Inspektorëve;
- Kartën e Inspektorit;
- Numrin e Kartës së Inspektorit (NKI);
- Historikun administrativ të inspektorit.

SHTOJCA NR. 2

MODELI DHE SPECIFIKIMET E KARTËS SË INSPEKTORIT

(në zbatim të nenit 17 të urdhrit)

1. NKI përbëhet si:

-—

Emërtimi i shkurtuar i IQ-së	Kodi i IQ-së	Kodi i drejtorisë së përgjithshme/rajonale	Numri rendor automatik i gjeneruar
ISHPSHSH	01	01	0001

Shembull: ISHPSHSH-0101-0001

2. Ana e përparme

Përmban:

- Stemën e Republikës së Shqipërisë;
- Logon e Inspektoratit të Përgjithshëm;
- fotografinë;
- emrin;
- mbiemrin;
- funksionin;
- institucionin;
- Numrin e Kartës së Inspektorit (NKI);
- datën e lëshimit.
- kodin QR;

3. Ana e pasme

Përmban:

- përmbajtja;
- ky dokument identifikon punonjësin e Inspektoratit të Përgjithshëm;
- mbajtësi i tij ushtron detyrat sipas ligjit nr. 99/2024, "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;
- ky dokument është pronë e institucionit dhe duhet të kthehet menjëherë në përfundim të marrëdhënies së punës ose kur kërkohet nga organet kompetente;
- Inspektori i Përgjithshëm Firma & Vula.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
INSPEKTORATI I PËRGJITHSHËM
REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
INSPEKTORATI I PËRGJITHSHËM
EMER MBIEMER
FUNKSIONI
INSPEKTORATI
QENDROR
EEMËRTIMI I SHKURTUAR I IQ-KODI IQ-
KODI DREJTORI
PËRGJITHSHME/RAJONALE-NR RENDOR
DATA E LËSHIMIT
DD.MM.2026

INSPEKTORATI I
PËRGJITHSHËM
Ky dokument identifikon punonjësin e Inspektoratit të Përgjithshëm.
Mbajtësi i tij ushtron detyrat sipas Ligjit nr. 99/2024 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
Ky dokument është pronë e institucionit dhe duhet të kthehet menjëherë në përfundim të marrëdhënies së punës ose kur kërkohet nga organet kompetente.
INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM
DASHNOR SULA
REPUBLIKA E SHQIPËRISË-INSPEKTORATI I PËRGJITHSHËM
Adresa:
Kompleksi Delijorgji,
Rr. M. Llagami, Tiranë
Tel:
042 229765
042 229883
www.ip.gov.al
info@ip.gov.al
Në rast gjetjeje, ju lutem ta dorëzoni pranë Inspektoratit të Përgjithshëm ose njoftoni numrin e telefonit të institucionit.

x

SHTOJCA NR. 3

SPECIFIKIMET E KODIT QR DHE PROCEDURAT E VERIFIKIMIT ELEKTRONIK

(në zbatim të nenit 22 të urdhrit)

1. Kodi QR

Çdo Kartë Inspektori përmban një kod QR unik.

2. Funksioni

Kodi QR përdoret, për:

a) verifikimin e vlefshmërisë së kartës;
b) verifikimin e statusit të inspektorit;
c) identifikimin elektronik.

3. Përmbajtja

Kodi QR nuk përmban të dhëna personale.

Ai përmban vetëm identifikuesin teknik që mundëson lidhjen me sistemin ***e-Inspektimi***.

4. Verifikimi

Pas skanimit të kodit QR sistemi shfaq:

a) emrin dhe mbiemrin;
b) institucionin;
c) funksionin;
d) statusin e kartës.

5. Siguria

Kodi QR nuk mund të modifikohet.

Çdo verifikim regjistrohet në *Audit Log*.

SHTOJCA NR. 4

STRUKTURA E REGJISTRIT TË INSPEKTORËVE DHE FUSHAT E TË DHËNAVE

(në zbatim të nenit 6 të urdhrit)

1. Qëllimi

Kjo shtojcë përcakton strukturën minimale të Regjistrit të Inspektorëve dhe të dhënat që administrohen në sistemin elektronik *e-Inspektimi*.

2. Të dhënat identifikuese

Nr.	Të dhënat
1	Numri Unik i Identifikimit (NUI)
2	Emri
3	Mbiemri
4	Numri personal
5	Fotografia zyrtare
6	Institucioni inspektues
8	Njësia organizative
9	Funksioni
10	Fusha kryesore e inspektimit
11	Data e emërimit
12	Data e regjistrimit
13	Statusi i inspektorit
14	Numri i Kartës së Inspektorit (NKI)
15	Data e lëshimit të kartës
16	Statusi i kartës
17	Adresa elektronike zyrtare

18	Historiku i transferimeve
19	Historiku i kartave
20	Shënime administrative

3. Të dhënat institucionale

Nr.	Fusha
1	Institucioni inspektues
2	Kodi i institucionit
3	Drejtoria
4	Sektori/njësia organizative
5	Pozicioni i punës
6	Funksioni
7	Dega rajonale

4. Të dhënat profesionale

Nr.	Fusha
1	Fusha kryesore e inspektimit
2	Fusha dytësore e inspektimit (nëse ka)
3	Data e emërimit
4	Data e fillimit të ushtrimit të funksionit
5	Statusi i inspektorit
6	Data e regjistrimit në Regjistër

5. Të dhënat e identifikimit elektronik

Nr.	Fusha
1	Numri Unik i Identifikimit (NUI)
2	Numri i Kartës së Inspektorit (NKI)
3	Statusi i kartës
4	Data e lëshimit të kartës
5	Data e skadimit të kartës
6	QR Code
7	Identifikuesi elektronik i kartës

6. Të dhënat e kontaktit

Nr.	Fusha
1	*Email*-i zyrtar
2	Numri i telefonit zyrtar (nëse administrohet)

7. Statusi administrativ

Kodi	Statusi
A	Aktiv
P	Pezulluar
T	Transferuar
L	Larguar nga funksioni
Ç	Çaktivizuar

8. Historiku profesional

Për çdo inspektor regjistrohen:
- regjistrimi fillestar;
- emërimi;
- konfirmimi në detyrë;
- transferimet;
- ndryshimi i institucionit;
- ndryshimi i funksionit;
- ndryshimi i njësisë organizative;

- ndryshimi i fushës së inspektimit;
- pezullimi;
- rikthimi në detyrë;
- përfundimi i marrëdhënieve të punës;
- çaktivizimi i statusit;
- lëshimi i kartës;
- rilëshimi i kartës;
- zëvendësimi i kartës;
- revokimi i kartës.

9. Të dhënat e *Audit Log*

Për çdo veprim sistemi regjistron automatikisht:

Nr.	Fusha
1	Data
2	Ora
3	Përdoruesi
4	Institucioni
5	Veprimi i kryer
6	Objekti i ndryshimit
7	Adresa IP (kur administrohet)
8	Komenti i sistemit

SHTOJCA NR. 5

KATALOGËT DHE KLASIFIKIMET E SISTEMIT ELEKTRONIK *E-INSPEKTIMI*

(në zbatim të nenit 24 të urdhrit)

1. Qëllimi

Kjo shtojcë përcakton katalogët standardë që përdoren nga sistemi elektronik *e-Inspektimi* për administrimin e Regjistrit të Inspektorëve.

2. Katalogu i institucioneve inspektuese

Përmban:
- kodin;
- emërtimin;
- llojin e institucionit;
- statusin.

3. Katalogu i fushave të inspektimit - Përmban fushat sipas legjislacionit sektorial.

Nr.		Inspektoratet qendrore	KODI I IQ-së	Fushat e inspektimit	Kodi i fushës së inspektimit
1	ISHPSHSH-ja	Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore	Kodi 01	1. Inspektimi ne punë	Kodi 01
2	AKU-ja	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit	Kodi 02	1. Inspektimi i OBU-së me origjinë shtazore;	Kodi 02
				2. Inspektimi i OBU-së me origjinë jo shtazore;	Kodi 03
				3.Inspektimi i mbrojtjes së bimëve dhe inputeve bujqësore;	Kodi 04
				4. Inspektim për IPARD-in;	Kodi 05
				5. Plani i monitorimit të qumështit lëndë e parë (Prodhim Primar);	Kodi 06

				6. Materiale në kontakt me ushqimin.	Kodi 07
3	AKM-ja	Agjencia Kombëtare e Mjedisit	Kodi 03	1. Inspektim në ujëra;	Kodi 08
				2. Inspektim në mjedis.	Kodi 09
4	AKAP-i	Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar	Kodi 04	1. Inspektimi në arsimin parashkollor (kopshtet);	Kodi 10
				2. Inspektimi në arsimi bazë (arsimi fillor dhe arsimi i mesëm i ulët);	Kodi 11
				3. Inspektimi në arsimin e mesëm dhe të lartë;	Kodi 12
				4. Inspektim për pajtueshmërinë e veprimtarisë së ZVAP-së me aktet ligjore dhe nënligjore;	Kodi 13
				5. Inspektim në Shkollën e Bashkuar.	Kodi 14
5	ISHTI	Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial	Kodi 05	1. Inspektimi i gazit dhe i naftës;	Kodi 15
				2. Inspektimit i pajisjeve nën presion;	Kodi 16
				3. Inspektimi i pajisjeve dhe instalimeve elektrike;	Kodi 17
				4. Transmetim shpërndarjeje, tregtim, depozitim, ndërtim e operim të infrastrukturës së gazit natyror.	Kodi 18
6	ISHSH-ja	Inspektorati Shtetëror Shëndetësor	Kodi 06	Inspektime të tjera shëndetësore;	Kodi 19
				Inspektim sanitar;	Kodi 20
				Inspektimi shëndetësor;	Kodi 21
				Inspektim për akreditim.	Kodi 22
7	ZMR-ja	Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet	Kodi 07	Inspektimi për Aparaturat me rreze X;	Kodi 23
				Inspektimi i burimeve radioaktive të hapura;	Kodi 24
				Inspektimi për burime të mbyllura;	Kodi 25
				Inspektimi për subjektet që kryejnë transport të lëndëve radioaktive.	Kodi 26
8	AKSEM-i	Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat Minerare	Kodi 08	1. Inspektimi në sipërfaqe;	Kodi 27
				2. Inspektimi në nëntokë.	Kodi 28
9	ISHMT-ja	Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut	Kodi 09	E drejta e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to;	Kodi 29
				Inspektimi për të drejtat e pronësisë industriale;	Kodi 30
				Inspektimi i detergjenteve;	Kodi 31
				Inspektim për mbrojtjen e konsumatorëve;	Kodi 32
				Inspektim i pajisjeve elektrike;	Kodi 33
				Inspektime të produkteve-instalimeve mekanike;	Kodi 34
				Inspektimi për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore;	Kodi 35
				Inspektimi metrologjik;	Kodi 36
				Inspektimi i produkteve qelq-këpucë-sig. produkteve;	Kodi 37
				Inspektimi i artikujve piroteknik;	Kodi 38
				Inspektimi i qeseve plastike mbajtëse.	Kodi 39
10	IKMT-ja		Kodi 10	Inspektime në mjedis dhe në ujëra	Kodi 40

		Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit		Inspektim në pyje	Kodi 41
				Inspektim në ndërtim	Kodi 42
11	AKBPM-ja	Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore	Kodi 11	Inspektimi i depove farmaceutike;	Kodi 43
				Inspektimi i farmacive private;	Kodi 44
				Inspektimi i farmacive spitalore;	Kodi 45
				Inspektim fabrikuesit e barnave;	Kodi 46
				Inspektim depo e pajisjeve mjekësore.	Kodi 47
12	DSHPA-ja	Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës (DSHPA)	Kodi 12	1. Inspektimi në peshkim;	Kodi 48
				2. Inspektimi në Akuakulturë;	Kodi 49
13	DPA-ja	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	Kodi 13	1. Inspektim për zbatimin e detyrave ne sekretari/arkiv;	Kodi 50
				2. Për licencimin e arkivave privatë;	Kodi 51
				3. Inspektimin në arkivat e sistemit dhe tipologjisë.	Kodi 52
14	AKB-ja	Agjencia Kombëtare e Bregdetit	Kodi 14	Inspektim në turizëm.	Kodi 53
15	AKZM-ja	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura	Kodi 15	1. Inspektimi për zonat e mbrojtura.	Kodi 54
16	AKVMB-ja	Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve	Kodi 16	Inspektime në farmaci veterinare;	Kodi 55
				Inspektime në depo farmaceutike veterinare;	Kodi 56
				Inspektime në ferma gjedhi mbi 5 krerë;	Kodi 57
				Inspektime në ferma të imta mbi 70 krerë;	Kodi 58
				Inspektime në stabilimentet e derrave;	Kodi 59
				Inspektime në stabilimentet e shpendëve;	Kodi 60
				Inspektime në stabilimentet e akuakulturës;	Kodi 61
				Inspektime të parqeve me bletë mbi 50 krerë;	Kodi 62
				Inspektime në tregjet e kafshëve të gjalla;	Kodi 63
				Inspektime të subjekteve që tregtojnë produktet me origjinë shtazore.	Kodi 64

4. Katalogu i strukturave organizative

Përmban:

- drejtoritë;
- sektorët;
- njësitë.

5. Katalogu i funksioneve

Përmban:

- Kryeinspektor;
- inspektor;
- funksione të tjera të miratuara.

6. Administrimi i katalogëve

1. Katalogët administrohen nga Inspektorati i Përgjithshëm nëpërmjet sistemit elektronik *e-Inspektimi*.

2. Përditësimi i katalogëve kryhet me miratimin e Inspektorit të Përgjithshëm, kur është i nevojshëm për zbatimin e legjislacionit ose zhvillimin e sistemit elektronik.

VENDIM
Nr. 73, datë 16.6.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Asim Vokshi	anëtar;
Ilir Toska	anëtar,

me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 16.6.2026, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 3 (S) 2026 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Stela Ulqinaku, përfaqësuar nga studioja e avokatisë "Daci and Associates" sh.p.k., me prokurë të posaçme.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Autoriteti i Aviacionit Civil, përfaqësuar nga Dorina Hajdari, me autorizim.

Departamenti i Administratës Publike, përfaqësuar nga drejtoresha e deleguar Enkela Dudushi.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-2954, datë 10.7.2025, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 5, 42, 43, 81, 116, 122, 131, pika 1, shkronja "f", 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, 135, 142 dhe 145 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 49, pika 3, shkronja "e", dhe 71/a, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim pretendimet e kërkueses Stela Ulqinaku (*kërkuesja*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Autoritetit të Aviacionit Civil (*AAC*) dhe Departamentit të Administratës Publike *(DAP)*, të cilët kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja ka qenë e punësuar pranë AAC-së prej vitit 2015. Gjatë vijimit të kësaj marrëdhënieje, me aktin nr. 5377, datë 16.7.2018, të DAP-it, ajo është emëruar si nëpunëse civile në pozicionin e përgjegjëses së Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Arkivës, ndërsa prej datës 10.6.2019, në pozicionin e drejtoreshës së Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun.

2. Rekrutimi i kërkueses si nëpunëse civile ka ndodhur gjatë kohës kur ishte në fuqi ligji nr. 10233, datë 11.2.2010, "Për autoritetin e aviacionit civil", i ndryshuar (*ligji i mëparshëm i AAC-së*), i cili është shfuqizuar me ligjin nr. 53/2022, "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil" (*ligji i ri i AAC-së*). Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, me vendimin nr. 22, datë 26.1.2023 (*vendimi nr. 22/2023*), të përgjegjëses së sektorit të burimeve njerëzore të AAC-së, është vendosur përfundimi i marrëdhënies së kërkueses në shërbimin civil, me arsyetimin se sipas nenit 17, pika 2, të ligjit të ri të AAC-së, marrëdhëniet e punës së punonjësve të saj rregullohen nga dispozitat e Kodit të Punës dhe se, për pasojë, AAC-ja kishte dalë nga skema e shërbimit civil. Në vijim, me urdhrin nr. 52, datë 26.1.2023 (*urdhri nr. 52/2023*), të drejtorit ekzekutiv të AAC-së, kërkuesja është liruar nga pozicioni "drejtore e Drejtorisë së Administratës dhe Shërbimeve Mbështetëse" dhe është emëruar në pozicionin "Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse" në drejtorinë e administratës pranë këtij autoriteti. Më pas, me urdhrin nr. 96, datë 27.1.2023 (*urdhri nr. 96/2023*) të AAC-së, është vendosur ndërprerja e marrëdhënieve të punës dhe financiare me kërkuesen, duke filluar nga data 27.1.2023, për shkak të refuzimit prej saj të detyrës së re të caktuar sipas organizimit të ri të institucionit.

3. Në datën 2.3.2023, duke mos qenë dakord me këto akte, me pretendimin se ajo gëzonte statusin e nëpunëses civile sipas ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar (*Ligji për Nëpunësin Civil*), dhe se ky ligj nuk ishte respektuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të saj në shërbimin

civil, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi, duke kërkuar: i. shfuqizimin e aktit administrativ, vendimit nr. 22/2023, të AAC-së, për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil; ii. shfuqizimin e aktit administrativ, urdhrit nr. 52/2023, të AAC-së, për lirimin nga pozicioni i drejtoreshës së Drejtorisë së Administratës dhe shërbimeve Mbështetëse dhe emërimin në pozicionin e Përgjegjëses së Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse, në drejtorinë e administratës; iii. shfuqizimin e veprimit administrativ, procesverbalit nr. 158/2 prot., datë 26.1.2023, të AAC-së; iv. shfuqizimin e aktit administrativ, urdhrit nr. 96/2023 të AAC-së, për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe financiare; v. rikthimin e saj si nëpunëse civile në vendin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të së njëjtës kategori, si dhe pagimin e pagës mujore që kishte në momentin e largimit, nga data e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

4. Me vendimin nr. 1293, datë 25.5.2023, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka shpallur moskompetencën lëndore për gjykimin e çështjes dhe ia ka dërguar aktet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si gjykata kompetente nga pikëpamja lëndore dhe tokësore. Ajo ka arsyetuar se mosmarrëveshja midis palëve nuk kishte natyrë juridike administrative, por civile, ndaj kompetenca për shqyrtimin e saj i përkiste gjykatës civile. Sipas këtij vendimi, kundër tij lejohej ankim së bashku me vendimin përfundimtar. Pas organizimit të ri gjyqësor, çështja është regjistruar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

5. Në vijim, pas pretendimeve të ngritura nga kërkuesja, në lidhje me kompetencën lëndore, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në datën 16.6.2025, bazuar në nenin 64 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), i është drejtuar Gjykatës së Lartë për rregullimin e kompetencës lëndore, duke parashtruar qëndrimin se, referuar materialeve të çështjes dhe natyrës së mosmarrëveshjes së ngritur nga kërkuesja, kompetenca lëndore i përkiste gjykatës administrative.

6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2025-2954, datë 10.7.2025, ka rregulluar kompetencën lëndore midis gjykatave, duke përcaktuar Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë si gjykatën kompetente dhe duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Në mënyrë të përmbledhur, Kolegji Civil ka vlerësuar se përcaktimi i kompetencës lëndore nuk bëhet vetëm mbi bazën e emërtimit formal të kërkimeve të padisë, por kërkon vlerësimin e natyrës juridike të mosmarrëveshjes, objektit dhe shkakut juridik të padisë, së drejtës së pretenduar, faktit të paligjshëm të pretenduar dhe ligjit të zbatueshëm. Në zbatim të këtyre parimeve në rastin konkret, Kolegji Civil ka çmuar se në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies dhe të paraqitjes së padisë ishte në fuqi ligji i ri i AAC-së, sipas të cilit marrëdhëniet e punës së punonjësve të saj rregullohen nga Kodi i Punës. Mbi këtë bazë, ai ka arritur në përfundimin se marrëdhënia e kërkueses nuk i përkiste më regjimit të shërbimit civil dhe se mosmarrëveshja kishte natyrë civile.

7. Pas vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, sipas informacionit të marrë për nevoja të shqyrtimit kushtetues, gjykimi i çështjes është duke vijuar në fazën e veprimeve përgatitore përpara Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

8. Në datën 22.1.2026, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese *(Gjykata)* me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për rregullimin e kompetencës. Në datën 31.3.2026, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, në datën 15.4.2026, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

9. Në lidhje me shqyrtimin e çështjes, Gjykata vlerësoi se ishte rasti për nxjerrjen e saj nga kalendari i zakonshëm dhe shqyrtimin me përparësi. Në këtë drejtim, ajo mbajti parasysh se vendimi i kundërshtuar, ndonëse ka natyrë procedurale, përcaktonte gjykatën përpara së cilës do të vijonte shqyrtimi i çështjes së themelit dhe, për rrjedhojë, ndikonte drejtpërdrejt në zhvillimin e mëtejshëm të atij procesi. Duke qenë se gjykimi i themelit ishte ende në vijim, ndërsa pretendimet e kërkueses lidheshin me efektet e këtij përcaktimi mbi aksesin substancial në gjykatë, mjetin juridik efektiv dhe gjykatën e caktuar me ligj, Gjykata çmoi se shqyrtimi me përparësi ishte i nevojshëm për të shmangur

zgjatjen e pasigurisë procedurale dhe për të garantuar efektivitetin e kontrollit kushtetues.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. *Kërkuesja,* në mënyrë të përmbledhur, ka *parashtruar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në drejtim të:

10.1 *Së drejtës së aksesit substancial në gjykatë,* pasi vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ndonëse formalisht është një vendim i ndërmjetëm mbi kompetencën lëndore, në fakt ka prodhuar efekte përfundimtare, duke e privuar nga mundësia për të pasur një shqyrtim në themel të kërkimeve të padisë nga gjykata që, sipas natyrës reale të mosmarrëveshjes, ishte kompetente. Çështja nuk përbën një mosmarrëveshje të zakonshme pune ose thjesht një konflikt kompetence ndërmjet gjykatave, por lidhet me efektin real që vendimi i kundërshtuar ka prodhuar mbi aksesin efektiv në gjykatë dhe mbi mbrojtjen e statusit të fituar si nëpunëse civile. Orientimi i çështjes drejt juridiksionit civil e bën të pamundur shqyrtimin e plotë të kërkimeve që lidhen me shfuqizimin e akteve të nxjerra nga AAC-ja, rikthimin në statusin e nëpunëses civile dhe pasojat që rrjedhin nga ky status. Kërkuesja nuk ka asnjë mjet efektiv për të çuar përpara pretendimet e saj, pasi gjykatat administrative tashmë nuk mund ta gjykojnë më çështjen, ndërsa gjykatat civile mund të gjykojnë vetëm një pjesë të pretendimeve, madje edhe ato të ndryshme në thelb nga kërkimet e parashtruara në padi. Ajo ka vënë në lëvizje gjykatën brenda afateve ligjore dhe nuk mund t'i ngarkohet barra e pasojave të krijuara nga konflikti i kompetencës ose nga koha e nevojitur për zgjidhjen e tij nga Gjykata e Lartë. Ndarja ndërmjet juridiksionit administrativ dhe atij civil është mjet organizimi i sistemit gjyqësor dhe nuk mund të shërbejë si instrument për të penguar mbrojtjen efektive të individit.

10.2 *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi konflikti për kompetencën lëndore është zgjidhur nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, ndërkohë që kërkimet e padisë lidhen me ligjshmërinë e akteve administrative dhe me statusin e nëpunëses civile. Për pasojë, çështja e kompetencës nuk duhej të shqyrtohej nga Kolegji Civil, por nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ose nga një trup me përbërje të përzier ose nga Kolegjet e Bashkuara. Si pasojë e vendimit të kundërshtuar, çështja do të shqyrtohet nga gjykata civile dhe jo nga gjykata administrative, e cila i përgjigjet natyrës së mosmarrëveshjes dhe kërkimeve kryesore të padisë. Për rrjedhojë, është cenuar parashikueshmëria e forumit gjyqësor dhe besimi i saj tek administrimi i drejtësisë, pasi garancia e gjykatës së caktuar me ligj nuk nënkupton vetëm ekzistencën formale të një gjykate, por edhe përcaktimin e qartë, të parashikueshëm dhe jo arbitrar të juridiksionit.

10.3 *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi Gjykata e Lartë nuk ka kryer një analizë substanciale të natyrës së mosmarrëveshjes dhe ka deformuar objektin real të padisë. Ajo është fokusuar te përfundimi se marrëdhënia e punës rregullohej nga Kodi i Punës, pa analizuar në mënyrë të plotë aktet që lidhen me përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil dhe kërkimin për rikthim në këtë status. Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje çështjeve thelbësore që buronin nga natyra e mosmarrëveshjes, konkretisht nëse gjykata civile mund të shqyrtojë ligjshmërinë e akteve të kundërshtuara, të vendosë për rikthimin në statusin e nëpunëses civile, të trajtojë rolin e DAP-it dhe t'u japë përgjigje pasojave procedurale të krijuara nga konflikti i kompetencës.

10.4 *Parimit të sigurisë juridike,* pasi vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ndonëse pranon se kërkuesja ka pasur statusin e nëpunëses civile, ka arritur në përfundimin se, për shkak të hyrjes në fuqi të ligjit të ri të AAC-së, marrëdhënia e saj e punës duhet të konsiderohet e rregulluar nga Kodi i Punës. Ky interpretim ka prodhuar në thelb efektin e humbjes së statusit të nëpunëses civile dhe të garancive që lidhen me të, pa një shqyrtim në themel të ligjshmërisë së akteve administrative që kanë çuar në ndërprerjen e këtij statusi dhe pa mundësuar përdorimin e mekanizmave mbrojtës të parashikuar nga legjislacioni i nëpunësit civil. Statusi i nëpunësit civil është pozitë juridike individuale e fituar dhe nuk mund të konsiderohet i humbur automatikisht për shkak të ndryshimeve ligjore që lidhen me organizimin e institucionit. Mungesa e dispozitave kalimtare në ligjin e ri të AAC-së nuk mund të interpretohet kundër individit dhe në favor të humbjes automatike të statusit, pasi kjo do të

cenonte pritshmëritë legjitime, parashikueshmërinë dhe stabilitetin e marrëdhënieve juridike. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka injoruar edhe parimin e hierarkisë së normave juridike, të përcaktuar në nenin 116 të Kushtetutës, si dhe natyrën e Ligjit për Nëpunësin Civil, të miratuar me shumicë të cilësuar sipas nenit 81 të Kushtetutës, i cili, për këtë arsye, ka epërsi ndaj ligjit të ri të AAC-së.

10.5 *Së drejtës për mjet juridik efektiv,* pasi vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë ka krijuar një situatë në të cilën ajo nuk disponon më një forum gjyqësor efektiv për shqyrtimin e pretendimeve thelbësore të padisë. Problemi nuk qëndron në faktin se gjykata civile nuk mund të shqyrtojë një konflikt pune, por në faktin se në këtë juridiksion kërkimet që lidhen me ruajtjen dhe mbrojtjen e statusit të nëpunëses civile, ligjshmërinë e akteve që kanë sjellë përfundimin e këtij statusi dhe pasojat që rrjedhin prej tij nuk mund të marrin përgjigje të plotë. Nëse çështja trajtohet vetëm si marrëdhënie pune e rregulluar nga Kodi i Punës, kërkimet e saj reduktohen në dëmshpërblim ose në pasojat e zgjidhjes së marrëdhënies së punës, duke mbetur pa shqyrtim pretendimet që lidhen me statusin e nëpunëses civile.

11. *Subjekti i interesuar, AAC-ja,* ka prapësuar si vijon:

11.1 Kërkuesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave të pretenduara, pasi ende nuk ka një gjykim dhe vendim përfundimtar për themelin e mosmarrëveshjes. Vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është i ndërmjetëm, me të cilin ajo gjykatë është shprehur vetëm për kompetencën lëndore, pa u marrë në shqyrtim themeli i çështjes, qoftë edhe tërthorazi. Procesi gjyqësor i themelit vijon përpara Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ku kërkuesja ka ende mundësi të parashtrojë pretendimet e saj. Në rastin konkret nuk plotësohen kushtet kur një vendim i ndërmjetëm mund të bëhet objekt i kontrollit kushtetues, pasi kërkuesja nuk ka provuar se vendimi i kundërshtuar i ka cenuar drejtpërdrejt një të drejtë kushtetuese ose se efektet e tij nuk mund të riparohen gjatë gjykimit të themelit.

11.2 Pretendimet e kërkueses nuk ngrenë një çështje të mirëfilltë kushtetuese, por lidhen kryesisht me kundërshtimin e mënyrës së interpretimit dhe zbatimit të ligjit nga gjykatat e zakonshme, në veçanti nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë. Fakti që kërkuesja nuk pajtohet me interpretimin e bërë nga Gjykata e Lartë për kompetencën lëndore, nuk mjafton për të ngritur një çështje kushtetuese, për sa kohë ajo nuk argumenton sesi vendimi i kundërshtuar i ka cenuar një të drejtë kushtetuese. Në këtë kuptim, ankimi kushtetues synon, në thelb, rishqyrtimin e ligjshmërisë së interpretimit të dispozitave mbi kompetencën lëndore, ndërkohë që Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se nuk vepron si një shkallë e katërt gjykimi për vlerësimin e mënyrës së interpretimit dhe zbatimit të ligjit nga gjykatat e zakonshme.

11.3.Pretendimet për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë dhe të së drejtës për një mjet juridik efektiv janë të pabazuara. Kërkuesja ka ushtruar mjetet procedurale të parashikuara nga ligji dhe çështja e kompetencës është shqyrtuar në nivelet përkatëse të juridiksionit të zakonshëm, ndërkohë që gjykimi i themelit vijon përpara gjykatës së përcaktuar si kompetente. Pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri të AAC-së, marrëdhëniet e punës së punonjësve të saj rregullohen nga Kodi i Punës dhe, në mungesë të dispozitave kalimtare, ky ligj është i zbatueshëm edhe për përcaktimin e kompetencës lëndore. Për rrjedhojë, orientimi i çështjes drejt gjykatës së juridiksionit të përgjithshëm nuk përbën mohim të aksesit në drejtësi ose cenim të procesit të rregullt ligjor, por zbatim të rregullave procedurale për përcaktimin e gjykatës kompetente. Për më tepër, vendimi i kundërshtuar i është bërë i ditur kërkueses në datën 26.9.2025, ndërkohë që ajo ka marrë dijeni për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në datën 27.1.2023. Në këtë kuptim, kërkuesja ka qenë ende në kohë për të ngritur pretendimet e saj sipas parashikimeve të nenit 203 të Kodit të Punës. Për rrjedhojë, kërkuesja ka pasur në dispozicion mjete procedurale për të kërkuar mbrojtjen e pretendimeve të saj, ndaj pasojat e zgjedhjeve të saj procedurale nuk mund t'i transferohen Gjykatës së Lartë.

11.4 I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike, si dhe pretendimi se çështja ka natyrë administrative ose hibride, për aq kohë sa statusi i nëpunëses civile kërkueses i është njohur dhe hequr nga vetë ligji. Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri të AAC-së, marrëdhëniet e punës së punonjësve të këtij autoriteti rregullohen nga Kodi i Punës dhe, në momentin e përfundimit të marrëdhënieve të punës, kërkuesja nuk e gëzonte më statusin e nëpunëses civile. Urdhri për

ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe financiare nuk përbën akt administrativ ose kontratë administrative, por shprehjen e vullnetit të organit publik, në cilësinë e punëdhënësit, për t'i dhënë fund marrëdhënies së punës. Organi publik në këtë rast nuk vepron në ushtrim të funksionit administrativ. Për këtë arsye, ndaj këtij urdhri nuk mund të disponohet mbi bazën e dispozitave që rregullojnë shfuqizimin e akteve administrative, referuar për këtë edhe vendimit unifikues nr. 7, datë 1.6.2011, të Gjykatës së Lartë, sipas të cilit zgjidhja e marrëdhënies së punës nga një organ publik nuk krijon marrëdhënie administrative, por marrëdhënie pune ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit.

12. *Subjekti i interesuar, DAP-i,* ka prapësuar si vijon:

12.1 Është i pabazuar pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë, pasi:

12.1.1 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka disponuar vetëm për rregullimin e kompetencës lëndore të gjykatave, vendimmarrje e cila nuk mund të konsiderohet si vlerësim për themelin e padisë, për ligjshmërinë e veprimeve administrative të kundërshtuara ose për ekzistencën e të drejtave subjektive të pretenduara nga kërkuesja. Kërkuesja ka ushtruar të drejtën e saj për t'iu drejtuar gjykatës me paraqitjen e kërkesëpadisë dhe gjykimi i themelit vijon përpara gjykatës së përcaktuar si kompetente, ku ajo ka mundësi të parashtrojë pretendimet e saj. Përcaktimi i gabuar nga kërkuesja i gjykatës kompetente nuk mund t'i adresohet Gjykatës së Lartë. Për më tepër, përcaktimi i gjykatës kompetente nuk mund të konsiderohet cenim i aksesit në gjykatë.

12.1.2 Kërkuesja, me argumentet e saj, paragjykon rezultatin e procesit gjyqësor që është ende në vijim dhe rrugëzgjidhjet procedurale që mund të ofrojë gjykata e themelit për pretendimet e saj. Në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies, ajo rregullohej nga Kodi i Punës dhe, për këtë arsye, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se, për të disponuar mbi kërkimet me natyrë civile, kompetente nga ana lëndore dhe funksionale është Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Ky vendim nuk i ka mohuar kërkueses mundësinë që për pretendime të tjera qartësisht të natyrës administrative t'i drejtohet gjykatës kompetente.

12.1.3 E drejta e aksesit në gjykatë nuk është absolute dhe mund t'u nënshtrohet kufizimeve procedurale, siç janë rregullat mbi kompetencën, juridiksionin dhe afatet procedurale, për sa kohë ato janë të parashikuara në ligj, ndjekin një qëllim të ligjshëm, si garantimi i sigurisë juridike dhe administrimi i rregullt i drejtësisë, janë proporcionale dhe nuk cenojnë thelbin e së drejtës. Në këtë kuptim, zgjidhja e konfliktit të kompetencës lëndore, e parashikuar në nenin 64 të KPC-së, synon garantimin e shqyrtimit të çështjes nga gjykata kompetente dhe nuk përbën pengesë për aksesin në gjykatë, por kusht procedural për administrimin e rregullt të drejtësisë. Cenimi i aksesit në gjykatë do të ishte i konceptueshëm vetëm nëse kërkuesja do të ishte privuar përfundimisht nga mundësia për t'iu drejtuar një organi gjyqësor, situatë që nuk ekziston në rastin konkret.

12.2 I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike. Kërkuesja e ka lidhur këtë pretendim me ndryshimin e ligjit organik të AAC-së, pa argumentuar sesi vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për përcaktimin e kompetencës lëndore e ka cenuar këtë parim. Për sa i përket ligjit të zbatueshëm, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se, me hyrjen në fuqi të ligjit të ri të AAC-së dhe shfuqizimin e ligjit të mëparshëm organik, AAC-ja ka dalë nga skema e shërbimit civil dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të saj rregullohen nga Kodi i Punës. Pavarësisht se në momentin e lindjes dhe vijimësisë së marrëdhënies së punës kërkuesja ka pasur statusin e nëpunëses civile, në momentin e ndërprerjes së saj, më 27.1.2023, marrëdhënia rregullohej nga ligji i ri nr. 53/2022. Ndryshimi i ligjit nuk e ka përkeqësuar situatën juridike të kërkueses, pasi institucioni i ka ofruar mundësinë e sistemimit në një pozicion tjetër, të cilin ajo nuk e ka pranuar.

12.3 I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, pasi:

12.3.1 Vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nuk ka cenuar zgjidhjen në themel të çështjes, por, përkundrazi, ka garantuar vijimin e saj përpara gjykatës së përcaktuar si kompetente, në kushtet kur gjykatat më të ulëta kishin mbajtur qëndrime të ndryshme për kompetencën lëndore. Ky vendim është marrë sipas nenit 64 të KPC-së, në dhomën e këshillimit dhe në kuadër të një çështjeje të ngritur nga gjykatat, jo nga palët, për rregullimin e kompetencës. Për më tepër, kërkuesja ka pasur dhe vijon të ketë në dispozicion mjetet procedurale për mbrojtjen e të drejtave të saj në gjykimin e themelit.

12.3.2 Vonesa në shqyrtimin e çështjes nuk ka ardhur si rezultat i ushtrimit të kompetencës nga Gjykata e Lartë, por si pasojë e konfliktit të kompetencës së krijuar në nivelet më të ulëta të juridiksionit. Mekanizmi i rregullimit të kompetencës synon shmangien e pasigurisë procedurale dhe vijimin normal të gjykimit në themel. Procesi i rregullt ligjor nuk mund të reduktohet vetëm te shpejtësia e gjykimit, pasi një proces i zhvilluar nga një gjykatë jokompetente do të cenonte standardet e procesit të rregullt ligjor. Për këtë arsye, duhet të ruhet balanca ndërmjet aksesit efektiv, afatit të arsyeshëm dhe respektimit të kompetencës së përcaktuar me ligj.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkueses

13. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a, të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

14. Në këtë këndvështrim, kërkuesja, si individ, legjitimohet/ *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, pasi është palë në procesin gjyqësor në kuadër të të cilit është dhënë vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë dhe ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

15. Në lidhje me kriterin paraprak të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, kërkuesja ka pretenduar se ato duhet të konsiderohen të shteruara, për sa kohë vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ndonëse formalisht është vendim procedural për kompetencën, ka prodhuar efekt përfundimtar mbi të drejtën për akses substancial në gjykatë, si dhe mbi atë për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj. Sipas saj, së pari, ky vendim i ka mbyllur rrugën për shqyrtimin e çështjes nga gjykata që, sipas natyrës së mosmarrëveshjes dhe kërkimeve të padisë, duhej të shqyrtonte në themel pretendimet e ngritura prej saj. Së dyti, Gjykata e Lartë është shprehur përfundimisht për çështjen e kompetencës lëndore dhe ndaj këtij vendimi nuk ka më mjete të tjera efektive ankimi. Së treti, megjithëse vendimi duket i shkëputur nga themeli, në realitet, sipas kërkueses, ai ka sjellë pasoja thelbësore, pasi, si rrjedhojë e tij, pretendimet e saj kryesore, që lidhen me statusin e nëpunëses civile, rikthimin në këtë status dhe pasojat që rrjedhin prej tij, nuk do të shqyrtohen nga gjykata që, sipas saj, i përgjigjet natyrës administrative të mosmarrëveshjes dhe kërkimeve të padisë. Për këtë arsye, sipas kërkueses, vendimi procedural për kompetencën ka prodhuar pasoja të drejtpërdrejta dhe të pakthyeshme mbi të drejtat e saj kushtetuese.

16. Në lidhje me këtë kriter të legjitimimit, subjekti i interesuar, AAC-ja, ka pretenduar se kërkuesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive, pasi vendimi i kundërshtuar është një vendim për rregullimin e kompetencës lëndore të gjykatave për shqyrtimin e çështjes së themelit dhe, si i tillë, nuk mund të konsiderohet përfundimtar, për sa kohë nuk ka zgjidhur themelin e mosmarrëveshjes dhe procesi gjyqësor vijon përpara gjykatës së përcaktuar si kompetente, ku kërkuesja ka ende mundësi të parashtrojë pretendimet e saj.

17. Gjykata ka pohuar se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, si rregull, mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Kontrolli kushtetues ka natyrë subsidiare, që do të thotë se individi duhet t'i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Cenimi i të drejtave themelore, përfshirë atë për një proces të rregullt ligjor, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte *(shih vendimet nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.3.2021; nr. 75, datë 22.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese).*

18. Gjykata vëren se, në rastin konkret, objekt i ankimit kushtetues individual është vendimi i

Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që ka rregulluar kompetencën lëndore për gjykimin e mosmarrëveshjes së ngritur nga kërkuesja. Për rrjedhojë, në aspektin formal, objekt i ankimit kushtetues individual është një vendim gjyqësor i ndërmjetëm, që nuk e ka zgjidhur në themel çështjen, por ka përcaktuar gjykatën që ka kompetencën lëndore për shqyrtimin e saj. Për vendimet e ndërmjetme, që nuk zgjidhin çështjen në themel, Gjykata në jurisprudencën e saj ka pranuar se ato mund të bëhen, në mënyrë përjashtimore, objekt i kontrollit kushtetues kur: i. shkelja e pretenduar është pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të kundërshtuar; ii. vendimi është shqyrtuar nga gjykatat më të larta, të cilat janë shprehur, qoftë edhe tërthorazi, për të drejtën që pretendohet si e cenuar; iii. vendimi ka një masë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që vendimi përfundimtar nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm dhe as të riparojë efektet e tij *(shih vendimet nr. 22, datë 4.4.2024; nr. 25, datë 13.10.2022; nr. 14, datë 11.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese)*. Në këtë drejtim, edhe kur një vendim nuk zgjidh formalisht themelin e mosmarrëveshjes, ai mund të konsiderohet përfundimtar për qëllime të kontrollit kushtetues, nëse prodhon pasoja të drejtpërdrejta mbi ushtrimin e një të drejte kushtetuese dhe këto pasoja nuk mund të riparohen në mënyrë efektive nga vijimi i gjykimit të themelit *(shih vendimin nr. 12, datë 18.3.2025, të Gjykatës Kushtetuese)*.

19. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata vëren se vendimi i kundërshtuar, ndonëse formalisht nuk zgjidh themelin e çështjes, ka përcaktuar gjykatën përpara së cilës do të vijojë shqyrtimi i mosmarrëveshjes së ngritur nga kërkuesja. Sipas kërkueses, ky përcaktim ka ndikuar drejtpërdrejt në mundësinë e saj për shqyrtimin në themel të të gjitha kërkimeve të padisë nga gjykata që, sipas saj, i përgjigjet natyrës së mosmarrëveshjes dhe është në gjendje t'u japë përgjigje të plotë pretendimeve të saj. Për rrjedhojë, Gjykata do të verifikojë nëse, nisur nga efektet konkrete që pretendohet se ka prodhuar vendimi i kundërshtuar mbi të drejtën e aksesit substancial në gjykatë dhe mbi të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, plotësohen kriteret që lejojnë, përjashtimisht, ushtrimin e kontrollit kushtetues ndaj një vendimi të ndërmjetëm.

20. Për sa i përket kriterit të parë, Gjykata vëren se pretendimi i kërkueses lidhet me faktin se vendimi i Gjykatës së Lartë, duke përcaktuar gjykatën civile si gjykatë kompetente, ka ndikuar drejtpërdrejt jo vetëm në gjykatën përpara së cilës do të vijojë shqyrtimi i çështjes, por edhe në shtrirjen e shqyrtimit që mund t'u bëhet kërkimeve të saj. Për të përcaktuar kompetencën lëndore, Gjykata e Lartë ka mbajtur qëndrim për ligjin e zbatueshëm për marrëdhënien e saj të punës, duke arritur në përfundimin se ajo rregullohej nga Kodi i Punës, ndërkohë që pikërisht ligji i zbatueshëm dhe ruajtja ose humbja e statusit të nëpunëses civile përbënin aspekte thelbësore të mosmarrëveshjes së ngritur në padi. Në këto kushte, ndonëse vendimi i kundërshtuar është dhënë formalisht për kompetencën lëndore, ai ka prodhuar pasoja të drejtpërdrejta jo vetëm mbi gjykatën që duhet të shqyrtojë padinë e kërkueses, por edhe mbi mënyrën sesi mund të shqyrtohen dhe të marrin përgjigje pretendimet kryesore të padisë. Për këtë arsye, këto pasoja lidhen me të drejtën e aksesit substancial në gjykatë, të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, si dhe të drejtën për mjet juridik efektiv. Për rrjedhojë, kriteri i pasojës së drejtpërdrejtë konsiderohet i përmbushur.

21. Për sa i përket kriterit të dytë, Gjykata vëren se vendimi i kundërshtuar është dhënë nga Gjykata e Lartë, si organi që, sipas nenit 64 të KPC-së, vendos për rregullimin e kompetencës lëndore kur gjykatat janë në konflikt midis tyre për çështjen e kompetencës. Për shkak të natyrës së kësaj procedure, vendimi i Gjykatës së Lartë nuk i nënshtrohet një mjeti tjetër ankimi në juridiksionin e zakonshëm. Për rrjedhojë, në rrethanat e rastit konkret, kriteri i shqyrtimit nga gjykata më e lartë kompetente konsiderohet i përmbushur, për sa kohë Gjykata e Lartë është shprehur përfundimisht për kompetencën lëndore dhe, përmes këtij përcaktimi, për gjykatën përpara së cilës kërkuesja duhet të kërkojë mbrojtjen e pretendimeve të saj, si dhe për shtrirjen e shqyrtimit që mund t'u bëhet atyre.

22. Për sa i përket kriterit të tretë, Gjykata vëren se vendimi i Gjykatës së Lartë ka një masë autonomie nga procesi i themelit, pasi gjykata e juridiksionit të përgjithshëm, gjatë shqyrtimit të themelit të çështjes, nuk mund të ndryshojë vendimin e Gjykatës së Lartë për kompetencën lëndore, por është e detyruar ta respektojë atë. Kjo do të thotë se, pavarësisht vijimit të gjykimit civil të themelit, përcaktimi i forumit gjyqësor dhe, si rrjedhojë, edhe shtrirja e shqyrtimit që mund t'u

bëhet kërkimeve të padisë, janë vendosur në mënyrë përfundimtare nga vendimi i kundërshtuar. Në këto kushte, vendimi që do të jepet në përfundim të gjykimit civil nuk është i aftë të ndryshojë këtë përcaktim dhe as të riparojë në mënyrë të plotë pasojën e pretenduar kushtetuese.

23. Për sa më sipër, Gjykata çmon se, në rrethanat e rastit konkret, vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë konsiderohet përfundimtar për qëllime të kontrollit kushtetues, pasi, ndonëse nuk ka zgjidhur themelin e mosmarrëveshjes, përmbush kriteret që lejojnë, në mënyrë përjashtimore, ushtrimin e kontrollit kushtetues ndaj një vendimi të ndërmjetëm. Për rrjedhojë, kërkuesja legjitimohet në drejtim të kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive.

24. Kërkuesja legjitimohet edhe/ *ratione temporis,* në kuptim të përmbajtjes së nenit/ 71/a, pika 1, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ndonëse mban datën 10.7.2025, i është njoftuar në rrugë elektronike përfaqësuesit të kërkueses me *email*-in e datës 26.9.2025, ndërkohë që kërkesa është paraqitur në Gjykatë, në datën 22.1.2026, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

25. Për sa i përket legjitimimit *ratione materiae,* Gjykata vëren se kërkuesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës së aksesit substancial në gjykatë, së drejtës për mjet juridik efektiv, së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe parimit të sigurisë juridike.

26. Për sa i përket së drejtës për gjykim nga një gjykatë e caktuar me ligj, Gjykata vëren se kërkuesja ka parashtruar dy argumente. Së pari, ajo ka pretenduar se konflikti i kompetencës lëndore është zgjidhur nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë dhe jo nga Kolegji Administrativ, nga një trupë me përbërje të përzier ose nga Kolegjet e Bashkuara. Së dyti, ajo ka pretenduar se, si pasojë e vendimit të kundërshtuar, çështja e saj do të shqyrtohet nga gjykata civile dhe jo nga gjykata administrative, e cila, sipas saj, i përgjigjet natyrës së mosmarrëveshjes dhe kërkimeve kryesore të padisë.

27. Në lidhje me argumentin e parë, Gjykata vëren se kërkesa për rregullimin e kompetencës lëndore i është paraqitur Gjykatës së Lartë nga Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, pra nga gjykata civile përpara së cilës çështja ishte dërguar për shqyrtim pas shpalljes së moskompetencës lëndore nga gjykata administrative. Në këtë kuptim, shqyrtimi i kërkesës nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë lidhet me kompetencën funksionale të tij në procedurën konkrete të rregullimit të kompetencës. Po ashtu, Gjykata vëren se neni 64 i KPC-së ia njeh Gjykatës së Lartë kompetencën për zgjidhjen e konfliktit të kompetencës midis gjykatave, ndërsa ndarja e saj në kolegje ka karakter organizativ dhe funksional dhe nuk krijon gjykata të veçanta në kuptimin kushtetues. Për më tepër, kërkuesja nuk ka paraqitur argumente konkrete që të tregojnë se trupi gjykues është formuar në kundërshtim me ligjin ose se Gjykata e Lartë ka vepruar jashtë kompetencës së saj ligjore. Vetëm fakti se në çështjen konkrete vihet në diskutim nëse mosmarrëveshja mes palëve është e natyrës administrative ose civile nuk mjafton për të konsideruar se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vepruar si gjykatë jo e caktuar me ligj. Për rrjedhojë, për sa mbështetet në këtë argument, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj është haptazi i pabazuar.

28. Për sa i përket parimit të sigurisë juridike, Gjykata vëren se kërkuesja e ka lidhur cenimin e tij me faktin se, sipas saj, vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë ka anashkaluar statusin e fituar të nëpunëses civile, aktet administrative mbi bazën e të cilave ajo e ka fituar këtë status, si dhe pritshmëritë e ligjshme që rrjedhin prej tij. Po kështu, sipas kërkueses, përcaktimi i gjykatës civile si gjykatë kompetente ka sjellë pasiguri për sa i përket forumit gjyqësor që duhet të shqyrtojë pretendimet e saj dhe mbrojtjes efektive të të drejtave që ajo pretendon se burojnë nga statusi i nëpunëses civile. Gjykata vlerëson se, në rrethanat e rastit konkret, ky pretendim nuk paraqitet si pretendim i pavarur kushtetues, por ndërthuret me pretendimet që lidhen me mënyrën sesi Gjykata e Lartë ka përcaktuar kompetencën lëndore, me arsyetimin e dhënë prej saj dhe me efektet që ky përcaktim ka prodhuar mbi mundësinë e kërkueses për të kërkuar mbrojtjen gjyqësore të pretendimeve të saj. Për këtë arsye, ai nuk do të trajtohet më vete, por do të mbahet në konsideratë vetëm për aq sa lidhet me pretendimet kryesore për akses substancial në gjykatë, mjet juridik efektiv, standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe gjykatën e caktuar me ligj, në aspektin e përcaktimit të kompetencës lëndore.

29. Për sa u përket pretendimeve të tjera, Gjykata vëren se cenimin e së drejtës së aksesit substancial në gjykatë kërkuesja e ka argumentuar, në thelb, me faktin se vendimi i kundërshtuar ka përcaktuar gjykatën civile si gjykatë kompetente mbi bazën e një vlerësimi paraprak për ligjin e zbatueshëm dhe natyrën juridike të marrëdhënies së punës, ndërkohë që këto çështje përbënin, sipas saj, thelbin e mosmarrëveshjes së ngritur në padi. Pretendimin për cenimin e së drejtës për mjet juridik efektiv kërkuesja e ka lidhur me faktin se, si pasojë e vendimit të Gjykatës së Lartë, mjeti gjyqësor i ndjekur prej saj nuk do të mundësojë shqyrtimin efektiv të pretendimeve kryesore nga gjykata që, sipas saj, ka kompetencën nisur nga natyra administrative e mosmarrëveshjes. Ndërsa pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor kërkuesja e ka lidhur me faktin se Gjykata e Lartë nuk ka analizuar në mënyrë substanciale natyrën e mosmarrëveshjes dhe nuk u ka dhënë përgjigje elementeve që, sipas saj, ishin përcaktues për kompetencën lëndore, veçanërisht për raportin midis statusit të fituar të nëpunëses civile, efekteve të ligjit të ri organik të AAC-së dhe natyrës së akteve të kundërshtuara.

30. Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se pretendimet për cenimin e aksesit substancial në gjykatë, të së drejtës për mjet juridik efektiv dhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor duhet të analizohen të ndërlidhura me njëra-tjetrën. Në këtë analizë do të mbahet në konsideratë edhe argumenti i dytë i kërkueses për të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, për aq sa ai lidhet me efektin që përcaktimi i gjykatës civile si gjykatë kompetente ka prodhuar mbi gjykatën përpara së cilës do të shqyrtohet çështja dhe mbi shtrirjen e shqyrtimit që mund t'u bëhet kërkimeve kryesore të padisë.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e së drejtës së aksesit substancial në gjykatë të lidhur me të drejtën për mjet juridik efektiv, standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj

31. Kërkuesja ka pretenduar se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ndonëse formalisht është vendim i ndërmjetëm për rregullimin e kompetencës lëndore, ka prodhuar efekte përfundimtare mbi të drejtën e saj për akses substancial në gjykatë. Sipas saj, çështja nuk përbën thjesht një konflikt kompetence ndërmjet gjykatave dhe as një mosmarrëveshje të zakonshme pune, por lidhet me efektin real që vendimi i kundërshtuar ka prodhuar mbi mundësinë që kërkimet e padisë të shqyrtohen në themel. Orientimi i çështjes drejt juridiksionit civil, sipas kërkueses, e bën të pamundur shqyrtimin efektiv të kërkimeve kryesore të saj, që lidhen me shfuqizimin e akteve të AAC-së, rikthimin në statusin e nëpunëses civile dhe pasojat që rrjedhin nga ky status.

32. Gjithashtu, kërkuesja ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk ka dhënë një arsyetim të mjaftueshëm për natyrën reale të mosmarrëveshjes, duke u fokusuar kryesisht te përfundimi se, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 53/2022, marrëdhënia e saj rregullohej nga Kodi i Punës. Sipas kërkueses, Gjykata e Lartë nuk ka analizuar në mënyrë të plotë tërësinë e akteve që lidhen me përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil dhe kërkimet për rikthim në këtë status, por ka trajtuar si të zgjidhura në fazën e kompetencës çështje që përbënin vetë thelbin e padisë, konkretisht ligjin e zbatueshëm për marrëdhënien e saj, ruajtjen ose humbjen e statusit të nëpunëses civile dhe pasojat që rrjedhin prej tij. Për rrjedhojë, sipas kërkueses, vendimi i kundërshtuar ka vënë në dyshim edhe të drejtën për mjet juridik efektiv, pasi, nëse çështja trajtohet vetëm si marrëdhënie pune e rregulluar nga Kodi i Punës, kërkimet e saj reduktohen në pasojat e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, duke mbetur pa përgjigje pretendimet që lidhen me statusin e nëpunëses civile, ligjshmërinë e akteve që kanë sjellë përfundimin e tij dhe pasojat që rrjedhin prej këtij statusi.

33. Subjekti i interesuar, AAC-ja, ka prapësuar se pretendimet e kërkueses për cenimin e së drejtës së aksesit substancial në gjykatë, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe së drejtës për mjet juridik efektiv janë të pabazuara. Sipas tij, vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë është akt procedural, me të cilin është zgjidhur vetëm çështja e kompetencës lëndore, pa u marrë në shqyrtim dhe pa u zgjidhur themeli i mosmarrëveshjes. Për këtë arsye, fakti që kërkuesja nuk pajtohet me interpretimin e bërë nga Gjykata e Lartë për kompetencën lëndore nuk mjafton për të ngritur një çështje kushtetuese, për sa kohë Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt për kontrollin e ligjshmërisë së interpretimit dhe zbatimit të ligjit nga gjykatat e zakonshme.

34. Sipas AAC-së, vendimi i kundërshtuar nuk i ka mohuar kërkueses aksesin në gjykatë dhe as mjetin juridik efektiv, pasi ajo ka ushtruar mjetet procedurale të parashikuara nga ligji, çështja e kompetencës është shqyrtuar nga gjykatat përkatëse dhe gjykimi i themelit vijon përpara gjykatës së përcaktuar si kompetente, ku kërkuesja mund të parashtrojë pretendimet e saj. Po sipas këtij subjekti, pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri të AAC-së, marrëdhëniet e punës së punonjësve të saj rregullohen nga Kodi i Punës dhe, në mungesë të dispozitave kalimtare, ky ligj është i zbatueshëm edhe për përcaktimin e kompetencës lëndore. Për rrjedhojë, orientimi i çështjes drejt gjykatës së juridiksionit të përgjithshëm nuk përbën mohim të aksesit në drejtësi ose cenim të mjetit juridik efektiv, por zbatim të rregullave procedurale për përcaktimin e gjykatës kompetente.

35. Subjekti i interesuar, DAP-i, ka prapësuar se pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë është i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë ka disponuar vetëm për rregullimin e kompetencës lëndore, pa shqyrtuar dhe pa zgjidhur themelin e mosmarrëveshjes, ligjshmërinë e akteve të kundërshtuara ose ekzistencën e të drejtave subjektive të pretenduara nga kërkuesja. Sipas tij, përcaktimi i gjykatës kompetente nuk mund të konsiderohet cenim i aksesit në gjykatë, për sa kohë kërkuesja e ka vënë në lëvizje gjykatën dhe gjykimi i themelit vijon përpara Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Kërkuesja, sipas DAP-it, me argumentet e saj paragjykon rezultatin e këtij procesi dhe mundësitë procedurale që mund të ofrojë gjykata e themelit për shqyrtimin e pretendimeve të saj.

36. DAP-i ka prapësuar, gjithashtu, se vendimi i kundërshtuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe as të drejtën për mjet juridik efektiv. Sipas tij, Gjykata e Lartë ka arsyetuar mbi bazën e kërkimeve të padisë dhe të ligjit të zbatueshëm, duke vlerësuar se në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies ajo rregullohej nga Kodi i Punës dhe se, për rrjedhojë, kompetente për shqyrtimin e kërkimeve me natyrë civile ishte gjykata e juridiksionit të përgjithshëm. Sipas DAP-it, rregullat për kompetencën lëndore nuk përbëjnë pengesë për aksesin në gjykatë, por garanci për administrimin e rregullt të drejtësisë dhe për shqyrtimin e çështjes nga gjykata kompetente. Në këtë kuptim, cenimi i aksesit ose i mjetit juridik efektiv do të mund të pretendohej vetëm nëse kërkuesja do të ishte privuar përfundimisht nga mundësia për t'iu drejtuar një organi gjyqësor, situatë që, sipas DAP-it, nuk ekziston në rastin konkret.

37. Neni 42, pika 1, i Kushtetutës parashikon se liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor. Ndërsa pika 2 e këtij neni garanton të drejtën e kujtdo për një gjykim të drejtë dhe publik, brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues e ligjorë të tij.

38. Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit, përfshirë të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Ajo u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik *(shih vendimet nr. 32, datë 3.11.2022; nr. 10, datë 12.4.2022, të Gjykatës Kushtetuese)*. Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të marrë nga gjykata një zgjidhje përfundimtare për çështjen, pasi aksesi në gjykatë duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal *(shih vendimet nr. 5, datë 22.2.2022; nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese)*.

39. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimit gjyqësor është element thelbësor i një vendimmarrjeje të drejtë, pasi u tregon palëve se ato janë dëgjuar dhe u mundëson të kuptojnë bazën mbi të cilën gjykata ka arritur në përfundimin e saj, si dhe, sipas rastit, u jep mundësinë ta kundërshtojnë atë *(shih vendimet nr. 19, datë 10.4.2025; nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 2, datë 11.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese)*. Nga pikëpamja kushtetuese, arsyetimi konsiderohet i mjaftueshëm kur u jep përgjigje pretendimeve thelbësore për zgjidhjen e çështjes, shpjegon lidhjen midis rrethanave të çështjes, ligjit të zbatueshëm dhe përfundimit të arritur, si dhe bën të mundur kontrollin e vendimmarrjes. Ky standard nuk

kërkon që gjykata t'i përgjigjet në mënyrë të detajuar çdo argumenti të palëve, por kërkon që ajo të trajtojë ato pretendime që janë përcaktuese për zgjidhjen e çështjes dhe mungesa e përgjigjes ndaj të cilave mund ta bëjë vendimin të paqartë, kontradiktor ose haptazi të paarsyeshëm.

40. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se përcaktimi i fakteve dhe zbatimi i ligjit në çështjet konkrete janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit *(shih vendimet nr. 85, datë 23.12.2025; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese).* Gjykata ka pohuar se detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyn atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që e bën gjykimin të padrejtë *(shih vendimet nr. 11, datë 11.2.2026; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 29, datë 1.11.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Në këtë kuadër, Gjykata vëren se interpretimi dhe zbatimi i rregullave ligjore për kompetencën lëndore u përkasin, në parim, gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe, në rastet e konfliktit të kompetencës, Gjykatës së Lartë. Megjithatë, kur pretendimi kushtetues lidhet me mënyrën sesi është përcaktuar kompetenca lëndore dhe me efektin që ky përcaktim ka mbi gjykatën përpara së cilës do të shqyrtohet çështja, si dhe mbi mundësinë e individit për të marrë përgjigje gjyqësore për pretendimet thelbësore, kontrolli kushtetues kufizohet në verifikimin nëse arsyetimi gjyqësor u ka dhënë përgjigje elementeve përcaktuese për kompetencën lëndore, në mënyrë që të garantohet respektimi i së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, aksesi substancial në gjykatë dhe efektiviteti i mjetit juridik. Ky kontroll merr rëndësi të veçantë kur, për të përcaktuar kompetencën, gjykata mban qëndrim edhe për çështje që, njëkohësisht, përbëjnë objekt të shqyrtimit në themel të padisë, pasi në këto raste arsyetimi duhet të jetë i tillë që të shmangë paragjykimin e çështjeve të themelit dhe të sigurojë që aksesi në gjykatë të mos mbetet formal.

42. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata vëren se kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi, me objekt, ndër të tjera, shfuqizimin si të paligjshme të akteve të AAC-së për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të hyrjes në fuqi të ligjit të ri të AAC-së, lirimin nga pozicioni dhe emërimin në një pozicion tjetër, si dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe financiare. Po kështu, ajo ka kërkuar rikthimin si nëpunëse civile në vendin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të së njëjtës kategori, si dhe pagesën e pagës nga data e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në ekzekutimin e vendimit gjyqësor.

43. Gjykata vëren se neni 7 i ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar (*Ligji për Gjykatat Administrative*), përcakton kompetencën lëndore të gjykatave administrative. Sipas kësaj dispozite, gjykatat administrative janë kompetente, ndër të tjera, për mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik, si dhe për mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës të nëpunësve civilë dhe të nëpunësve të tjerë që, sipas ligjit organik, kanë një rregullim të posaçëm. Në të njëjtën kohë, kjo dispozitë, ndër të tjera, përjashton nga kompetenca administrative punonjësit në administratën publike, marrëdhënia e punës e të cilëve bazohet në Kodin e Punës.

44. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka shpallur moskompetencën lëndore dhe ka dërguar aktet për gjykim në gjykatën e juridiksionit të përgjithshëm. Ajo ka arsyetuar se mosmarrëveshja midis palëve nuk kishte natyrë juridike administrative, por civile, pasi, me hyrjen në fuqi të ligjit të ri të AAC-ës, kjo e fundit kishte dalë nga shërbimi civil dhe, sipas nenit 17, pika 2, të këtij ligji, marrëdhëniet e punës të punonjësve të saj rregulloheshin nga Kodi i Punës, çka do të thoshte se paditësja (kërkuesja) kishte humbur statusin e nëpunëses civile. Për rrjedhojë, sipas asaj gjykate, për sa kohë marrëdhënia juridike e punës midis palëve bazohej në dispozitat e Kodit të Punës, mosmarrëveshja e rrjedhur prej saj nuk përfshihej në kompetencën lëndore të gjykatave administrative,

pavarësisht se punëdhënësi ishte pjesë e administratës publike, duke iu referuar për këtë nenit 7, shkronja "ç", të Ligjit për Gjykatat Administrative.

45. Nga ana tjetër, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, përpara së cilës çështja ishte dërguar për shqyrtim, i është drejtuar Gjykatës së Lartë për rregullimin e kompetencës lëndore. Sipas saj, referuar natyrës së mosmarrëveshjes së parashtruar nga paditësja (kërkuesja) dhe materialeve të çështjes, kompetenca lëndore i përkiste Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, pasi mosmarrëveshja lidhej me zbatimin e Ligjit për Nëpunësin Civil dhe ligjin e mëparshëm të AAC-së. Po kështu, ajo ka vlerësuar se AAC-ja kishte vepruar në mënyrë të njëanshme dhe pa miratimin e DAP-it, ndërkohë që kërkuesja pretendonte se gëzonte statusin e nëpunëses civile dhe, për këtë arsye, Ligji për Nëpunësin Civil kishte përparësi në raport me çdo ligj tjetër që binte në kundërshtim me të, përfshirë edhe ligjin e ri të AAC-së.

46. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin e kundërshtuar, ka përcaktuar si kompetente Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Në vendimin e tij, Kolegji Civil ka vlerësuar se për përcaktimin e kompetencës lëndore gjykata nuk duhet të mjaftohet me emërtimin formal të kërkimeve në padi, por duhet të analizojë objektin dhe shkakun ligjor të saj, të drejtën subjektive të pretenduar si të cenuar, si dhe faktin e paligjshëm që pretendohet se e ka cenuar këtë të drejtë. Sipas Kolegjit Civil, pavarësisht se kërkuesja, nga pikëpamja formale, kishte kërkuar shfuqizimin e akteve të cilësuara prej saj si akte administrative, në thelb, shkaku i padisë lidhej me paligjshmërinë e ndërprerjes së marrëdhënies së punës nga i padituri.

47. Në vijim, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka evidentuar se, ndonëse në momentin e lindjes dhe vijimësisë së marrëdhënies së punës kërkuesja kishte pasur statusin e nëpunëses civile dhe kjo marrëdhënie, sipas ligjit të mëparshëm të AAC-së, kishte rregullim të posaçëm, në momentin e ndërprerjes së saj, më 27.1.2023, marrëdhënia e punës rregullohej nga Kodi i Punës, në referim të ligjit të ri të AAC-së. Sipas Kolegjit Civil, këto ndryshime ligjore kishin edhe dimension procedural, pasi lidheshin drejtpërdrejt me përcaktimin e kompetencës lëndore për shqyrtimin e mosmarrëveshjes. Në këtë drejtim, ai ka arsyetuar se ligji procedural zbatohet në momentin kur gjykata vihet në lëvizje dhe se për sa kohë ligji i ri i AAC-së nuk kishte parashikuar dispozita kalimtare për mosmarrëveshjet e marrëdhënieve të punës të filluara mbi bazën e ligjit të mëparshëm, për përcaktimin e kompetencës lëndore ishin të zbatueshme dispozitat e ligjit të ri. Në vijim, duke iu referuar parimit *iura novit curia* dhe nenit 7, shkronja "ç", të Ligjit për Gjykatat Administrative, Kolegji Civil ka çmuar se marrëdhënia e punës së kërkueses, sipas nenit 17, pika 2, të ligjit të ri të AAC-së, rregullohej nga Kodi i Punës dhe se, për rrjedhojë, kompetente për shqyrtimin e çështjes ishte gjykata e juridiksionit të përgjithshëm.

48. Në këto rrethana, Gjykata çmon se, për qëllime të kontrollit kushtetues të arsyetimit, çështja nuk qëndron te përcaktimi nga kjo Gjykatë i gjykatës kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjes, por te verifikimi nëse Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje elementeve që, sipas kërkueses, ishin përcaktuese për kompetencën lëndore. Këto elemente lidhen me natyrën e akteve të kundërshtuara, organin që i kishte nxjerrë ato, kërkimet e padisë, statusin e pretenduar të kërkueses si nëpunëse civile dhe ligjin e zbatueshëm për marrëdhënien e saj të punës.

49. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë e ka mbështetur përfundimin e saj kryesisht në nenin 17, pika 2, të ligjit të ri të AAC-së dhe në nenin 7, shkronja "ç", të Ligjit për Gjykatat Administrative, duke arsyetuar se marrëdhënia e punës së kërkueses, në momentin e ndërprerjes së saj, rregullohej nga Kodi i Punës. Megjithatë, në rrethanat kur kërkuesja kishte kundërshtuar akte të nxjerra nga një organ publik, kishte pretenduar se ato kishin disponuar për përfundimin e marrëdhënies së saj në shërbimin civil dhe kishte kërkuar rikthimin në statusin e nëpunëses civile, analiza e kompetencës lëndore nuk mund të kufizohej vetëm te përfundimi se ligji i ri i AAC-së e rregullonte marrëdhënien e punës sipas Kodit të Punës. Gjykata e Lartë duhej të arsyetonte edhe nëse dhe përse këto elemente nuk ndikonin në përcaktimin e kompetencës lëndore në raport me nenin 7, shkronjat "a" dhe "ç", të Ligjit për Gjykatat Administrative.

50. Gjykata vëren, po ashtu, se kërkuesja nuk ka paraqitur vetëm një kërkim për dëmshpërblim ose për pasojat financiare të ndërprerjes së një marrëdhënieje pune. Ajo ka kërkuar shfuqizimin e

akteve të AAC-së, të cilat i ka cilësuar si akte administrative, përmes të cilave, sipas saj, është disponuar për përfundimin e marrëdhënies së saj në shërbimin civil, lirimin nga pozicioni, emërimin në një pozicion tjetër dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe financiare. Po kështu, ajo ka kërkuar rikthimin si nëpunëse civile në vendin e mëparshëm të punës ose në një pozicion të së njëjtës kategori. Këto kërkime, të vlerësuara së bashku me mënyrën sesi kërkuesja ka parashtruar shkakun juridik të padisë, tregonin, për qëllime të analizës së kompetencës lëndore, se mosmarrëveshja nuk kufizohej vetëm te pasojat e ndërprerjes së një marrëdhënieje pune, por lidhej edhe me pretendimin për ekzistencën, vazhdimësinë dhe mbrojtjen e statusit të nëpunëses civile, si dhe me natyrën e akteve të nxjerra nga organi publik.

51. Në këto kushte, Gjykata çmon se Gjykata e Lartë duhej të arsyetonte në mënyrë të posaçme përse natyra e mosmarrëveshjes, siç ishte parashtruar nga kërkuesja, aktet konkrete të kundërshtuara dhe kërkimi për rikthimin e statusit të nëpunëses civile nuk ishin elemente përcaktuese për kompetencën lëndore. Po kështu, ajo duhej të sqaronte përse pretendimi i kërkueses se aktet e AAC-së kishin disponuar për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil dhe për pasojat e këtij statusi nuk kërkonte shqyrtim nga gjykata administrative ose, të paktën, një vlerësim më të plotë për raportin midis elementeve që lidhen me aktet e organit publik, statusin e pretenduar të nëpunëses civile dhe marrëdhënien e punës sipas Kodit të Punës. Ky detyrim për arsyetim ishte veçanërisht i rëndësishëm, pasi përfundimi mbi ligjin e zbatueshëm për marrëdhënien e kërkueses lidhej drejtpërdrejt me një nga çështjet që ajo kërkonte të shqyrtohej në themel.

52. Gjykata konstaton se një arsyetim i tillë nuk rezulton të jetë dhënë. Gjykata e Lartë ka identifikuar ligjin e ri të AAC-së dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës sipas Kodit të Punës, por nuk ka dhënë një përgjigje të mjaftueshme përse ky element ishte i vetëmjaftueshëm për të përcaktuar përfundimisht natyrën civile të mosmarrëveshjes, pavarësisht se kërkuesja kishte kundërshtuar akte të organit publik dhe kishte kërkuar mbrojtje mbi bazën e statusit të nëpunëses civile. Po kështu, ajo nuk ka analizuar në mënyrë të mjaftueshme raportin midis nenit 7, shkronja "a", të Ligjit për Gjykatat Administrative, që lidhet me aktet administrative të organit publik, dhe nenit 7, shkronja "ç", që lidhet me marrëdhëniet e punës të nëpunësve civilë dhe me përjashtimin e marrëdhënieve të punës të bazuara në Kodin e Punës. Për më tepër, ligji i zbatueshëm për marrëdhënien e kërkueses dhe pasojat e hyrjes në fuqi të ligjit të ri të AAC-së mbi statusin e saj përbënin çështje të kontestuara në themelin e padisë. Në këto kushte, për sa kohë përfundimi se marrëdhënia e kërkueses rregullohej nga Kodi i Punës dhe se mosmarrëveshja kishte natyrë civile lidhej drejtpërdrejt me çështje të kontestuara në themelin e padisë, Gjykata e Lartë duhej të arsyetonte përse ky vlerësim mund të bëhej në fazën e përcaktimit të kompetencës lëndore, pa paragjykuar shqyrtimin në themel të pretendimeve të kërkueses për statusin e nëpunëses civile dhe për ligjshmërinë e akteve të kundërshtuara. Po ashtu, në analizën e saj nuk rezulton që Gjykata e Lartë të ketë marrë në konsideratë parimin e disponibilitetit të padisë dhe përfundimet unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara në vendimin nr. 3/2012, për sa i përket identifikimit të shkakut të padisë, rolit të paditësit në përcaktimin e mbrojtjes gjyqësore që kërkon dhe pasojave që rrjedhin kur gjykata vlerëson nëse kërkimi i paraqitur gëzon ose jo mbrojtje ligjore në themel. Kjo kishte rëndësi në rastin konkret, pasi kërkuesja nuk kishte kërkuar thjesht pasojat financiare të ndërprerjes së një marrëdhënieje pune, por kishte kërkuar shfuqizimin e akteve të AAC-së dhe rikthimin në statusin e nëpunëses civile.

53. Gjykata thekson se nuk i takon asaj të përcaktojë nëse ligji i ri i AAC-së e ka shuar ose jo statusin e kërkueses si nëpunëse civile, as nëse aktet e AAC-së janë ose jo akte administrative dhe, më tej, nëse ato janë ose jo të ligjshme. Këto janë çështje që i përkasin gjykimit të themelit nga gjykata kompetente. Megjithatë, pikërisht për këtë arsye, në fazën e rregullimit të kompetencës lëndore, Gjykata e Lartë duhej të arsyetonte me kujdes përse këto çështje nuk ndikonin në përcaktimin e gjykatës kompetente ose përse ato mund të merrnin përgjigje efektive në gjykimin civil. Mungesa e këtij arsyetimi krijon paqartësi nëse kërkuesja do të ketë një mjet gjyqësor efektiv për të marrë përgjigje mbi pretendimet që lidhen me statusin e nëpunëses civile dhe të drejtat që ajo pretendon se rrjedhin prej tij. Njëkohësisht, ajo lidhet edhe me garancinë e gjykatës së caktuar me ligj, për sa kohë përcaktimi i gjykatës kompetente duhet të mbështetet në kritere

ligjore të qarta dhe në një arsyetim që u jep përgjigje elementeve përcaktuese të kompetencës lëndore.

54. Në këtë kuptim, Gjykata çmon të theksojë se efektiviteti i mjetit juridik nuk matet vetëm me faktin se çështja është orientuar drejt një gjykate dhe se gjykimi i themelit vijon. Mjeti gjyqësor është efektiv kur gjykata përkatëse është në gjendje të shqyrtojë në substancë pretendimet thelbësore të palës dhe të japë një përgjigje të arsyetuar mbi to. Në rastin konkret, Gjykata e Lartë nuk ka sqaruar nëse gjykata civile, si gjykata e përcaktuar kompetente, mund t'u japë përgjigje pretendimeve për ligjshmërinë e akteve që kërkuesja i lidh me përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, ruajtjen e statusit të nëpunëses civile dhe pasojat që rrjedhin prej tij. Për rrjedhojë, vetëm fakti se çështja vijon pranë gjykatës civile nuk mjafton, në rrethanat e rastit konkret, për të përjashtuar cenimin e aksesit substancial në gjykatë dhe të së drejtës për mjet juridik efektiv.

55. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se cenimi i së drejtës së kërkueses nuk qëndron thjesht në faktin se Gjykata e Lartë ka interpretuar ligjin e zbatueshëm për kompetencën lëndore ose se ka arritur në përfundimin se çështja ka natyrë civile, pasi këto vlerësime, në parim, i përkasin funksionit të saj si gjykatë ligji. Cenimi qëndron në faktin se arsyetimi i përdorur nuk është i mjaftueshëm për të justifikuar përfundimin se natyra e mosmarrëveshjes, siç ishte parashtruar nga kërkuesja, aktet e kundërshtuara, kërkimet konkrete të padisë dhe statusi i pretenduar i nëpunëses civile nuk ishin përcaktuese për kompetencën lëndore. Në veçanti, Gjykata e Lartë nuk ka arsyetuar nëse dhe përse çështja e ligjit të zbatueshëm për marrëdhënien e kërkueses, e cila ishte një nga çështjet thelbësore të padisë, mund të zgjidhej në fazën e rregullimit të kompetencës pa cenuar mundësinë e kërkueses për shqyrtimin në themel të pretendimeve të saj. Duke mos dhënë përgjigje për këto elemente, Gjykata e Lartë ka cenuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor në atë masë që ky standard lidhet me garantimin e aksesit substancial në gjykatë dhe të mjetit juridik efektiv.

56. Për sa i përket pretendimit të kërkueses për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, në aspektin që lidhet me faktin se çështja e saj do të shqyrtohet nga gjykata civile dhe jo nga gjykata administrative, Gjykata vëren se ky pretendim lidhet drejtpërdrejt me mënyrën sesi duhet të përcaktohet kompetenca lëndore në rrethanat e rastit konkret. Për sa kohë kjo Gjykatë nuk përcakton vetë gjykatën kompetente dhe nuk zgjidh natyrën civile ose administrative të mosmarrëveshjes, ky pretendim nuk mund të marrë përgjigje të pavarur në këtë gjykim kushtetues. Ai duhet të shqyrtohet dhe të marrë përgjigje nga Gjykata e Lartë, në përmbushje të detyrimit të saj për të arsyetuar mbi kompetencën lëndore, duke mbajtur parasysh natyrën e akteve të kundërshtuara, statusin e pretenduar nga kërkuesja, kërkimet kryesore të padisë dhe kriteret e nenit 7 të Ligjit për Gjykatat Administrative.

57. Për sa i përket kërkesës së kërkueses që Gjykata të orientojë Gjykatën e Lartë drejt përdorimit të një mekanizmi procedural për raste të ngjashme, përfshirë mundësinë e shqyrtimit nga Kolegjet e Bashkuara, si dhe të përcaktojë kritere udhëzuese për trajtimin e konflikteve të kompetencës me natyrë të pretenduar hibride, Gjykata vëren se, në kuadër të ankimit kushtetues individual, kompetenca e saj kufizohet në kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të vendimmarrjes konkrete të kundërshtuar dhe në përcaktimin e standardeve kushtetuese që duhet të respektohen gjatë rishqyrtimit të çështjes. Përcaktimi i mekanizmit procedural konkret, përfshirë nëse çështja duhet t'i nënshtrohet shqyrtimit nga një kolegj i caktuar, nga një trupë me përbërje të ndryshme ose nga Kolegjet e Bashkuara, i përket Gjykatës së Lartë, në përputhje me kompetencat e saj kushtetuese dhe ligjore. Megjithatë, gjatë rishqyrtimit, Gjykata e Lartë është e detyruar të mbajë parasysh standardet kushtetuese të përcaktuara në këtë vendim, veçanërisht detyrimin për të dhënë përgjigje të arsyetuar për elementet që përcaktojnë kompetencën lëndore, në mënyrë që ndarja ndërmjet juridiksioneve të mos cenojë aksesin substancial në gjykatë dhe efektivitetin e mjetit gjyqësor.

58. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës së aksesit substancial në gjykatë të lidhur me të drejtën për mjet juridik efektiv, standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe të drejtën për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj është i bazuar në aspektin që lidhet me mungesën e një arsyetimi të mjaftueshëm për përcaktimin e kompetencës lëndore. Për rrjedhojë, kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe nenit 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2025-2954, datë 10.7.2025, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 16.6.2026.
Shpallur më 27.7.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji
Anëtarë: Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Genti Ibrahimi, Sandër Beci, Ilir Toska, Asim Vokshi

KËRKESË

Shtetasja Brunilda Koçollari kërkon pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, shpalljen e vdekjes së shtetasit Artur Koçollari, me atësi Petrit dhe amësi Luiza i lindur më 6.10.1982, në Kërrabë, Tiranë dhe vdekur më 20.12.2013, në shtetin Sirian, zona Halepo, Kobani.

KËRKUESE
Brunilda Koçollari

KËRKESË

Shtetasja Shpëtime Beqiri (Xhemali) kërkon pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, deklarimin e zhdukjes së shtetasit Pullumb Xhemali, me atësi Shuaip dhe amësi Afete, i lindur më 4.10.1965, shpalljen e vdekjes, si dhe caktimin e një kujdestari.

KËRKUESE
Shpëtime Beqiri (Xhemali)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 304 lekë

||FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË|Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare|Viti: 2026 - Numri: 170|Datë: 04.08.2026 14:44:15 +02:00|a427c372-2118-484c-9fe7-ae02c8642381

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë|të një procedure automatike nga një sistem elektronik|(Qendra e Botimeve Zyrtare)